



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 171 Akti

Nr. 363 Vendimi
Tiranë, më 1.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Roland Ilia	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 24.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Elizabeta Imeraj, me detyrë prokurore/drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta A. Imeraj, aktualisht me detyrë prokurore/drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë në të cilën është komanduar në datën 1.8.2018, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe i është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 17.9.2018 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues që mori në shqyrtim përfundimisht hetimin e thelluar administrativ të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, përbëhet nga Olsi Komici me cilësinë e kryesuesit, Suela Zhegu me cilësinë e anëtares dhe Roland Ilia me cilësinë e relatorit.

4. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

5. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 3.9.2018, e ILDKPKI-së, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

8. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me

qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2019, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.*

9. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 15.4.2019, për subjektin e rivlerësimit, ardhur në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2019.

10. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, atë të figurës dhe vlerësimit profesional, në datën 27.1.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj; (ii) njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 27.1.2021 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh me aktet e dosjes në datat 29.1.2021 dhe 3.2.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja.

13. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen, ka marrë një kopje të saj dhe ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 24.2.2021, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 24.3.2021.

15. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 24.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

16. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Znj. Elizabeta Imeraj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) gjetjet dhe opinionet e vëzhguesit ndërkombëtar si dhe denoncimet e publikut;
- ë) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/I. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

Znj. Elizabeta Imeraj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privat, nga vitit 2004-2017 si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit 84/2016 (deklarata *Vetting*).*

Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

A/II. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- e) gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë

hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, me nr. indeksi ***, datë 23.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për periudhën 2004 – 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratimeve të bëra nga subjekti në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka deklarim të rremë, konflikt interesi, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting* të dorëzuar në ILDKPKI dhe nga hetimi i kryer kanë rezultuar në pronësi 100% të subjektit këto pasuri:

1. Depozitë për fëmijë në vlerën 552,924 lekë

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 1.1 Kjo depozitë rezultoi se është çelur në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit në datën 24.1.2017. Balanca e depozitës është në vlerën 552,924 lekë.
- 1.2 Sipas deklarimit të subjektit burimi i krijimit është nga akumulimi dhe kalimi periodik mujor në vlerën prej 10,000 lekësh, nga llogaria e pagës së subjektit.
- 1.3 Bazuar në konfirmimin e “Credins Bank” dhe në verifikimin e kryer nga Komisioni, rezultuan veprimet për kalimet periodike të shumave nga llogaria rrjedhëse e pagës së subjektit në këtë depozitë.
- 1.4 Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë depozitë dhe rezultoi se subjekti ka bërë deklarim të saktë lidhur me këtë depozitë bankare.

2. Depozitë për fëmijë në vlerën 546,602 lekë

- 2.1 Kjo depozitë rezultoi se është çelur në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit në datën 24.1.2017. Balanca e depozitës është në vlerën 546,602 lekë.
- 2.2 Sipas deklarimit të subjektit, burimi i krijimit është nga akumulimi dhe kalimi periodik mujor në vlerën prej 10,000 lekë nga llogaria e pagës së subjektit.
- 2.3 Bazuar në konfirmimin e “Credins Bank” dhe verifikimin e kryer nga Komisioni, rezultuan veprimet për kalimet periodike të shumave nga llogaria rrjedhëse e pagës së subjektit në këtë depozitë.
- 2.4. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë depozitë dhe se subjekti ka bërë deklarim të saktë lidhur me këtë depozitë bankare.

3. Hetimi mbi pasurinë apartament banimi me nr. *, në Tropojë**

- 3.1 Bazuar në përgjigjen e ZVRPP-së Tropojë rezultoi se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve ka qenë e regjistruar në bashkëpronësi apartament banimi me sip. 91 m², pasuria nr. ***, z. k. ***.

- 3.2 Kjo pasuri e paluajtshme rezultoi se është përfituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, në vitin 2001, nga Enti Kombëtar i Banesave për shumën 28,700 lekë. Kontrata e privatizimit për këtë apartament është lidhur në datën 30.8.1993 nga babai i subjektit të rivlerësimit nga ku rezulton se është shlyer shuma 28,700 lekë.
- 3.3 Ky apartament është shitur në datën 13.6.2003, me kontratë nr. ***, për shumën 1,400,000 lekë, ku palë shitëse rezulton subjekti i rivlerësimit së bashku me nënën dhe babanë.
- 3.4 Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk rezulton që këto të ardhura dhe ky apartament të jenë deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe të ardhurat e përfituara nga kjo shitje nuk janë përfshirë në analizën financiare.
- 3.5 Në shpjegimet e dhëna nga subjekti rezulton se pasuria e mësipërme është përfituar nga prindërit e saj, në zbatim të ligjit nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe në bazë të nenit 9 të këtij ligji, pronarë të ligjshëm të kësaj banese, ishin prindërit, si të vetmit persona madhorë në familje në vitin e fitimit të pronësisë. Në vitin 1993, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë në moshën 14-vjeçare dhe, si e tillë, në bazë të ligjit nuk përfitonte të drejta pronësore.
- 3.6 Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri dhe të ardhurat e përfituara nga shitja nuk janë përfshirë në analizën financiare si të ardhura, duke qenë se subjekti ishte e mitur në kohën e përfitimit të kësaj pasurie nga prindërit, në procedurën e privatizimit.

4. Depozitë bankare në vlerën 18,300 lekë, në BKT

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 3.1 Kjo depozitë rezultoi se është hapur në emër të subjektit të rivlerësimit në BKT Tiranë. Burimi i krijimit është deklaruar nga të ardhurat e përfituara nga subjekti si pedagogë në W*** U***.
- 3.2 Bazuar në konfirmimin e BKT-së, vlera e kësaj depozite në momentin e deklaramit ishte në shumën 18,300 lekë.
- 3.3 Nga Komisioni u konstatua se në këtë llogari janë bërë veprime bankare nga të ardhurat e përfituara nga U*** në periudhën maj 2015 – shkurt 2016 dhe këto veprime janë reflektuar në analizën financiare.
- 4.4 Nga nxjerrja e llogarisë në lekë në BKT, me nr. ***, në emër të subjektit, rezultoi se:
- Në datën 17.10.2006 është kredituar kredia në shumën 1,920,000 lekë, e cila është tërhequr në po të njëjtën datë nga subjekti. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në deklaratën vjetore për vitin 2006, me qëllim përdorimi për rregullime shtëpie.
- 4.5 Nga hetimi rezultoi se në datën 9.10.2006 me kontratë kredie nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në BKT me afat 240 muaj, me qëllim për rregullim/ndërtim një shtëpi.
- 4.6 Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me këtë kredi, e cila në përgjigjen e saj¹ ka sqaruar se: *“Në vitin 2006 kam marrë një kredi në vlerën prej 2,000,000 lekësh në BKT, si një kredi konsumatore, kredi kjo e marrë në kushte normale. Qëllimi i kësaj kredie ka qenë investimi dhe blerja e disa pajisjeve për banesën në të cilën jetoja në atë kohë, tek prindërit e mi. Në lidhje me sa kërkoni për mungesën e deklaramit të saj në deklaratën *Vetting* kjo lidhet me faktin se kjo kredi ishte një kredi e mbyllur dhe nuk listohej si*

¹Shihni përgjigjen e pyetësorit të subjektit drejtuar Komisionit.

detyrim. Ndërkohë që është deklaruar nga ana ime në deklaratat periodike në mënyrë të plotë”.

4.7 Rezultoi se në datën 7.5.2007 është depozituar në BKT nga subjekti shuma 2,079,000 lekë, e cila është përdorur për shlyerjen e plotë dhe të parakohshme të kredisë të marrë në datën 9.10.2006.

4.8 Subjekti i rivlerësimit është pyetur për burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj kredie, e cila në përgjigjen e saj ka deklaruar se: *“Shlyerja e kësaj kredie është bërë brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe jo sipas afatit që ishte marrë duke qenë se nuk e shpenzova shumën e marrë si kredi, edhe për shkak të martesës sime. Si burim për shlyerjen e kredisë kanë shërbyer në pjesën më të madhe vetë kredia e marrë, të ardhurat nga puna ime ...”.*

4.9 Gjatë analizimit të mundësisë së shlyerjes së kredisë janë marrë parasysh të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj, duke u ndërtuar për këtë edhe analiza financiare². Në këtë analizë nuk janë marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit se si burim mbyllje kredie, ka shërbyer pjesërisht vetë kjo kredi e papërdorur.

4.10 Në përfundim të hetimit të kryer nga Komisioni me rezultatet³ subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime dhe prova. Në përgjigje të tyre, subjekti deklaroi⁴:

“- Kredia është përfituar në datën 17 tetor 2006, me qëllim konstruksionin banese dhe blerjen e pajisjeve shtëpiake;

- qëllimi i marrjes së kredisë është shpjeguar detajisht në DPV-në për vitin 2006, kur edhe kjo kredi është përfituar;

- nuk kam kryer asnjë shpenzim nga të ardhurat e përfituara nga kredia dhe këtë e vërteton fakti se në DPV/2006 dhe DPV/2007 nuk është deklaruar në rubrikën përkatëse shpenzime të kryera;

- referuar jo vetëm kësaj kredie, por nga analizimi i DPV në gjithë ato vite, asnjëherë nuk kam kryer shpenzime në vlera të konsiderueshme, e aq më pak të shpenzoja 2,000,000 lekë për një muaj e gjysmë;

- për shkak të rrethanave të jetës (për shkak të martesës sime), nuk e realizova qëllimin për të cilin e kisha përfituar këtë kredi dhe për të mos paguar interesa bankare për një shumë kredie që e disponoja të pakosumuar, bëra mbylljen e parakohshme të saj, sikurse provohet nga STM pranë BKT-së, ku e kam depozituar të plotë shumën për mbylljen e parakohshme të kredisë”.

4.11 Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe ka kërkuar të administrohen edhe aktet shkresore ku përfshihet: shkresë e ardhur nga Bashkia Tiranë, në të cilën informohet se në emër të subjektit nuk është lëshuar asnjëherë lejendërtimi; shkresë nga BKT-ja, përmes të cilët përlllogaritjen interesat që duhet të likuidonte subjekti, nëse nuk do të bënte mbylljen e parakohshme të kredisë⁵.

4.12 Për sa i përket mosdeklarimit të gjendjes së kredisë së papërdorur në fund të vitit 2006, subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në shpjegimet e depozituara në seancë dëgjimore ka shpjeguar se: *“Shuma e marrë kredi është deklaruar rregullisht në deklaratën periodike të vitit 2006 në rubrikën e detyrimeve financiare, por nuk është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, e kjo ka ardhur për shkak të perceptimit që unë kam pasur për këtë kredi, pasi kjo shumë monetare lidhej me huan/detyrimin dhe jo me gjendjen e krijuar për shkak kursimi. Ky qëndrim dhe*

²Shihni analizën financiare të rezultateve të hetimit të dërguar nga Komisioni subjektit.

³Shihni rezultatet e hetimit të dërguar subjektit të rivlerësimit nga Komisioni.

⁴Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

⁵Përmes këtij akti, subjekti shpjegon logjikën ekonomike të mbylljes së parakohshme të kredisë.

perceptim i imi në raport me mënyrën e deklarimit të kredisë është bërë edhe nga subjekte të tjerë të rivlerësimit, duke u pranuar si i drejtë edhe nga Komisioni siç është edhe vendimi nr. 152, datë 7.6.2019, për subjektin E.K., i cili ka marrë formë të prerë në datën 5.8.2019”.

4.13 Konkluzion i Komisionit

- Rezultoi se në datën 17.10.2006 është kredituar kredia në shumën 1,920,000 lekë, e cila është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit. Qëllimi i kredisë ka qenë “për të ndërtuar shtëpi ...”.
- Rezultoi se në datën 7.5.2007, nga subjekti i rivlerësimit është depozituar në BKT shuma prej 2,079.000 lekësh, e cila është përdorur për shlyerjen e plotë dhe të parakohshme të kredisë të marrë në datën 7.10.2006.
- Në përgjigjen e saj, subjekti deklaroi se: *“Shlyerja e kësaj kredie është bërë brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe jo sipas afatit që ishte marrë duke qenë se nuk e shpenzova të gjithë shumën e marrë si kredi, edhe për shkak të martesës sime. Si burim për shlyerjen e kredisë kanë shërbyer në pjesën më të madhe vetë kredia e marrë, të ardhurat nga puna ime ...”.*
- Referuar shkresës nr. *** prot., datë 23.2.2021, të BKT-së, rezultoi disbursimi i kredisë më 17.10.2006, në vlerën prej 2,000,000 lekë dhe se kredia është mbyllur në datën 7.5.2007, me fonde të arkëtuara nga subjekti i rivlerësimit.
- Nga Komisioni nuk u konstatua shpenzim i kryer i vlerës së kredisë për ndërtim shtëpie në vitin 2006 dhe 2007.
- Komisioni i konsideroi bindëse deklaratimet e subjektit për mospërdorimin e kredisë në vitin 2006, duke pasur parasysh se kredia e përfituar është deklaruar edhe në deklaratën periodike për vitin 2006 nga subjekti. Vlera e kredisë së papërdorur në vitin 2006, u konsiderua si burim kryesor për shlyerjen e saj në vitin 2007, së bashku me të ardhurat e subjektit dhe ish-bashkëshortit.
- Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2006, Komisioni e konsideron si paqartësi të subjektit për plotësimin e kësaj DPV-je, pasi subjekti e ka deklaruar si të ardhur kredinë e përfituar në këtë vit, duke u pasqyruar kështu edhe gjendja e saj deri në datën 31.12.2006. Komisioni në vendimmarrje mori në konsideratë edhe faktin se vetëm me ndryshimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, në vitin 2014, u përfshi deklarimi për *“gjendje cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lek ose në valutë të huaj”.*
- Analiza financiare (në vijim) për mundësinë e subjektit për shlyerjen e kredisë u hartua nga Komisioni pas përgjigjeve dhe provave që subjekti ka sjellë në përgjigje të rezultateve të hetimit. Vlera e tërhequr e kredisë në vitin 2006 u konsiderua si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar dhe u përfshi si burim në analizën financiare, për shlyerjen e kredisë në vitin 2007.

4.14 Analiza financiare për shlyerjen e kredisë

Analizë mbyllje e parakohshme e kredisë në BKT – Elizabeta Imeraj – në vlerën 2,079,000 lekë, datë 7.5.2007

Të ardhura nga paga E. Imeraj deri më 7.5.2007	409,603
Të ardhura A.B. deri më 7.5.2007	651,300
Të ardhura total	1,060,903

Shpenzime jetese deri më 7.5.2007	70,473
Shlyerje kredi NBG deri më 7.5.2007	40,700
Shlyerje kredi BKT E. Imeraj deri më 7.5.2007	2,105,828
Shpenzime në total	2,217,001
Diferencë likuiditeti 7.5.2007 – 31.12.2006	-1,836,372
Total pasuri	-1,836,372
Mundësia financiare	680,275

Bazuar në këtë analizë financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për mbylljen e parakohshme të kredisë në datën 7.5.2007, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të asaj periudhe.

4.15 Në BKT rezulton edhe një llogari në lekë në emër të subjektit të rivlerësimit, e cila rezultoi me balancë 0 (zero) në datën e deklaratës *Vetting*.

4.16 Nga verifikimi i llogarisë me nr. *** në lekë, në emër të subjektit, rezulton se :

- Në datën 10.5.2006 është depozituar shuma 1,100,000 lekë. Kjo shumë është tërhequr nga subjekti nga data 12.5.2006 – 18.5.2006. Kjo lëvizje është kryer përpara lëvrimit të kredisë së mësipërme.

4.17 Për të shpjeguar burimin i të ardhurave për këtë shumë dhe destinacionin e përdorimit është pyetur subjekti, e cila ka sqaruar se⁶: *“Shuma prej 1,100,000 lekësh është depozituar nga ana ime në llogarinë në BKT me qëllim garancie për pajisjen me vizë Angleze. Kjo vlerë është depozituar në datën 10.5.2006 dhe është tërhequr përsëri brenda pak ditëve. Kjo shumë është marrë dhe kthyer përsëri tek i afërmi im shtetasi H.B., për efektin e mësipërm (bashkëlidhur deklaratata e shtetasit H.B.)”*.

4.18 Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues:

- kërkesë për informacion në BKT për depozitimimin e shumës 1,100,000 lekë;
- shkresë BKT-së informacion nr. *** prot., datë 22.5.2019;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.5.2019, lëshuar nga shtetasi H.B. në të cilën deklaron se: *“Në vitin 2006 i kam dhënë përkohësisht në përdorim kushërirës sime Elizabeta Imeraj shumën në vlerën 1,100,000 lekë të reja me qëllim hapjen e një depozite bankare për t'i përdorur si garanci për aplikim për vizë. Kjo shumë është dhënë në datën 10.5.2006 dhe po e njëjta shumë më është kthyer përsëri pas disa ditësh”*.

4.19 Nga sistemi *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar jashtë Shqipërisë për periudhën 19.5.2006 – 24.5.2006.

4.20 Nga Komisioni u hetua mundësia e z. H.B., për dhënien e huas në shumën 1,100,000 lekë subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se z. H.B. ka pasur depozita në vlera të konsiderueshme.

4.21 Në përfundim nisur nga fakti se kalimi i shumës në këtë depozitë dhe tërheqja e saj është bërë në një periudhë 8-ditore dhe se subjekti nuk ka përfituar pasuri nga kjo hua (hua e marrë për garanci për marrje vize), Komisioni nuk konstatoi problematika.

5. Llogari bankare në vlerën 392.52 lekë

5.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogari bankare në vlerën 392.52 lekë.

⁶Shihni përgjigjen e subjektit në pyetësorin nr. 1.

5.2 Kjo llogari rezultoi se është çelur në emër të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” dhe në datën 24.1.2017, balanca e saj është në vlerën 392.52 lekë.

5.3 Nga Komisioni nuk u konstatuan problematika për këtë llogari bankare dhe ndryshimet e saj, ndër vite (shtesa dhe pakësime), janë përfshirë në analizën financiare.

6. Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat nga marrëdhëniet e punës si prokurore, shitje automjeti dhe mësimdhënia.

6.2 Në analizën financiare⁷ janë përfshirë të gjitha të ardhurat e ligjshme të vërtetuara dhe të konfirmuara nga institucionet përkatëse.

- Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjeve në depozitat dhe llogaritë bankare si më sipër. Deklarimet e subjektit përputhen me rezultatin e hetimeve të kryera nga Komisioni.

Komisioni, gjatë hetimit administrativ të kryer, konstatoi se marrëdhëniet pronësore ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personit të saj të lidhur (ish-bashkëshorti), janë rregulluar përmes kontratës “Për regjimin e pasurive të ndara”, në kuptim të neneve 66⁸ dhe 115⁹ të Kodit të Familjes.

Në kontratën e përcaktimit të regjimit pasuror, janë evidentuar pasuritë në pronësi apo të drejtat reale që bashkëshortët kanë pasur përpara lidhjes së martesës. Këto pasuri në mbështetje të nenit 77 të Kodit të Familjes¹⁰, mbeten personale, ndërsa sanksionohet se çdo pasuri tjetër (tej atyre të krijuara para martesë), do të vijojë të mbeten individuale dhe në pronësi personale të bashkëshortit në emër të të cilit do të regjistrohen këto pasuri.

Duke qenë se pasuri të paluajtshme në momentin e dorëzimit dhe deklarimit të tyre në deklaratën *Vetting* rezultojnë po ato që janë krijuar para lidhjes së martesës dhe të parashikuara në kontratën “E regjimit pasuror”, Komisioni i ka renditur në vijim, duke verifikuar saktësinë e deklarimit të tyre nga subjekti dhe personi i saj i lidhur.

Në deklaratën *Vetting* janë deklaruar si pasuri të personit të lidhur pasuritë si vijon:

⁷Shihni analizën financiare më poshtë në këtë vendim.

⁸Neni 66 i Kodit të Familjes parashikon: “Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës”.

⁹Neni 115 i Kodit të Familjes parashikon se: “Kur bashkëshortët kanë përcaktuar në kontratën e martesës regjimin e pasurive të ndara, secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij. Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur atij, para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 70 të këtij kodi”.

¹⁰Neni 77 i Kodit të Familjes, në lidhje me kuptimin e pasurisë vetjake parashikon se: “Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:

a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;

b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë;

c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesorë të pasurisë vetjake;

ç) njetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare;

d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;

dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura;

e) shkëmbimi i tyre, kur kjo është e deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes.

7. Pasuri e paluajtshme në rrugën “*” dhe legalizim shtese banese**

- 7.1** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuri të paluajtshme të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, apartament me sip. 66 m², në pronësi të shtetasit A.B., blerë në vitin 2008, në shumën 4,000,000 lekë.
- 7.2** Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: blerë me kredinë bankare të marrë në datën 31.1.2008, në vlerën 4,000,000 lekë, në BKT.
- 7.3** Subjekti, në lidhje me këtë apartament, vlerën dhe pronësinë e tij, ka shpjeguar se vlera e shitblerjes së apartamentit ka qenë shuma prej 4,000,000 lekësh. Kjo vlerë është deklaruar nga subjekti edhe më parë si vlerë e përgjithshme se sa ka kushtuar kjo pasuri. Në lidhje vetëm me vlerën e apartamentit, subjekti ka deklaruar se: *“Në kontratë ashtu sikurse edhe në deklaratimet periodike të pasurisë, çmimi i pasurisë së ndodhur në rr. ‘***’ është shënuar 4,000,000 lekë, sepse atëherë ka qenë shuma reale e shitblerjes dhe i vetmi akt juridik në të cilin përcaktohet çmimi i shitjes është kontrata e shitjes, sipas parashikimeve të Kodit Civil Shqiptar”*.
- 7.4** Rezultoi se në datën 31.1.2008 me kontratën e shitblerjes nr. ***, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë apartament me sip. 66 m², në katin e parë, në rrugën “***”, p. ***, shk.*** ap. ***, për shumën 4,000,000 lekë, nga shtetasja M.P.
- 7.5** Bazuar në këtë kontratë rezulton se shuma është likuiduar dhe se pala shitëse deklaroi se ka marrë nga pala blerëse shumën prej 4,000,000 lekësh. Apartamenti ka numër pasurie *** dhe ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se është në pronësi individuale të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
- 7.6** Bazuar në deklaratimet e subjektit mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie përmes kredisë bankare ka rezultuar se në datën 29.1.2008, përmes kontratës nr. ***, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka marrë kredi për blerje apartamenti në shumën 100,000 euro.
- 7.7** Kjo kredi është siguruar me kontratë hipotekimi nr. ***, datë 29.1.2008, sipas të cilës është hipotekuar në favor të BKT-së, për të garantuar kthimin e kredisë prej 100.000 euro, apartamenti me sip. 73 m², nr. pasurie ***, në rrugën “***” (pasuri e analizuar në vijim).
- 7.8** Shumat e paguara për shlyerjen e kredisë duke përfshirë principalin dhe interesin, si dhe mundësinë financiare të ish-bashkëshortit si person i lidhur, janë përfshirë në analizën financiare.
- 7.9** Nga nxjerrja e llogarisë në euro të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit rezultoi se:
- Në datën 30.1.2008 është disbursuar kredia në shumën 98,800 euro.
 - Në datën 31.1.2008 është transferuar te shtetasja M.D. shuma prej 90,000 euro me emërtim për blerje apartamenti.
- 7.10** Subjekti është pyetur në lidhje me faktin e kalimit të shumës prej 90,000 euro te shtetasja M.D. dhe jo znj. M.P.. Në përgjigje, subjekti sqaroi se:
- “Në vitin 2008 bashkëshorti ka marrë një kredi në vlerën prej 100,000 euro. Kjo shumë është përdorur për blerjen e apartamentit të ndodhur në rruga “***”, k. ***, ap. ***, Tiranë, si edhe për pagesën e një shume të hollash shtetasve M. dhe M.D..*
- Kjo shumë i është kaluar në llogari shtetasve M.D., sipas kërkesës së bërë nga shitësi i pasurisë M.P. - sepse janë të afërm mes tyre - duke qenë se kësaj shtetaseje i ishte marrë edhe një hua më parë në kohë dhe pa interes nga vëllai i tim shoqi.*
- Deklaroj se nuk kam asnjë raport me shtetasen M.D., personalisht dhe nuk kam pasur ndonjëherë në hetim atë vetë apo familjarë të saj.*

Kam për të sqaruar se bashkëshorti im A.B. ka pasur më parë në kohë komunikime dhe raporte me shtetasen M.P. që i ka blerë apartamentin, si dhe vetë shtetasja M.P. ka pasur raporte me M. dhe M.D. Gjithashtu, vëllai i bashkëshortit ka marrë një shumë prej tyre në vitin 2004, e cila është shlyer me këtë kredi”.

- 7.11** Nga hetimi i Komisionit janë administruar gjatë hetimit administrativ dy deklarata noteriale:
- a) Deklarata noteriale nr. ***, datë 3.2.2016, në të cilën znj. M.P. deklaroi se në vitin 2008 i ka shitur apartament shtetasit A.B. Shuma e këtij apartamenti i është dorëzuar nga të afërmit e saj, konkretisht, nga shtetasja M.D. të cilës blerësi A.B. ia ka kaluar përmes bankës.
 - b) Deklarata noteriale nr. ***, datë 3.2.2016, në të cilën shtetasit M.D. dhe M.D. deklarojnë se në datën 31.1.2008 i ka kaluar shuma prej 90,000 euro pranë BKT-së nga shtetasi A.B.. Nga kjo shumë 45,000 euro kanë qenë për banesën e shitur nga shtetasja M.P. dhe 45,000 euro kanë qenë për ta, duke qenë se u është kthyer një shumë të hollash që shtetasi A.B. i detyrohej nga viti 2004.
- 7.12** Nga hetimi i kryer nga Komisioni janë përfutur edhe një tërësi aktesh të tjera juridike në lidhje me këtë pasuri të përpiluara nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për të cilat nga hetimi u provua se nuk ishin të lidhura me vullnetin e subjektit të rivlerësimit dhe nuk kishin sjellë përfitim apo të drejta të tjera në favor të saj.
- 7.13** Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament me sip. 66 m², në pronësi të shtetasit A.B., rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, që vjen në analogji dhe me dy deklaratat noteriale të datës 3.2.2016 (të hartuara para plotësimit dhe depozitimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti). Si rrjedhim, rezultoi se burim i krijimit të saj ka qenë kredia bankare e përfituar nga ish-bashkëshorti në vlerën prej 100,000 euro.
- 7.14** Bazuar në shkresën e ZVRPP-së¹¹ Tiranë, rezultoi se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është pronar i pasurisë nr. ***, e llojit truall me sip. 70.40 m², nga e cila ndërtesë me sip. 70.40 m², në rrugën “****”, përfituar me lejen e legalizimit nr. 116088, datë 31.8.2015, shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues 5-katësh.
- 7.15** Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës me sip. 50 m², në rrugën “****” (objekt jobanimi, i ndërtuar në tokë publike).
- 7.16** Në datën 19.12.2014 me deklaratë nr. *** prot., për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtime me leje, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se ndërtimi është ngritur në vitin 2006.
- 7.17** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga ALUIZNI konstatohet se me kontratë në dobi të personit të tretë, premtim për shitjen e banesës së ndodhur në rrugën “****”, p. *** shk.***, ap. *** k. ***, Tiranë, lidhur në datën 9.6.2006, rezultoi se:
- Znj. M.P. ka në pronësi një shtëpi banimi, me sip. 66 m², të ndodhur në rr. “****”, të cilën e ka përfituar në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 4.11.1998. Kjo banesë i është shitur nga shtetasit M., M. dhe A.D.
 - Me kontratë në dobi të një personi të tretë të lidhur në datën 9.6.2006, propozuesi M.P. deklaroi se një dhomë të kësaj banese ia ka lënë kundrejt pagesës av. A.B., me premtimin që ka për t’i shitur dhe gjithë banesën sapo të jetë gati për shitje.

¹¹ Shihni përgjigjen e ZVRPP-në dosjen e Komisionit.

- Më tej, shtetasja M.P. deklaron se: *“Në momentin më të parë që banesa ime do të jetë e lirë për t’u shitur, ne si palë kemi rënë dakord që këtë banesë ta blejë shtetasi A.B., i cili ka edhe pjesën ballore të banesës time (ndërtim pa leje rreth 50 m²)”.*
- Në lidhje me shtesën me sip. 50 m², av. A.B., ka të drejtën e aplikimit për legalizim.

7.18 Për të saktësuar situatën në lidhje me ndërtimin e shtesës, i janë kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila në përgjigje ka sqaruar se:

*“Bashkëshorti im ka marrë në posedim një pjesë të apartamentit në vitin 2006, periudhë në të cilën ka filluar edhe bisedimet me shitësin për të marrë në pronësi të gjithë apartamentin. Nga pronarët është autorizuar për të vijuar dhe ndjekur procedurat e legalizimit për shtesën në fjalë (referuar aktmarrëveshjes ‘Premtim dhe shitje banese’, vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 9.6.2006).*

Sipas deklaramit për legalizim, shtesa është ndërtuar përgjatë vitit 2006, para martesës sime dhe është bërë nga pronarët e banesës”.

- 7.19** Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me kontratë nr. ***, datë 27.8.2015, ka përfituar kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sip. 70.4 m², ku sipërfaqja e ndërtimit të shtesës është 70.4 m².
- 7.20** Bazuar në këtë kontratë rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar për legalizimin e kësaj banese shumë 1,447,802 lekë dhe bono privatizimi shumë 2,020,000 lekë. Këto pagesa vërtetohen me urdhërxhirimet e datës 27.8.2015, “Credins Bank”.
- 7.21** Bazuar në analizën financiare, dukej se subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj nuk kishin mundësi financiare për pagesën e vlerës së legalizimit të shtesës mbi pasurinë, si edhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të përfshira në këtë analizë, në vitin 2015, në vlerën prej 108,762 lekësh.
- 7.22** Analiza financiare është hartuar duke mbajtur parasysh të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga qiratë.
- 7.23** Në analizën financiare të bërë për këtë pasuri janë përfshirë të ardhurat nga qiraja dhe shuma e dhuruar nga z. A.B. (dhurim i llogaritur deri në datën 27.8.2015), pasi subjekti ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat dhe burimin e ligjshëm.
- 7.24** Subjekti është pyetur në lidhje me vlerën e blerjes së bonove të privatizimit që kanë shërbyer për legalizimin e kësaj banese. Subjekti nuk ka dhënë një përgjigje e saktë për vlerën e blerjes së tyre. Në analizë financiare janë përfshirë shpenzimet për blerjen e këtyre bonove duke i llogaritur me 7%, pra, 2,020,000 x 7% = 141.400 (bazuar në të dhënat e marra publikisht).
- 7.25** Në analizën financiare është përfshirë si vlerë e shpenzuar nga subjekti/ish-bashkëshorti për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2008, shuma prej 45,000 euro, kurse në vitin 2015 për legalizimin shumat 1,447,802 lekë dhe 2,020,000 lekë bono privatizimi (shumë e konvertuar dhe e barasvlershme me 141,400 lekë).
- 7.26** Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, mbi pronësinë dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar:

“Nuk kam pasuri individuale apo në bashkëpronësi me ish-bashkëshortin, pasi i kemi nënshtruar regjimit të pasurive të ndara. Për këtë rivendos në dispozicion kontratën

nr. ***, datë 27.3.2007 (para lidhjes së martesës), 'Regjimit pasuror paramartesor, regjimi i pasurive të ndara'. Sipas kësaj kontrate marrëdhëniet e tyre pasurore i nënshkruhen regjimit pasuror atë të 'Pasurive të ndara', pasuritë që i nënshtrohen këtij regjimi pasuror janë renditur në kontratë si më poshtë:

- a) banesë 5-katëshe e ndodhur në ***;
- b) njësi sip. 73 m², e ndodhur në rrugën '***';
- c) banesë sip. 61 m², e ndodhur në ***, Durrës;
- d) pasuri tokë arë me sip. 1464 m², në ***; si dhe
- e) e drejtë reale për pasurinë në rrugën '***', Tiranë”.

7.27 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹², si edhe mbi pamundësinë e konstatuar nga Komisioni, subjekti deklaroi:

*“Përmes kontratës nr. ***, datë 27.3.2007, së bashku me ish-bashkëshortin kemi rënë dakord me vullnet të plotë dhe të lirë, për të përcaktuar regjimin e pasurive të ndara. Sipas kësaj kontrate të gjitha pasuritë e krijuara para martesë do të vijojnë të mbeten vetjake. Në këtë kontratë janë përcaktuar disa pasuri të paluajtshme të krijuara nga ish-bashkëshorti para martesë, ndër të cilat, edhe pasuria e ndodhur në rr. '***'. Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët dhe është e lidhur sipas Kodit Civil dhe Kodit të Familjes.*

Për këtë pasuri nuk kam marrë pjesë në shitblerjen e saj, nuk kam tërhequr asnjëherë asnjë të drejtë pronësie prej tyre, nuk kam siguruar të ardhura personale dhe nuk i kam përdorur asnjëherë për asnjë lloj interesi vetjak.

Lidhur me mundësitë financiare nëse shikoni dhe përfshini të ardhurat e qirasë së përfituar nga bashkëshorti për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, rezultoj me balancë pozitive, duke pasur mundësi për krijimin e shumës për legalizimin e kësaj pasurie të paluajtshme, në pronësi individuale të ish-bashkëshortit”.

7.28 Analiza dhe konkluzioni i Komisionit

- Para konstatimeve në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme të deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, në pronësi të ish-bashkëshortit, fillimisht Komisioni bën një analizë në lidhje me origjinën e këtyre pasurive, statusin juridik të tyre, të drejtat reale/pronësore të subjektit të rivlerësimit mbi to dhe, më pas, mundësinë financiare për krijimin e tyre.
- Për pasurinë e paluajtshme me sip. 66 m², të ndodhur në rr. “***”, rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, para lidhjes së martesës ka nënshkruar një kontratë “Premtim shitje”, sipas të cilës do të marrë në pronësi/blejë një apartament me sip. 66 m², të ndodhur në rr. “***”, sapo kjo e fundit të jetë e gatshme për t’u shitur (pra, të pajisej me dokumentacionin e nevojshëm të pronësisë). Gjithashtu, para lidhjes së martesës u provua se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, kishte fituar të drejtën e parablerjes për apartamentin, si edhe të drejtën reale mbi një shtesë apartamenti me sip. 50 m² (pasuri të ndodhura ngjitur mes tyre), për të cilën nga pronarët ishte autorizuar për të bërë aplikimin për legalizim dhe fituar të drejtën e pronësisë mbi të.
- Bazuar në praktikën e legalizimit të shtesës së apartamentit, rezulton se ajo është ndërtuar dhe vetëdeklaruar e ndërtuar në vitin 2006, periudhë kur në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk kishte lidhur martesë dhe, si e tillë, nuk kishte shfaqur asnjë vullnet për krijimin, ndryshimin apo shuarjen e këtyre të drejtave.

¹²Shihni rezultatet e hetimit dërguar subjektit lidhur me këtë pasuri.

- Në deklaratën e datës 16.1.2008, të nënshkruar nga ish-bashkëshorti në prani të subjektit të rivlerësimit dhe znj. M.P., parashikohet se: *“Shuma e shitjes së shtëpisë së banimit të ndodhur në rrugën “***” është vendosur 150,000 euro. Prej z. A.B. është dorëzuar parapagesë një shumë të hollash 5,000 euro. Pjesa tjetër e shumës së shitjes do t’i jepet në momentin e përpilimit të kontratës së shitjes”*.

Komisioni, lidhur me këtë deklaratë, arriti në konkluzionin se i vetmi akt juridik në të cilin përcaktohet çmimi i shitjes është kontrata e shitjes, sipas parashikimeve të Kodit Civil Shqiptar. Shuma e përmendur në deklaratë prej 150,000 euro nuk rezultoi se është bërë ndonjëherë si pagesë. Deklarata mes palëve e datës 16.1.2008, përbën një akt përmes të cilës palët zotoheshin se në të ardhmen do të kryenin një shitblerje, por kjo deklaratë nuk ka pasur efekte juridike, pasi nuk është realizuar qëllimi. Nuk rezultoi që pasuria shtëpi banimi, trualli dhe shtesa pa leje të jetë blerë nga ish-bashkëshorti i subjektit. Rezultoi vetëm blerja e shtëpisë së banimit me kontratë noteriale dhe procedurat e tjera për truallin dhe shtesën janë ndjekur ndërmjet legalizimit, ku janë paguar edhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit.

- Kontrata e huamarrjes nr. ***, datë 1.2.2008, përmes së cilës znj. M.D. i ka dhënë hua shumë prej 55,000 euro z. A.B., nuk rezultoi që të ketë prodhuar efekte juridike. Si garanci për kthimin e kësaj shume pas kalimit të afatit 1-vjeçar të huas, do të shërbente sip. 12 m², e përbërë nga një dhomë e apartamentit të banimit me nr. pasurie ***. Fakti që në kartelën e pasurisë nr. *** nuk është vendosur ndonjë hipotekë, konfirmon që kjo kontratë huamarrjeje nuk është finalizuar. Gjithashtu, shuma e përcaktuar në këtë kontratë huamarrjeje nuk ka shërbyer për blerja pasurie dhe as është deklaruar si e ardhur nga ish-bashkëshorti i subjektit.
- Bazuar në kontratën nr. ***, datë 27.3.2007, ndër të tjera, është sanksionuar dhe bashkëlidhur dokumentacion provues sipas të cilit pasuritë:
 - banesa në “***”;
 - njësi me sip. 73 m² në rrugën “***”;
 - banesë me sip. 61 m², në ***, Durrës;
 - pasuri tokë arë me sip. 1464, në ***; dhe
 - e drejtë reale për pasurinë në rrugën “***”;

janë pasuri apo të drejta të krijuara para lidhjes së martesës (kontrata është e datës 27.3.2007) dhe, si të tilla, ato qëndrojnë individuale të personit që i ka fituar apo i ka në pronësi.

- Bazuar në Kodin e Familjes, neni 77 “Pasuria vetjake”, parashikon se: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:*
 - a) pasuria e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;*
 - b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit...;*
 - c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort...;*
 - d) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit...;*
 - e) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;*
 - f) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura;*
 - g) shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar”*.

- Referuar situatës faktike në bazë të kontratës së regjimit pasuror martesor në raport me përcaktimet e Kodit të Familjes, rezulton se pasuritë e cituara në këtë kontratë (4 pasuri dhe një e drejtë reale), përbëjnë pasuri individuale të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Për krijimin e këtyre pasurive nuk rezultoi të jetë shprehur ndonjë vullnet i subjektit të rivlerësimit, nuk rezultoi ndonjë akt në të cilin të ketë disponuar në çfarëdolloj forme ndonjë nga këto pasuri, si edhe nuk rezultoi që të ketë përfituar apo deklaruar interesa pasurorë apo të ketë përdorur këtë pasuri. Bazuar në dokumentacionin e origjinës të këtyre dy pasurive, konfirmohet se ato janë në pronësi individuale të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe në të gjitha aktet shkresore për zotërimin e saj, ka qenë vullnet i vetëm i pronarit.

Pavarësisht rezultateve mbi hetimin e këtyre dy pasurive dhe mundësisë financiare të krijimit të tyre, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi.

Për të arritur në konkluzionin e mësipërm, Komisioni i referohet edhe praktikës së deritanishme të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për sa i përket trajtimit që iu janë bërë pasurive apo të drejtave të krijuara nga personat e lidhur përpara martese.

- Në vendimin nr. 181, datë 18.7.2019, të Komisionit për subjektin e rivlerësimit E.K., ndër të tjera, arsyetohet se: *“Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për personin e lidhur, nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, pasi kjo e fundit provoi me dokumentacion ligjor se martesa ligjore e subjektit (ka ndodhur pasi është krijuar pasuria e paluajtshme)... Subjekti provoi se nuk ka pasur asnjë lidhje interesi midis subjektit dhe personit të lidhur, në momentin e blerjes së apartamentit”.*

Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me detyrimet ligjore që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë në zbatim të legjislacionit.

- Në vendimin nr. 262, datë 17.6.2020, të Komisionit për subjektin E.P., ndër të tjera, arsyetohet se të gjitha situatat faktike kur pasuria ka rezultuar e fituar nga personi i lidhur para martese, pavarësisht se nuk justifikohet burimi i ligjshëm i krijimit të tyre, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbën detyrim e aq më pak shkak për shkarkim të subjektit të rivlerësimit, mjafton të provohet mospasja në pronësi e këtyre pasurive, apo ndonjë e drejtë tjetër interesi kundrejt tyre.

Përveç rikonfirmimit të qëndrimit të mësipërm se pasuria paramartesorë e personit të lidhur, nuk mund t’i ngarkohet subjektit të rivlerësimit, nga ana tjetër në këtë vendim u mbajt qëndrimi (i cili u gjend i bazuar edhe nga institucioni i Komisionerit Publik për sa kohë që nuk është ankimmuar prej këtij të fundit) se përfitimi i një pasurie paramartesorë dhe burimi i krijimit të saj nga personi i lidhur, nuk duhet të lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

- Në vendimin nr. 8, datë 25.6.2020, të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit, A.K., ka konfirmuar përsëri se subjekti nuk mund t’i kundrejtohet detyrimi për një pasuri,

nëse nuk shfaq kundrejt saj një marrëdhënie interesi sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

7.29 Për sa i përket analizës financiare në lidhje me krijimin e shtesës me sip. 70.40 m², të përfituar në vitin 2015 nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Komisioni administroi provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, duke përfshirë të ardhurat e ish-bashkëshortit nga qiraja, si dhe duke reflektuar ndryshimet përkatëse. Në përfundim analiza financiare rezultoi si vijon:

Analizë legalizim shtese, në rrugën “**” - A.B. - më 27.8.2015**

Të ardhura nga paga E. Imeraj deri më 27.8.2015	1 113 125
Të ardhura nga qiraja deri më 27.8.2015	790 480
Të ardhura nga dhurimi A.B.	568 953
Të ardhura dëmshpërblimi nga CEZ	5 032 084
Të ardhura nga shitja e motorit “****”	40 000
Të ardhura nga shitja e armës së gjahut	50 000
Të ardhura nga biznesi A.B. deri më 27.8.2015	
Të ardhura total	9 033 292
Shpenzime jetese deri më 27.8.2015	598 069
Shpenzime udhëtimi deri më 27.8.2015	150 648
Shpenzime arsimimi fëmijët deri më 27.8.2015	289 065
Shpenzime për fondin “SiCred” E. Imeraj	10 000
Dhënë hua S.Sh.	5 000 000
Dhënë hua G.H. – 2 000 euro	275 300
Shpenzim legalizim shtese pallati rr. “****”	1 601 426
Shlyerje kredi BKT, A.B. – 8 545 euro	1 176 244
Shpenzime ne total	9 100 752
Diferencë likuiditeti 27.8.2015 – 31.12.2014	-77 270
Total pasuri	-77 270
Mundësia financiare	9 810

7.30 Nga analiza financiare përfundimtare në lidhje me këtë pasuri rezulton se subjekti dhe ish- bashkëshorti kishin mundësi financiare për legalizimin e shtesës së kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

7.31 Kjo pasuri përfshihet në kontratën nr. ***, datë 27.3.2007, “Regjimi pasuror paramartesor, regjimi i pasurive të ndara”. Sipas kësaj kontrate marrëdhëniet e tyre pasurore i nënshtrohen regjimit pasuror të “Pasurive të ndara”.

7.32 Kjo shtesë përbën pasuri individuale të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Veprimet e kryera, ndër vite, për këtë pasuri janë bërë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si pronar, zotërues dhe përfitues i vetëm i saj.

8. Të ardhura me vendim gjyqësor në vlerën 4,729,804 lekë

8.1 Sipas vendimit, datë 21.1.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar dëmshpërblim nga kompania ***, ku vlera financiare është 4,729,804 lekë.

- 8.2** Sipas konfirmimit të “Raiffeisen Bank”, rezultoi se ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i ka kaluar në llogari bankare shuma prej 5,032,084 lekësh (më 2.3.2015), me përshkrimin “ekzekutim i vendimit gjyqësor”.
- 8.3** Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe të ardhurat e krijuara në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë, konfirmuar me veprime bankare për kalimin e shumës së dëmshpërblimit.

9. Të ardhura në vlerën 780,551 lekë nga fondi i emergjencave civile

- 9.1** Rezultoi se ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit sipas njoftimit të datës 22.12.2015, të Prefekturës Kukës, i është akorduar fondi prej 780,000 lekësh.
- 9.2** “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar arkëtimin e shumës prej 780,551 lekësh në llogarinë bankare të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
- 9.3** Me shkresën datë 23.5.2019, të Ministrisë së Mbrojtjes, është konfirmuar se ish-bashkëshortit të subjektit i është akorduar ndihmë financiare në shumën prej 780,551 lekësh.
- 9.4** Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këto të ardhura të përfituara nga fondi i emergjencave civile i dhënë nga institucionet shtetërore.

10. Shtëpi banimi kati 3, rruga “**”, Tiranë**

10.1 Bazuar në deklaramin e subjektit sipas deklaratës *Vetting* burimi i kësaj pasurie janë: *“Të ardhurat e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve të krijuara, ndër vite, fillimisht blerë trualli dhe banesa është ndërtuar pas saj. Banesa është ndërtuar në vitin 2006, aplikuar për legalizim në vitin 2006 dhe legalizuar në vitin 2011. Blerja e truallit dhe ndërtimi i banesës është bërë para martesës (sipas certifikatës së pronësisë për pasurinë tokë ku është ndërtuar banesa datës 2.5.2006, kontratë shitje trualli datë 19.4.2006, leje legalizimi dhe certifikatë pronësie për apartamentin, datë 27.9.2011, fatura tatimore për arkëtim, datë 12.11.2010). Toka është blerë në shumën 3,300,000 lekë. Legalizimi total për 5 kate është bërë në shumën 127,745 lekë”.*

10.2 Për të provuar deklaramet e saj, subjekti ka paraqitur këto dokumente:

- kontratë nr. ***, datë 27.3.2007, “Për regjimin e pasurive të ndara”, së bashku me praktikën shkresore të kësaj kontrate;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, apartament me sip. 157.9 m², në emër të z. A.B., lëshuar në datën 27.9.2011. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme;
- certifikatë për vërtetim pronësie, pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, truall me sip. 332 m², në emër të z. A.B., lëshuar në datën 2.5.2006 – bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme dhe hartë treguese;
- kontratë shitje (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 19.4.2006;
- leje legalizimi nr. ***, datë 29.3.2011, për objektin godinë banimi 5 kate, në emër të shtetasit A.B., z. k. ***, nr. pasurie ***, sip. e parcelës ndërtimore 285.1 m², sip. e ndërtimit 128.2 m², sip. e përgjithshme e ndërtimit për banim 759.8 m², numri i kateve mbi tokë, 5 – bashkëlidhur formulari i vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 8.8.2006;
- faturë për arkëtim nr. ***, datë 12.11.2010, si tarifë shërbimi dhe taksë për ndikim në infrastrukturë në shumën totale 127,745 lekë në favor të ALUIZNI-t, Qarku Tiranë;
- njoftim për formularët e pagesave nr. *** prot., datë 12.11.2010; vlera e investimit: 22,349,070 lekë; vlera e tarifës së shërbimit 8,000 lekë;

- deklaratë personale e shtetasit A.B.;
 - deklaratë për zbatimin e planit rregullues i pa firmosur;
 - kërkesë për përgatitjen e dosjes për legalizim për shtetasin A.B., datë 24.4.2009.
- 10.3** Bazuar në deklaratimet konsistente të subjektit të rivlerësimit, për shkak të martesës së saj në prill të vitit 2007, ka përdorur për banim katin e tretë të godinës 5-katëshe të ndodhur në ***, Tiranë.
- 10.4** Për këtë arsye, nga Komisioni u hetua për të verifikuar vërtetësinë e deklaratimit të subjektit për këtë pasuri, nga ku rezultoi se:
- 10.5** Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Tiranë rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi truall me sip. 332 m² me nr. pasurie ***, z. k. ***. Ky truall është blerë me kontratë shitje nr. ***, datë 19.4.2006, nga shtetasja V.Xh. për shumën 3,300,000 lekë, përfaqësuar me prokurë nga i biri.
- 10.6** Në datën 8.8.2006, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka plotësuar vetëdeklarimin nr. *** prot., duke deklaruar se ndërtimi për objektin “shtëpi banimi” në rr. “****” (***) është bërë në datën 3.3.2006. Sipërfaqja e zënë 332 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 160 m².
- 10.7** Në lidhje me ndërtimin e kësaj banese, është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka sqaruar se: *“Kjo banesë ka filluar dhe mbaruar ndërtimin e saj në vitin 2006. Në momentin e aplikimit tek ALUIZNI, sipas fotove shihet se është i mbaruar ... duke u përpiluar edhe akti i kolaudimit që po ua vendos në dispozicion. Kjo ndërtesë ka qenë e ndërtuar dhe e përfunduar në vitin 200, dhe pas këtij viti nuk janë bërë shpenzime për ndërtimin e saj përveç mirëmbajtjes së zakonshme”*.
- 10.8** Subjekti, në përgjigjen e saj, i referohet aktit të kolaudimit të gjendur në praktikën e legalizimit. Ky akt nuk ka datën e hartimit, por në të deklarohet se ndërtesa është ndërtuar në vitin 2006. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka depozituar asnjë dokumentacion për të vërtetuar se kjo banesë ka përfunduar në vitin 2006, prandaj nga Komisioni iu kërkua të paraqiteshin shpjegime dhe akte shkresore për të provuar këtë pretendim.
- 10.9** Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Tiranë, rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi pasurinë nr. ***, apartament me sipërfaqe 157.9 m², ndodhur në ***, Tiranë. Origjina e kësaj pasurie është leja e legalizimit.
- 10.10** Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri si adresë banimi, e cila duket se ka qenë në përdorim nga subjekti dhe ish-bashkëshorti që në vitin e martesës.
- 10.11** Krahas dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë pasuri, janë kërkuar shpjegime nga ana e subjektit në lidhje me kostot e ndërtimit të saj. Në përgjigje subjekti ka sqaruar se: *“Kjo shtëpi banimi është ndërtuar në vitin 2006 dhe ndërtimi i saj ka nisur në datën 3.3.2006. Në këtë periudhë nuk kam qenë ende e martuar me bashkëshortin tim A.B. Sipas vërtetimit të lëshuar nga ALUIZNI, rezulton se në lidhje me këtë banesë është aplikuar për legalizim në datën 8.8.2006. Ndërkohë, unë jam martuar me A.B. në datën 26.4.2007, sipas certifikatës së martesës pjesë të deklaratimit tim.*

Për këtë fakt, aktualisht unë jam përdoruese e kësaj banese, për shkak të martesës me shtetasin A.B., dhe jo pronare e saj. Bazuar në periudhën e ndërtimit dhe kontributin e dhënë, unë nuk kam qenë kurrë investuese dhe kësaj s'mund të bëhem asnjëherë pronare e saj.

Në periudhën kur unë jam martuar dhe kam filluar të jetoj në këtë banesë ajo ka qenë plotësisht e përfunduar. Burimi i të ardhurave për ndërtimin e kësaj banese kanë qenë të ardhurat e bashkëshortit dhe familjareve të tij”.

- 10.12** Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit për kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe nga UKT-ja rezultoi se kontratat për kryerjen e shërbimeve si abonent janë lidhur nga familjarët e ish-bashkëshortit të subjektit para datës së martesës.
- 10.13** Komisioni bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti i rivlerësimit dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit krijoi bindjen se kjo pasuri është krijuar nga ish-bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij para periudhës së martesës.
- 10.14** Ndërkohë rezultoi e pasqyruar se në të gjitha deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, është përcaktuar se vetëm kati i tretë i banesës është i ish-bashkëshortit të saj, duke përcaktuar dhe një vlerë për ndërtimin e këtij kati në shumën 4,000,000 lekë. Sipas deklarimeve të bëra në DPV dhe deklaratën Vetting, (përfshirë edhe Pyetësorin e datës 30.5.2019) banesa është ndërtuar brenda vitit 2006, për rrjedhojë, investimet për krijimin e saj janë bërë përpara lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit.
- 10.15** Bazuar në kontratën nr. ***, datë 27.3.2007, “Për regjimin e pasurive të ndara”, rezultoi e përcaktuar se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit (deri në datën e përpilimit të kësaj kontrate mars 2007), së bashku me familjarët e tij (vëllezërit), kishin përfunduar së ndërtuari me kontribute të përbashkëta, një ndërtesë 5-katëshe, me përdorim secili prej tyre nga një kat të ndërtesës. Në këtë kontratë të përpiluar para lidhjes së martesës, provohet se kjo ndërtesë ka përfunduar para lidhjes së martesës dhe investimi i saj është bërë mbi të ardhura që nuk shfaqin ndonjë lidhje apo kontribut të subjektit të rivlerësimit.
- 10.16** Përveç periudhës së krijimit të kësaj ndërtesë, nga gjithë hetimet e kryera nga Komisioni, nuk u administrua dhe nuk u zotërua ndonjë akt përmes të cilit subjekti i rivlerësimit të ketë pronësi në ndonjë lloj mënyre pasurine e mësipërme (katin e tretë të ndërtesës), apo të ketë përfiturar të ardhura nga kjo ndërtesë. Në përgjigje të pyetësorit, pas njohjes me rezultatet e hetimit¹³ dhe në kuadër të përgjigjeve të dhëna, u dëshmuar se pas zgjidhjes së martesës nga subjekti nuk përdoret më as e drejta e banimit të subjektit ndaj kësaj pasurie, duke u provuar edhe njëherë fakti se nuk mund të ngarkohet dot me përgjegjësi për deklaratimet e ish-bashkëshortit.

10.17 Konkluzioni i Komisionit

- Subjekti ka qenë e saktë dhe konsistente në deklarin e kësaj pasurie (pasuri në përdorim kati i 3) që nga deklarata para fillimit të detyrës, në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve dhe në rezultatet e hetimit, si për objektin, sipërfaqen që disponon dhe për vlerën e saj.
- Burimi i krijimit janë evidentuar nga të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij të krijuara ndër vite. Fillimisht është deklaruar se është blerë truall dhe banesa është ndërtuar, më pas, deri në vitin 2006. Në vitin 2006 rezultoi se është aplikuar për legalizimin e kësaj banese dhe në vitin 2011 kjo banesë është legalizuar.
- Blerja e truallit dhe ndërtimi i banesës është bërë para martesës (sipas certifikatës së pronësisë për pasurinë tokë ku është ndërtuar banesa më 2.5.2006, kontratë shitje truall, datë 19.4.2006, kontrata “Për regjimin pasuror martesor”,

¹³Shihni rezultatet e hetimit të Komisionit dërguar subjektit të rivlerësimit.

vetëdeklarimi për legalizim, leja e legalizimit dhe certifikata e pronësisë për apartamentin, datë 27.9.2011, faturë tatimore për arkëtim më 12.11.2010).

- Toka është blerë në shumën 3,300,000 lekë. Vlera për ndërtimin e katit të 3-të, sipas DVP/2007 është në shumën prej 4,000,000 lekësh. Legalizimi total është bërë në vlerën 127,745 lekë.
- Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Tiranë rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi pasurinë me nr. ***, apartament me sip. 157.9 m², ndodhur në ***, Tiranë. Origjina e kësaj pasurie është leja e legalizimit.
- Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri si adresë banimi (katin e tretë të objektit 5-katësh), e cila duket se ka qenë në përdorim nga subjekti dhe ish-bashkëshorti në vitin e martesës.
- Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit për kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe nga UKT-ja, duket se kontratat për kryerjen e shërbimeve si abonent janë lidhur nga familjarët e ish-bashkëshortit të subjektit para datës së martesës.
- Komisioni bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti i rivlerësimit dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit krijoi bindjen se kjo pasuri është krijuar nga ish-bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij para periudhës së martesës.
- Kjo pasuri përfshihet në kontratën nr. ***, datë 27.3.2007, “Regjimit pasuror paramartesor, regjimi i pasurive të ndara”. Sipas kësaj kontrate marrëdhëniet e tyre pasurore i nënshtrohen regjimit pasuror atë të “Pasurive të ndara”.
- Pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë në lidhje me burimin e të ardhurave për komplet objektin ndërtimor, duke marrë shkas nga fakti se subjekti ka deklaruar në përdorim vetëm katin e tretë dhe se edhe bashkëshorti ka deklaruar në pronësi personale, po vetëm katin e tretë, rezultoi se deklarimi ka qenë konsistent përgjatë gjithë deklaratave të bëra nga subjekti dhe ish-bashkëshorti. Veçanërisht, edhe në deklaratën *Vetting*, ku bashkëshorti i subjektit ka vepruar në ndarjen dhe në regjistrimin e godinës në apartamente, duke deklaruar pronësinë reale të vëllezërve për secilin kat dhe e përfunduar kjo procedurë me dhurimin e këtyre apartamenteve vëllezërve, sipas perkatësisë pronësore të deklaruar në deklaratën *Vetting*, përjashton subjektin nga çdo lloj përgjegjësie mbi problematikën për godinën në tërësi, duke pasur përgjegjësi vetëm për katin e tretë të godinës së deklaruar prej saj, si adresë banimi dhe, njëkohësisht, si në pronësi personale të bashkëshortit.
- Komisioni konstatoi se veprimet e kryera, ndër vite, për këtë pasuri janë bërë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si pronar dhe përfitues i vetëm i kësaj pasurie.
- Komisioni ka mbajtur parasysh faktet objektive dhe ligjore në lidhje me këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit përveç situatës faktike në raport me apartamentin e ndodhur në katin e tretë, të krijuar për shkak të martesës, nuk ka patur raporte të tjera me këtë pasuri.

Ish bashkëshorti dhe familjarët e tij nuk gëzojnë statusin e personit të lidhur të subjektit në kohën e krijimit të të gjithë pasurisë, sipas Ligjit nr. 84/2016.

10.18 Në përfundim të hetimit të kryer mbi këtë pasuri, duke mbajtur në konsideratë edhe arsyetimin e bërë në pikën 7.28 të këtij vendimi, si edhe faktet e rezultuara të

provuara në lidhje me këtë pasuri, Komisioni gjeti të sakta deklaratimet e subjektit të rivlerësimit¹⁴ dhe nuk konstatoi problematika në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

11. Pasuri e paluajtshme në rrugën “**”, Tiranë**

- 11.1** Pasuria e ndodhur në rr. “****”, Tiranë, p. ***, shk. ***, ap. ***, k. ***, është deklaruar në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, e krijuar përmes kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 4.1.2008, në vlerën prej 500,000 lekësh, shitur nga vëllai A.B. tek ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.
- 11.2** Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga veprimtaria e punësimit (certifikatë pronësie me nr. ***, datë 28.1.2008, banesa është blerë nga A.B. në datën 28.12.1996, sipas kontratës së kësaj date nga të ardhurat familjare).
- 11.3** Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka dorëzuar këto dokumente:
- kontratë nr. ***, datë 27.3.2007, “Për regjimin e pasurive të ndara”, së bashku me praktikën shkresore të kësaj kontrate;
 - certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k ***, apartament me sip. 73 m², me adresë, rr. “****”, p. ***, shk. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, në emër të A.B., lëshuar në datën 28.1.2008 – bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme;
 - kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme (apartament banimi) nr. ***, datë 4.1.2008, shitës A.B. dhe S.B., blerës A.B.;
 - kontratë shitblerje nr. ***, datë 28.12.1996;
 - deklaratë noteriale A.B., mbi likuidimin e çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie.
- 11.4** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se me kontratë shitblerje nr. ***, datë 4.1.2008, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë nga vëllai A.B. dhe bashkëshortja S.B., apartamentin me sip. 73 m², për shumën 500,000 lekë. Bazuar në këtë kontratë nga ana e palëve deklarohet se pronar ekskluziv dhe i pakontestueshëm i këtij apartamenti është ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) në BKT.
- 11.5** Referuar kontratës “Për regjimin e pasurisë martesore, të pasurive të ndara”, përcaktohet se para lidhjes së martesës, ndër të tjera, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe familjarët e tij, kanë në pronësi apo kanë fituar të drejta reale mbi disa pasuri të paluajtshme, përfshirë këtu edhe një pasuri me sip. 73 m², të ndodhur në rr. “****”. Megjithëse kjo pasuri përbën pasuri vetjake të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij të krijuar para martesës, subjekti e ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie nga ish-bashkëshorti, me qëllim vendosjen e saj si kolateral për marrjen e një kredie nga ky i fundit (ish-bashkëshorti) në BKT.
- 11.6** BKT-ja¹⁵ ka vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë për përfitimin e kredisë së z. A.B. në shumën 100,000 euro, ku konfirmohet se kolateral për marrjen e kësaj kredie është vendosur ky apartament.
- 11.7** Në lidhje me mundësinë e krijimit të kësaj pasurie në datën 4.1.2008, Komisioni konstatoi se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ndodhej në pamundësi për të paguar vlerën e kësaj pasurie në shumën prej 500,000 lekë.
- 11.8** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti¹⁶ ka sqaruar, ndër të tjera, se pasuria me sipërfaqe 73 m² e ndodhur në rr. “****”, është krijuar nga ish-bashkëshorti dhe

¹⁴Shihni përgjigjet e dërguara nga subjekti mbi rezultatet e hetimit.

¹⁵Shihni përgjigjen e BKT-së në dosjen e ILDKPKI-së dhe në dosjen e Komisionit.

¹⁶Shihni rezultatet e hetimit të Komisionit dërguar subjektit të rivlerësimit.

vëllezërit e tij, që në vitin 1996. Qëllimi i kalimit të kësaj pasurie në pronësi të ish-bashkëshortit të saj është bërë përdorimi i saj si kolateral nga ish-bashkëshorti për disbursimin e një kredie në BKT.

Në lidhje me pagimin e çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie, subjekti sqaron se për shkak ngutshmërie dhe kërkesë të bankës ish-bashkëshorti me vëllain e tij, kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes dhe për efekt regjistrimi të saj, ishte e domosdoshme që të deklarohet i likuiduar çmimi i shitblerjes, ndërkohë që likuidimi i plotë i saj, është bërë përgjatë vitit 2008, kur edhe mundësitë financiare të ish-bashkëshortit konstatohet që janë evidente. Për shkak të lidhjeve të posaçme mes tyre (vëllezër), likuidimi i vlerës 500,000 lekë është rënë dakord të bëhet përgjatë vitit. Për këtë arsye, sikurse subjekti ka deklaruar në të gjithë pyetësorët në lidhje me prezantimin e kësaj pasurie ajo është krijuar që në vitin 1996 dhe procedurat e ndjekura për shitblerjen e saj kanë pasur regjim të posaçëm midis vëllezërve.

Në përfundim të sqarimeve mbi këtë pasuri janë dorëzuar dhe administruar edhe deklarimi i shtetasit A.B., i cili konfirmon shpjegimet e subjektit, mbi likuidimin e çmimit të pasurisë përgjatë vitit 2008.

11.9 Konkluzion i Komisionit

- Në vlerësimin e kësaj pasurie, duke mbajtur në konsideratë konstatimet dhe arsyetimin e bërë në pikën 7.28 të vendimit, si edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi marrëdhëniet e posaçme mbi këtë pasuri. Subjekti nuk ka asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri dhe as ka realizuar përfitime prej saj. Deklarimet e dhëna në lidhje me këtë pasuri janë gjendur të sakta.
- Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri dhe subjekti ka bërë deklaram të saktë në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

12. Pasuri e paluajtshme tokë me sip. 2500 m², në ***, Tiranë

12.1 Rezultoi se kjo pasuri është përfituar me anë të kontratës së shkëmbimit të datës 7.11.2012. Burimi i krijimit: shkëmbimi i tokës së ndodhur në ***, Tiranë, blerë në vitin 2006 - 2007.

Objekti i kontratës është shkëmbimi i sipërfaqes në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit prej 532 m², 532 m² dhe 400 m², në ***, Tiranë, me sipërfaqen prej 2,500 m² në pronësi të shtetasit P.K., në ***, Tiranë.

Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2006 – 2007 ka blerë pasuritë e mëposhtme:

- me kontratë nr. ***, datë 2.10.2006, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë tokë arë me sipërfaqe 532 m² ndodhur në *** me çmim 1,750,000 lekë. Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie, datë 16.10.2006, kjo pasuri ka nr. *** z. k. ***;
- me kontratë nr. ***, datë 21.2.2007, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë tokë arë me sipërfaqe 532 m², ndodhur në ***, me çmim 1,700,000 lekë – bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie, datë 27.2.2007, kjo pasuri ka nr. *** z. k. ***;
- me kontratë nr. ***, datë 26.6.2007, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë tokë arë me sipërfaqe 400 m² ndodhur në ***, me çmim 1,000,000 lekë – bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie, datë 13.7.2007, kjo pasuri ka nr. ***, z. k. ***.

12.2 Rezultoi se dy nga këto pasuri të paluajtshme janë blerë para martesë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me pasurinë me sipërfaqe prej 400 m², me çmim 1,000,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata e shitblerjes në datën 13.7.2007, rezultoi nga hetimi se për këtë pasuri ndërmjet ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shitëseve, është lidhur një deklaratë në tetor të vitit 2006, në të cilën konfirmohet likuidimi i çmimit të kësaj pasurie në këtë datë, por kalimi në pronësi edhe formalisht i saj, do të bëhet sapo ajo të jetë e gatshme për t'u shitur.

Për këtë fakt, subjekti ka dorëzuar edhe kontratën “Për regjimin pasuror martesor”, në të cilën konfirmohet se ish-bashkëshorti ka në pronësi (së bashku me vëllain e tij) tri parcela në ***, Tiranë. Pjesë e kësaj kontrate gjendet edhe deklarata e palëve e cila provon se pagesa e kësaj parcele është bërë në vitin 2006, para lidhjes së martesës.

12.3 Subjekti ka deklaruar që të tria sipërfaqet e tokës arë, janë pasuri para martesë dhe ish-in në bashkëpronësi faktike mes shtetasve A. dhe A.B. Kontributet financiar për blerjen e këtyre pasurive kanë qenë të z. A.B. me të ardhura nga emigracioni dhe ish-bashkëshortit të subjektit. Kontributi i ish-bashkëshortit të subjektit deklarohet se ka qenë në masën 50% (në vlerën 500,000 lekë), por përtej deklarimeve nuk zotërohet dokumentacion.

Bazuar në analizën financiare për pasuritë e krijuara para martesë rezultoi se ish-bashkëshorti i subjektit ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.

12.4 Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë rezulton se në datën 18.10.2012 është lidhur midis z. A.B. dhe z. P.K. aktmarrëveshje (për shkëmbim pasurie të paluajtshme) nr. ***, në këtë aktmarrëveshje parashikohet se:

*“Z. P.K. rezulton pronar mbi pasurinë me sipërfaqe 10.100 m² me nr. ***, z. k. ***, ndërsa ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezulton pronar mbi pasuritë e ndodhura në ***.*

Shtetasi P.K. premtos të shkëmbejë sipërfaqen prej 2.500 m² si pjesë e tërësisë së sipërfaqes 10100 m², kundrejt pasurive të regjistruara në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Palët bien dakord që do të shkëmbejnë pasuritë respektive pa kundërshpërblim dhe se kontrata e shkëmbimit do të lidhet më datë 15.11.2012”.

Në lidhje me këtë shkëmbim duket se nuk plotësohen kushtet e një shkëmbimi ekonomik të arsyeshme për sa kohë vlera e tokës së përfituar nga subjekti i rivlerësimit është më i lartë se vlera e tokës së dhënë në këmbim.

12.5 Në lidhje me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Bashkëshorti im A.B. ka kryer disa shërbime avokatie në favor të shtetasit P.K. dhe për këtë qëllim ata kanë parashikuar si formë shpërblimi shumë prej 80,000 euro, e cila në rast mosshlyerje do të kompensohet me shkëmbimin e pasurive të ndodhura në ***, Tiranë, me atë të ndodhur tek ***, Tiranë. Pikërisht kjo shumë e parashikuar me vullnet të plotë si garanci, ka shërbyer si kompensim për shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të mësipërme. Ky është dhe arsyeja ekonomike në lidhje me këtë fakt. Madje për këtë situatë, bashkëshorti ka një marrëveshje me shtetasin P.K., të cilën po ua vë në dispozicion”.*

12.6 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer veprimet e mëposhtme me z. P.K.

- Nga noteri publik Xh.O. është administruar akti i mëposhtëm:

Në datën 3.7.2012 është nënshkruar deklaratë (për lidhjen e marrëveshjes kontraktuale të shërbimit) midis z. P.K. dhe ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Në këtë marrëveshje deklarohet se: “Z. P.K. njeh detyrimin prej 80,000 euro si shërbim i kryer nga ana e z. A.B.. Ai merr përsipër ta konsiderojë hua të dhënë pa interes sasinë monetare prej 80,000 eurosh dhe garanton pagesën e saj në të holla apo dhe në ndonjë mënyrë tjetër...siç mund të jetë shkëmbimi apo dhe dhurimi...Në cilësinë e porositësit P.K. merr përsipër të përpilojë kontratë huaje duke njohur shumën deri në 80,000 euro si hua të marrë pa interes nga avokati A.B.. Gjithashtu z. P.K. merr përsipër të bëj marrëveshje në rast mospagesës së shërbimit për avokatin për shkëmbimin e 2500 m² tokë pasuri e paluajtshme e ndodhur tek *** me nr. hipotekor ***, datë 23.9.2010, në z. k. *** nr. pasurie *** me pasuritë e paluajtshme në pronësi të A.B. të ndodhur në ***, Tiranë, me nr. ***, *** dhe ***, z. k. ***”.

Nënshkrimi i kësaj deklarate është vërtetuar nga noteri publik me vërtetim nënshkrimi nr. ***.

- Nga noteri publik D.K. janë administruar aktet e mëposhtme:

Në datën 1.8.2012, me kontratën e huamarrjes nr. ***, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka dhënë hua shumën 80,000 euro, shtetasve P.K. dhe Xh.K.

Në këtë kontratë deklarohet se: “Z. A.B. është posedues i një shume prej 80,000 euro...”. Në nenin 4 të kësaj kontrate parashikohet se huaja duhet të kthehet plotësisht brenda datës 15.12.2012, në rast se kjo shumë nuk do të kthehet në këtë afat pala huamarrëse do të vinte si garanci pasurore për kthim e shumës apartamentin banimi me sip. 147 m² nr. pasuri ***, z. k. ***, ndodhur në Rrugën e Kavajës, Tiranë.

Në datën 7.11.2012, me deklaratë noteriale nr. ***, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi se në datën 7.11.2012, ka marrë nga z. P.K. shumën prej 80,000 euro.

12.7 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Kjo hua nuk është dhënë ndonjëherë dhe nuk është marrë ndonjëherë si qarkullim vlerash monetare, por është njohur si e tillë për shkak të shërbimeve që bashkëshorti ka kryer karshi shtetasit P.K., në një dokument shtese për të mbrojtur interesat e tij. Kjo ka qenë dhe arsyeja e mospasqyrimin të saj si hua ne deklaratën Vetting. Mbi këtë sqarim, rrjedh dhe fakti që P.K. nuk i ka paguar ndonjëherë 80,000 euro”.

12.8 Duke qenë se vlera e shërbimit të kryer nga ish-bashkëshorti i subjektit nuk është faturuar, në analizën financiare nuk do të përfshihet kjo shumë, por vlera e pasurisë së përfituar nga shkëmbimi në ***, referohet e barabartë me vlerën e pasurisë së këmbyer në ***, bazuar në deklarimin e subjektit në deklaratën Vetting dhe në kontratën e shkëmbimit.

12.9 Në datën 23.4.2014, është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, midis ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “***”, sh.p.k., për sipërfaqen truall 2360 m². Bazuar në këtë kontratë ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit do të përfitojë nga kjo marrëveshje 37% të sipërfaqes së ndërtimit. Ndarja do të kryhet në planvendosje horizontale. Pjesa takuese e tij është si vijon:

- 37% sipërfaqe ndërtimi për katin e nëndheshëm ose i quajtur ndryshe kati-1 e përcaktuar gjithsej 360 m²;
- sipërfaqen e plotë të katit të parë mbi sipërfaqen e tokës kati 0;
- sipërfaqen e plotë të katit të dytë mbi sipërfaqen e tokës kati 1;
- sipërfaqen e plotë të katit të tretë mbi sipërfaqen e tokës kati 2;
- sipërfaqen e plotë të katit të tretë mbi sipërfaqen e tokës kati 3 deri në masën sa sipërfaqja e ndërtimit të arrijë vleftën e përcaktuar 37%.

- 12.10** Në datën 5.4.2017, me kontratë dhurimi nr. ***, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka dhuruar vëllait të tij A.B. ½ e pasurisë me nr. *** (truall me sip. 2290.3 m², për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes), në këtë kontratë parashikohet se:

*“Pasuria nr. ***, objekti i kësaj kontrate është fituar nga shkëmbimi me 3 pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të z. A.B. në vitet 2006 – 2007 (pasuri të blera realisht me kontributet e A.B.t dhe vëllait të tij A.B., por ky i fundit jo prezent në Shqipëri për të nënshkruar aktet noteriale duke qenë se A.B. jeton dhe punon në Angli që prej vitit 1997). Me regjistrimin e kontratës së shkëmbimit në vitin 2012, në mungesë të A.B.t është lëshuar certifikata e pasurisë në emër të A.B. me nr. ***. Mbi pasurinë nr. ***, objekt i kësaj kontrate është ndërtuar strukturë banimi dhe shërbimi 4-11-12 kate me 2 kate parkim nëntokë sipas vendimit nr. ***, datë 30.7.2014, për Miratimin e Lejes zhvillimore të ndërtimit të lëshuar nga Bashkia Tiranë dhe Leje Zhvillimore të Ndërtimit nr. ***, datë 13.10.2014, me zhvillues dhe ndërtues shoqërinë ‘***’ sh.p.k., pasi pala dhuruese ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 23.4.2014, me të cilën është arritur marrëveshja që në objektin e ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse mbi këtë truall pala pronare e truallit të përfitojë 37% të sipërfaqes ndërtimore. Në këto kushte palët kanë vendosur të nënshkruajnë këtë kontratë dhurimi me qëllim rregullimin e pronësisë për pasurinë objekt të kësaj kontrate. Ky veprim juridik kryhet me qëllim barazimin e situatës faktike me situatën juridike si dhe për pasqyrimin real të pronësisë së shtetasit A.B. mbi truallin ½ pjesë dhe mbi pjesën takuese të sipërfaqes ndërtimore në objektin e ndërtuar mbi këtë truall (1/2 e 37%=18.5%) të cilat derivojnë nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë ‘***’ sh.p.k.”.*

- 12.11** Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me konstatimet e Komisionit gjatë fazës së hetimit administrative, e cila ka sqaruar se:

*“Arsyeja e dhurimit lidhet me faktin se pasuritë në *** janë blerë me të ardhurat jo vetëm të bashkëshortit tim, por dhe me ato të vëllait të tij A.B.. Këto tre pasuri janë shkëmbyer me pasurinë prej 2500 m², të ndodhur tek ***, Tiranë. Pasuritë e paluajtshme të ndodhura në ***, janë blerje të kryera nga bashkëshorti im para lidhjes së martesës, përkatësisht në vitin 2006 – 2007. Rezulton se për blerjen e këtyre pasurive janë nënshkruar kontratat e datës 2.10.2006 dhe 21.2.2007. Duke qenë se nga akt verifikimi i kryer në ZVRPP Tiranë, dhe në terren, sipërfaqja reale për një nga pasuritë ishte më e madhe sesa ajo e pasqyruar në dokumentacionin e pronësisë, për sipërfaqen prej 400 m², shitblerja formalisht është shtyrë për në datën 26.6.2007, sapo është lëshuar certifikata e saktësuar. Mbi këtë rrethanë është nënshkruar paraprakisht edhe deklarata mes palëve e datës 2.10.2006, për premtimin e shitjes së kësaj pasurie. Duke qenë se këto kontrata janë kryer para lidhjes së martesës time, unë nuk jam për asnjë moment pronare e këtyre pasurive ...”.*

- 12.12** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratë për premtim shitje pasuri e paluajtshme tokë arë të datës 2.10.2006. Në këtë deklaratë shtetasit D. dhe S.K. deklarojnë se sipas një marrëveshje verbale me shtetasit A.B. dhe A.B. kanë renë dakord t’i shesin 932 m² tokë për çmimin 2,750,000 lekë, këto pasuri janë shitur faktikisht dhe jemi likuiduar plotësisht me ta.

- 12.13** Në datën 7.6.2017 është nënshkruar aneks kontratë sipërmarrjeje (nr. ***, datë 23.4.2014) nr. ***, midis shtetasve A. dhe A.B. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në të cilin pasqyrohet ndryshimi i pronarëve të truallit duke u shtuar dhe z. A.B., i cili përfiton 18.5 të sipërfaqes së ndërtimit ndërsa 18.5% tjetër i takon z. A.B..

12.14 Në datën 29.6.2017 është nënshkruara kontrata e shkëmbimit të truallit me nr. ***, midis ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., me dhënës pëlqimi dhe z. A.B. në cilësinë e bashkëpronarit në bazë të kësaj kontrate ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

Në këmbim shoqëria do të marrë në pronësi ½ pjesë të pandarë të truallit me sipërfaqe totale 2290.3 m² me nr. pasurie ***, z. k. ***. Të gjitha pasuritë e mësipërme rezultojnë të regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Ish-bashkëshorti i subjekti i rivlerësimit ka pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sip. 140 m² (pasuria e ndarë nga pjesa prej 2500 m²) nga kartela e pasurisë rezulton se kjo pasuri është në bashkëpronësi me z. A.B. Në datën 23.4.2018 me kontratë dhurimi nr. ***, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka dhuruar vëllait të tij z. A.B. ½ pjesë ideale të pasurisë llojit truall me sip. 69.7 me nr. pasurie ***, z. k. *** dhe 140 m² me nr. pasurie ***, z. k. *** ndodhur në ***.

12.15 Në përgjigje të pyetorit të fundit subjekti ka deklaruar: *“Nuk kam qenë asnjëherë pronare apo bashkëpronare e pasurisë të *** dhe as kam përfiturar të drejta reale mbi këtë pasuri apo shkëmbimin e saj. Kjo pasuri i është nënshtruar regjimit pasuror të ndarë sipas kontratës për regjimin pasuror. Me subjektin “****” nuk kam qenë palë kontraktore.*

*Ish-bashkëshorti im ka përfiturar pasuri me anë të kontratës së shkëmbimit dhe këto janë pasuri individuale/vetjake të tij dhe jo në bashkëpronësi, si dhe për këtë ju vë në dispozicion dokumentacionin që disponoj. Me z. K. ish-bashkëshorti ka pasur një marrëdhënie kontraktuale “kontrata nr. ***, datë 21.06.2007.*

Për të gjitha këto shërbime, në asnjë moment nuk ka përfiturar asnjë shpërblim për punën e kryer, për shkak të paaftësisë paguese të palës porositëse. Këtë fakt e vërteton dhe nga lëvizjet në llogarinë e tij bankare ku nuk rezulton asnjë derdhje e kryer nga ana e shtetasit P.K.

*Në kushtet si më sipër, kur mbi shërbimet e dhëna nga viti 2007 deri në janar të vitit 2013 (kohë pas të cilës ka marrë licencën për ushtrimin e detyrës së noterit), nuk ka përfiturar asnjë shpërblim, atëherë me vullnetin të përbashkët ka nënshkruar një deklaratë (me vërtetim nënshkrimi të noterit Xh.O. me nr. ***, datë 3.7.2012). Në këtë deklaratë shtetasi P.K. për të gjithë punën e kryer (për rreth 6 vite), dhe të pa shpërblyer deri në atë moment e në vazhdim, ka njohur një detyrim total prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro.*

*Me nënshkrimin dhe regjistrimin në ZVRPP-në Tiranë, të kontratës së shkëmbimit me nr. ***, datë 7.11.2012, janë shuar përfundimisht të gjitha detyrimet ekzistuese dhe të derivuara nga kontrata e porosisë.*

*- Këto pasuri (pasuritë e ndodhura në ***) i nënshtrohet regjimit pasuror të ndarë sipas kontratës nr. ***, datë 27.3.2007, së lidhur me ish-bashkëshortin.*

- Sipas kësaj kontrate të gjitha pasuritë e krijuara para martesë do të vijojnë të mbeten vetjake;

- Në këtë kontratë janë përcaktuar disa pasuri të paluajtshme të krijuara nga ish-bashkëshorti para martesë ndër të cilat dhe pasuritë në fjalë.

- Pasuria me sipërfaqe 400 m² është likuiduar dhe blerë në datën 2.10.2006, para lidhjes së martesës.

- Lidhur me mundësitë financiare kam dhënë shpjegime dhe prova ku rezulton se pasuritë e përfituara nga ish-bashkëshorti para martesë, janë krijuar me burime të ligjshme”.

12.16 Konkluzion i Komisionit

- Nuk rezultoi që subjekti të këtë kryer veprime për këto pasuri apo të jetë përfituese e tyre.
- Sipërfaqet e tokës së ndodhura në ***, rezultojnë të jenë blerë nga ish-bashkëshorti, para martesës së subjektit, datë në të cilën sipas kontratës është bërë dhe likuidimi i sasisë monetare. Përfshirë edhe sipërfaqen e tokës prej 400 m², të blerë për çmimin 1,000,000 leke, për të cilën deklarata e muajit tetor 2006 si dhe praktika e kryer në ish ZVRPP Tirane, për të sistemuar problematikat me këto pasuri (filluar që në vitin 2006) krijojnë bindjen se çmimi i blerjes është paguar që në tetor 2006), para martesës së subjektit të rivlerësimit.
- Komisioni konstatoi disa pasaktësi lidhur me deklarinimin për këto pasuri por veprimet janë kryer vetëm nga ish-bashkëshorti i subjektit si pronar i vetëm i këtyre pasurive të krijuara para martesë dhe të përfshira në kontratën për regjimin pasuror të pasurive të ndara.
- Në vlerësimin e kësaj pasurie lidhur me burimin e ligjshëm dhe përgjegjësinë e subjektit Komisioni i referohet dhe praktikës së Komisionit dhe Kolegjit¹⁷.
- Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri dhe subjekti ka bërë deklarinim të saktë në përputhje me pikë 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

13. Pasuri e paluajtshme në *, Durrës**

13.1 Ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar pasuri me sip. 61 m², në emër të tij, por në pronësi të vëllait A.B. Kjo pasuri rezultoi e blerë sipas kontratës së shitblerjes së datës 14.10.2005, në vlerën 2,000,000 lekë. Zotëron: 0%. Në pronësi reale A.B.

13.2 Rezultoi se kjo pasuri është blerë dhe regjistruar në ZVRPP-së Durrës, nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit para martesë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: të ardhurat e përfituara në emigracion nga A.B. (bilanc tregtar A.B. Blerë me këste në shumën 2,000,000 lekë, nga të cilat 1,000,000 lekë janë dhënë në datën 14.10.2005 dhe 1,000,000 lekë janë dhënë në datën 4.1.2006, sipas deklaratës së datës 4.1.2006 me nr. ***. Pjesë e bërë totalisht nga A.B., por në emër të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

13.3. Subjekti, për të provuar deklarinimet e saj, ka paraqitur:

- vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. 2, datë 19.1.2006, është i regjistruar apartament me sip. 61 m² me adresë ***, Durrës në emër të A.B., lëshuar në datën 16.1.2006;
- kontratë shitje nr. ***, datë 14.10.2005, për apartament 1+1 dhe ambiente ndihmëse, me sip. 61 m², ndodhur në ***, shk. ***, k. ***, nr. ***;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.1.2006;
- kontratë nr. ***, datë 27.3.2007, “Për regjimin e pasurive të ndara”, së bashku me praktikën shkresore të kësaj kontrate.

13.4. Në datën 14.10.2005, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me kontratë nr. ***, ka blerë një apartament me sip. 61 m² në ***, Durrës. Bazuar në kontratën e blerjes

¹⁷Shihni pikën 7.28 në këtë vendim.

rezulton se çmimi është 2,000,000 lekë ku 1,000,000 lekë janë likuiduar në prezencë të noterit ndërsa shuma tjetër do të likuidohej brenda datës 15.2.2006. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 4.1.2006, shitësit e apartamentit deklarojnë se në prezencë të noterit kanë marrë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit shumën 1,000,000 lekë. Nga subjektit të rivlerësimit nuk provohet me dokumentacion ligjor që z. A.B. ka kontribuar në blerjen e këtij apartamenti.

13.5 Në datën 3.2.2017, me kontratë dhurimi nr. ***, subjekti i rivlerësimit i ka dhuruar vëllait A.B. këtë apartament. Në këtë kontratë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklarohet se: *“Pasurinë e mësipërme z. A.B. e ka blerë në vitin 2005 para martesës pasuri të cilën e ka blerë me të ardhurat për llogari të pranuesit të dhurimit i cili për efekt emigrimi nuk ka qenë fizikisht për blerjen e pasurisë së mësipërme...”*.

13.6 Në lidhje me këtë pasuri i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit, e cila deklaron se: *“Kjo banesë është blerë në vitin 2005 për llogari të vëllait të bashkëshortit tim A.B. Kjo blerje i referohet një periudhe të hershme, para se të lidhja martesë me bashkëshortin tim. Në vijim ju vëmë në dispozicion, dhe kontratën e dhurimit nr. ***, datë 3.2.2017, me të cilën kjo pasuri nga bashkëshorti im i ka kaluar vëllait të tij, duke barazuar kështu situatën faktike me atë ligjore. Në deklaratën e vitit 2007, kjo pasuri ka qenë në emrin e bashkëshortit dhe nga ime është pasqyruar situata ligjore. Me vonë është bërë dhe prezantimi i situatës faktike. Burimi i krijimit të saj është nga të ardhurat e ligjshme të shtetasit A.B. në emigracion, për të cilat iu vëmë në dispozicion dokumentet përkatës.*

Kjo banesë është dhënë me qira në vlera të vogla, shuma të cilat janë shpenzuar për nevoja familjare të familjareve të bashkëshortit. Duke pasur parasysh se këto të ardhura faktikisht nuk janë të ardhura të miat dhe të familjes sime, nuk janë përsëritur në deklaram”.

13.7 Për aq sa referohet nga subjekti i rivlerësimit, kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar para martesës së saj. Në deklaratat periodike vjetore, por edhe në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti për llogari të vëllait A.B., emigrant në Angli. Në lidhje me këtë subjekti ka sqaruar se prezantimi i bërë prej saj në deklaratën periodike është prezantim i situatës ligjore sipas certifikatës së pronësisë, ndërkohë që situata ligjore në vitet në vijim është përputhur me situatën faktike.

13.8 Për të gjitha konstatimet e evidentuara dhe gjetjet e Komisionit për këtë pasuri të paluajtshme, subjektit iu kërkuar shpjegime¹⁸, e cila, në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁹, deklaroi se: *“Kjo pasuri i nënshtrohet regjimit pasuror të ndarë sipas kontratës nr. ***, datë 27.3.2007, së lidhur me ish-bashkëshortin. Sipas kësaj kontrate të gjitha pasuritë e krijuara para martesë do vijojnë të mbeten vetjake. Në këtë kontratë janë përcaktuar disa pasuri të paluajtshme të krijuara nga ish-bashkëshorti para martesë ndër të cilat dhe pasuria në fjalë.*

Lidhur me mundësitë financiarë kam dhënë shpjegime dhe prova ku rezulton se pasuritë e përfituara nga ish-bashkëshorti para martesë, janë krijuar me burime të ligjshme”.

¹⁸Shihni rezultatet e hetimit të Komisionit dërguar subjektit të rivlerësimit.

¹⁹Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

13.9 Konkluzion i Komisionit

- Ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar pasuri me sip. 61 m², në emër të tij, por në pronësi të vëllait A.B.. Kjo pasuri e blerë sipas kontratës së shitblerjes së datës 14.10.2005, në vlerën 2.000.000 lekë. Zotëron: 0%, në pronësi reale të A.B.
- Rezultoi se kjo pasuri është blerë dhe regjistruar pranë ZVRPP nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit para martese.
- Në lidhje me pasuritë paramartesore, të ardhurat e siguruara nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit (trajtuar edhe me sipër), si edhe mundësia financiare e ti, për të krijuar këto pasuri para martese, subjekti ka dhënë shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit.
- Në përgjigje të këtyre rezultateve, subjekti ka dërguar shpjegime të hollësishme dhe akte shkresore, duke kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës.
- Nuk rezultoi që subjekti të këtë kryer veprime për këto pasuri apo të jetë përfituese e tyre.
- Komisioni konstatoi se ish-bashkëshorti i subjektit ka qenë pronar i vetëm i kësaj pasurive të krijuar para martese, pasuri e cila është përfshirë në kontratën për regjimin pasuror të ndarë.
- Në vlerësimin e kësaj pasurie, lidhur me burimin e ligjshëm dhe përgjegjësinë e subjektit, Komisioni i referohet edhe praktikës së tij dhe të Kolegjit²⁰.
- Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri dhe subjekti ka bërë deklaram të saktë në përputhje me pikën 5/a, nenit 33, të ligjit nr. 84/2016

14. Automjet tip “Land Rover”, blerë në vlerën 500,000 lekë

- 14.1** Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti si pasuri e blerë nga të ardhurat e krijuara si noter.
- Rezultoi se kjo pasuri është blerë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 17.7.2014, në vlerën prej 500,000 lekë.
- 14.2** Bazuar në dokumentacion e dërguar nga DPSHTRR-ja rezulton se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri.
- 14.3** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë nga të ardhurat e bashkëshortit nga veprimtaria e tij si noter. Të ardhurat nga kjo veprimtari rezultoi në shumën prej 1,314,776 lekësh dhe vlera e blerjes së këtij automjeti plus shpenzimet doganore është në shumën 962,052 lekë.
- Duket se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj (duke marrë në konsideratë të ardhurat e të 2 bashkëshortëve) kishin burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, mbulimin e shpenzimeve dhe shtimin e likuiditeteve.
- 14.4** Por, meqenëse subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e ish-bashkëshortit për vitin 2014, në kuptim edhe të regjimit të pasurive të ndara, iu kërkuar shpjegime subjektit lidhur me burimin e ligjshëm.
- 14.5** Në përgjigje të rezultateve, subjekti deklaroi se nga analiza financiare e bërë nga Komisioni rezulton se të ardhurat e krijuara rezultojnë mëse të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie dhe, për më tepër, rezulton dhe një balancë pozitive prej 290,047 lekësh.

²⁰Shihni pikën 7.28 në këtë vendim.

- 14.6** Komisioni rishikoi të ardhurat e ish-bashkëshortit nga qiraja dhe i reflektoi ato në analizën financiare.²¹ Pas rishikimit të këtyre të ardhurave u hartua analiza e mëposhtme financiare.

Analizë për automjetin tip “Land Rover”, me targa *- A.B. – më 17.7.2014**

Të ardhura nga paga E. Imeraj deri më 17.7.2014	853,575
Të ardhura nga qiraja deri më 17.7.2014	1,680,770
Të ardhura nga dhurimi A.B.	700,000
Të ardhura nga biznesi A. B. deri më 17.7.2014	1,314,776
Të ardhura total	4,549,121
Shpenzime jetese deri më 17.7.2014	476,662
Shpenzime mobilimi deri më 17.7.2014	108,333
Shpenzime udhëtimi deri 17.7.2014	450,000
Shpenzime arsimimi fëmijët deri më 17.7.2014	208,706
Shpenzime doktorature E. Imeraj deri më 17.7.2014	204,600
Shlyerje kredi BKT A. B. - 8,346.34 euro	1,169,406
Shpenzime në total	2,617,707
Blerje mjete “Land Rover”, me targa ***, më 17.7.2014	500,000
Shpenzime doganore “Land Rover”, me targa ***, më 22.7.2014	462,052
Diferencë likuiditeti 17.7.2014 – 31.12.2013	511,237
Total pasuri	1,473,289
Mundësia financiare	458,124

- 14.7** Në përfundim, Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit dhe analizën financiare, arriti në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të mjaftueshëm dhe ka pasur burime financiare për blerjen e kësaj pasurie, rritjen e likuiditetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

15. Automjet tip “Volkswagen Passat” , blerë në vlerën 3,000 euro

- 15.1** Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti si pasuri e blerë nga të ardhurat e krijuara nga profesioni i avokatit, në pronësi të ish-bashkëshortit.
- 15.2** Rezultoi se kjo pasuri është blerë me kontratë në datën 18.9.2011, në vlerën 3,000 euro nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.
- 15.3** Bazuar në dokumentacion e dërguar nga DPSHTRR-ja rezulton se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri.
- 15.4** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë nga të ardhurat e bashkëshortit nga veprimtaria e tij si avokat. Të ardhurat nga kjo veprimtari rezultoi në shumën prej 2,638,917 lekë dhe vlera e blerjes së këtij automjeti plus shpenzimet doganore është në shumën 414,900 lekë.
- 15.5** Edhe nëse Komisioni nuk do të merrte parasysh të ardhurat e subjektit për vitin 2011, (pasi kjo pasuri është deklaruar e blerë vetëm me të ardhurat e ish-bashkëshortit, në kuptim kjo edhe të regjimit të pasurive të ndara), duket se subjekti/ish-bashkëshorti, ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

²¹Shihni shpjegimet te metodologjia pas analizës financiare në këtë vendim.

- 15.6** Komisioni rishikoi të ardhurat e ish-bashkëshortit nga qiraja dhe i reflektoi ato në analizën financiare.²² Pas rishikimit të këtyre të ardhurave, u hartua analiza e mëposhtme financiare.

Analizë për automjet “Volkswagen Passat” , me targa *– A.B. – më 18.9.2011**

Të ardhura nga paga E. Imeraj deri më 18.9.2011	1,048,428
Të ardhura nga qiraja deri më 18.9.2011	2,309,610
Të ardhura nga biznesi A.B. deri më 18.9.2011	2,638,917
Të ardhura total	5,996,955
Shpenzime jetese deri më 18.9.2011	387,090
Shpenzime udhëtimi deri më 18.9.2011	20,825
Shpenzime mobilimi	354,167
Shpenzime doganore BMW, ***– më 21.1.2011	671,735
Kaluar G.I. nga E. Imeraj, “Credins Bank”	120,000
Shlyerje kredi BKT A.B. - 12,544.74 euro	1,734,942
Shpenzime ne total	3,288,759
Blerje VW Passat A.B. - 3,000 euro – 18.9.2011	414,900
Diferencë likuiditeti 18.9.2011 – 31.12.2010	-47,561
Total pasuri	367,339
Mundësia financiare	2,340,856

- 15.7** Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti, kishin burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera.

16. Të drejta reale të krijuara me shoqërinë “**” sh.p.k.**

- 16.1** Ish-bashkëshorti e subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në datën 23.4.2014, me shoqërinë “****”. Kjo marrëdhënie kontraktuale ka të bëjë për përfitim me përqindje ndërtimi të pasurisë tokë me sip. 2.360 m², ndodhur tek ish-fusha e aviacionit Tiranë. Kjo sipërfaqe toke i jepet shoqërisë “****” dhe ish-bashkëshorti i subjektit do të përfitojë 37% të ndërtimit të përgjithshëm që do të ndërtohet mbi truallin në pronësi të tij.
- 16.2** Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: marrëdhënie kontraktuale për dhënien me përqindje ndërtimi të pasurisë tokë me sip. 2.360 m², ndodhur tek ish-fusha e aviacionit, Tiranë. Kjo sipërfaqe toke i është dhënë për zhvillim me përqindje shoqërisë “****” në vlerën prej 37% të ndërtimit të përgjithshëm sipas lejes zhvillimore me nr. *** prot., datë 13.10.2014, akorduar shoqërisë “****”, me vendimin nr. ***, datë 30.7.2014, të Bashkisë Tiranë.
- 16.3** Nga ky shkëmbim ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit do të përfitonte 9 pasuri të paluajtshme (njësi, apartament dhe garazh).
- 16.4** Për të vërtetuar deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur në Komision këto dokumente:
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 2.290,30 m² në emër të z. A.B., lëshuar më 12.6.2014. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme;

²²Shihni shpjegimet te metodologjia pas analizës financiare në këtë vendim.

- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 140 m² në emër të A.B., lëshuar më 9.7.2013, bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “truall” me sip. 69.70 m² në emër të z. A.B., lëshuar më 12.6.2014; bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme;
- kontratë shkëmbimi (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.11.2012;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë” me sip. 532 m², ndodhur në *** Tiranë, në emër të z. A.B., lëshuar më 27.2.2007;
- akt shitblerje prone pasurie të paluajtshme tokë arë me sip. 532 m², nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2007;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë” me sip. 532 m², ndodhur në *** Tiranë, në emër të z. A.B., lëshuar më 16.10.2006, bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme;
- kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme tokë arë me sip. 532 m², nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2006;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f.***, e llojit “arë” me sip. 400 m², ndodhur në *** Tiranë, në emër të z. A.B., lëshuar më 13.7.2007;
- kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme tokë arë me sip. 400 m², nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.6.2007;
- kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.4.2014;
- leje zhvillimore ndërtimi nr. *** prot., datë 13.10.2014, miratuar me vendim të kryetarit të bashkisë nr. ***, datë 30.7.2014;
- vendim i Bashkisë Tiranë nr. ***, datë 30.7.2014, për miratimin e lejes zhvillimore të ndërtimit për strukturë banimi dhe shërbimesh 4, 11 dhe 12 kate, me 2 kat parkim nën tokë në rrugën “***”, në pronë të z. A.B., me subjekt zhvillues dhe ndërtues shoqërinë “***” sh.p.k.;
- plani i vendosjes së zonës që zhvillohet për strukturën banim dhe shërbime 4, 11 dhe 12 kate. Sipërfaqja e tokës që zhvillohet 2.290 m², sipërfaqja e tokës së zënë 800 m², z. k. ***, nr. pasurie ***. Njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 27.1.2017.

16.5 Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, gjatë periudhës 2006 – 2007, ka blerë pasuritë: tokë arë me sip. 532 m², ndodhur në *** me çmim 1,750,000 lekë; tokë arë me sip. 532 m², ndodhur në *** me çmim 1,700,000 lekë; dhe tokë arë me sip. 400 m², ndodhur në *** me çmim 1,000,000 lekë.

16.6 Në përfundim, Komisioni konstatoi se pasuritë e përfituara me anë të kontratës së shkëmbimit janë regjistruar në ZVRPP, pas plotësimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me to.

17. Të ardhura nga shitja e automjetit tip “BMW” në vlerën 20,000 euro

17.1 Me kontratën e datës 14.12.2011, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur automjetin tip “BMW” me targa ***. Vlera e kontratës është 20,000 euro.

17.2 Ky automjet është përfituar nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me kontratë shkëmbimi automjetesh me nr. ***, datë 21.1.2011 ku automjeti tip “BMW X5” (viti i prodhimit 2003) është shkëmbyer me automjetin tip “Opel Astra” (viti i prodhimit 2005) me targa ***.

- 17.3** Automjeti tip “BMW X5” bazuar në deklaratën doganore import ***, të datës 22.1.2011 (një ditë pas shkëmbimit) rezulton se është blerë për shumën 250,000 lekë dhe është paguar detyrim doganor në shumën 403,119 lekë, ndërkohë në një tjetër deklaratë doganore të po të njëjtës datë, çmimi rezulton 11,480 euro dhe detyrimi doganor 671,735 lekë. Kjo deklaratë e dytë gjendet në dosjen e automjetit, administruar nga DPSHTRR-ja. Ky automjet rezulton të jetë blerë nga shkëmbyesi për shumën 250,000 lekë dhe, më pas, është shkëmbyer me automjetin e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
- 17.4** Shuma 20,000 euro nuk rezulton e deklaruar si e ardhur në DVP-në e vitit 2011, si dhe nuk ka asnjë informacion se për çfarë është përdorur kjo shumë. Njëkohësisht, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion për të provuar që ka paguar detyrimet tatimore në lidhje me shumën e shitjes (diferencë çmim shitje - çmim blerjeje).
- 17.5** Në lidhje me këtë shkëmbim, subjekti i rivlerësimit sqaroi se: *“Në lidhje me këtë veprim (shkëmbim automjetesh) mund të them vetëm se ka qenë një shkëmbim i bërë me vullnet të lirë mes palëve dhe si rezultat i njohjeve të mëparshme mes tyre. Kjo shumë është përdorur për shpenzime të ndryshme gjatë vitit, si pagesë kredie apo shpenzime të ndryshme. Shitja ka qenë një okazion dhe nuk është llogaritur si fitim. Në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2011 ka qenë një harresë nga ana e bashkëshortit mbi shitblerjen e automjetit tip ‘BMW X5’. Në deklaratën Vetting një fakt i tillë ndodhet i pasqyruar dhe është sqaruar prej meje”*.
- 17.6** Sipas deklarimeve²³ të subjektit të rivlerësimit rezulton se shuma 20,000 euro është shpenzuar gjatë vitit dhe ky shpenzim është llogaritur në analizën financiare për vitin 2011.

Në përgjigje të rezultateve të mëparshme të hetimit, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues nga Drejtoria e Tatimeve (shkresa nr. *** prot., datë 15.11.2019), në bazë të të cilit figuron e deklaruar si e ardhur vlera e shitjes së këtij automjeti dhe, gjithashtu, vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse.

Në përfundim, mbetet i dyshimtë fakti se si shkëmbehet nga ana e ish-bashkëshortit të subjektit një automjet me vlerë 8,300 euro me një automjet tjetër me vlerë 20,000 euro.

Automjeti tjetër tip “Opel Astra” me targa *** është blerë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 14.11.2009, me kontratën nr. ***, për shumën 8,300 euro.

Bazuar në analizën financiare për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj (duke marrë në konsideratë të ardhurat e të dy bashkëshortëve) nuk kishin burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti tip “Opel Astra” në vitin 2009, për mbulimin e shpenzimeve dhe shtimin e likuiditeteve.

Analiza financiare²⁴ është hartuar duke mbajtur parasysh të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit. Ky vlerësim është bërë pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin 2009 *pasuri makinë në vlerën 8,300 euro e blerë nga bashkëshorti*.

²³Pyetësori datë 30.5.2019.

²⁴Shihni analizën financiare në rezultatet e hetimit.

17.7 Për të gjitha konstatimet e evidentuara dhe gjetjet e Komisionit për këto pasuri të luajtshme, subjektit²⁵ iu kërkuan shpjegime, e cila, në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁶, deklaroi:

“- *Mosdeklarimi i të ardhurave të shitjes së automjetit në vitin 2011 ka qenë një harresë në DPV-në e personit të lidhur për atë vit;*

- *lidhur me diferencat e çmimeve të automjeteve shprehem se palët me vullnetin e tyre kanë vendosur, duke mos kryer asnjë veprim jashtë logjike dhe aq më tepër të pa lejuar nga ligji;*

- *kontratat e shitblerjes janë deklaruar në organet tatimore, ku është likuiduar çdo detyrim i lindur prej tyre, konform ligjeve në fuqi;*

- *lidhur me pamundësinë financiare shprehem se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitin 2009 dhe të ardhurat nga ushtrimi i funksionit të avokatisë nga ish-bashkëshorti, të cilat do ndryshonin situatën financiare...”.*

17.8 Analiza financiare

Komisioni rishikoi të ardhurat e ish-bashkëshortit nga qiraja dhe aktiviteti i biznesit, duke i reflektuar ato në analizën financiare.²⁷ Pas rishikimit të këtyre të ardhurave, u hartua analiza e mëposhtme financiare.

Analizë për automjetin tip “Opel Astra” me targa *, z. A.B., blerë me çmimin 8,300 euro, më 14.11.2009**

Të ardhura nga paga E. Imeraj deri më 14.11.2009	1,254,247
Të ardhura nga qiraja deri më 14.11.2009	1,270,000
Të ardhura nga biznesi A.B. deri më 14.11.2009	423,500
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Nissan Micra”, më 20.11.2009	137,170
Të ardhura total	3,084,917
Shpenzime jetese deri më 14.11.2009	358,628
Shpenzime udhëtimi deri më 14.11.2009	14,771
Shlyerje kredi NBG	15,882
Shlyerje kredi BKT A.B. - 14,453.08 euro	1,982,529
Shpenzime ne total	2,371,810
Blerje automjeti tip “Opel Astra” A.B - 8,300 euro - 14.11.2009	1,000,000
Diferencë likuiditeti 14.11.2009 – 31.12.2008	11,868
Total pasuri	1,011,868
Pamundësia financiare	-298,760

17.9 Konkluzion i Komisionit

- Komisioni konstatoi pamundësi financiare për blerjen e pasurisë automjet tip “Opel” në vitin 2009, pasuri e ish-bashkëshortit të subjektit.

²⁵Shihni rezultatet e hetimit të Komisionit dërguar subjektit të rivlerësimit.

²⁶Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

²⁷Shihni shpjegimet te metodologjia pas analizës financiare në këtë vendim.

- Lidhur me përgjegjësinë e subjektit, Komisioni mori në konsideratë kontratën paramartesore për pasuritë vetjake të ish-bashkëshortit. Bazuar aplikimit të këtij regjimi, kjo pasuri është regjistruar në emër të ish-bashkëshortit, për të cilën e drejta e pronësisë i përket vetëm këtij personi²⁸. Gjithashtu, nga hetimi nuk rezultoi përdorimi dhe as disponimi në asnjë mënyrë/formë e kësaj pasurie të luajtshme nga subjekti i rivlerësimit.
- Të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit rezultuan si të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit.

Me gjithë aplikimin e regjimit të pasurive të ndara, në deklaratën *Vetting* janë deklaruar balancat kreditore të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, të cilat rezultojnë si vijon:

18. Balancë kreditore në vlerën 1,024,332 lekë

- 18.1** Kjo llogari është krijuar nga arkëtimi i shumës 5,032,084 lekë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, arkëtimi i shumës prej 300,000 lekësh nga shitja e banesës dhe i shumës prej 780,551 lekësh nga fondi i emergjencave civile.
- 18.2** Nga Komisioni nuk është konstatuar problematikë lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe me të ardhurat e krijuara te kjo llogari bankare.

19. Balancë kreditore në vlerën 201,726 lekë

- 19.1.** Rezultoi se kjo llogari është krijuar për periudhën 2014 – 2017, si llogari e veprimeve noteriale të kryera nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Bazuar në konfirmimin e “Credins Bank” gjendja e kësaj llogarie në datën 29.1.2017 është në shumën 198,906 lekë.
- 19.2.** Nga Komisioni nuk është konstatuar problematikë lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe me të ardhurat e krijuara te kjo llogari bankare.

20. Balancë kreditore në shumën 525,15 lekë

- 20.1** Rezultoi se kjo llogari është krijuar për periudhën 2014 – 2017 si llogari e veprimeve noteriale të kryera nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Bazuar në konfirmimin e “Credins Bank” gjendja e kësaj llogarie, në datën 29.1.2017, është në shumën 525 lekë.
- 20.2** Nga Komisioni nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe me të ardhurat e krijuara nga kjo llogari bankare.

21. Balancë kreditore në shumën 838,96 lekë

- 21.1** Kjo llogari është krijuar për periudhën 2016 - 2017, si llogari e veprimeve noteriale të kryera nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.
Bazuar në konfirmimin e “Credins Bank” gjendja e kësaj llogarie, në datën 29.1.2017, është në shumën 838,96 lekë.
- 21.2** Nga Komisioni nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe me të ardhurat e krijuara nga kjo llogari bankare.

22. Balancë kredie në shumën 2,019 lekë

- 22.1** Kjo llogari është krijuar për periudhën 2014 – 2017, si llogari e veprimeve noteriale të kryera nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Bazuar në konfirmimin e

²⁸Neni 115 i Kodit të Familjes përcakton se: “Kur bashkëshortët kanë përcaktuar në kontratën e martesës regjimin e pasurive të ndara, secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij”.

“Credins Bank” gjendja e kësaj llogarie, në datën 29.1.2017, është në shumën 2,019 lekë.

- 22.2** Nga Komisioni nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe me të ardhurat e krijuara nga kjo llogari bankare.

23. Të drejta reale nga shtetasi S. Sh., në vlerën 5,000,000 lekë

- 23.1** Sipas deklaratës noteriale të datës 19.6.2015, shtetasi Sabri Shera deklaroi se një detyrimin prej 5,000,000 lekësh, të marrë nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Kjo sasi monetare është përfituar nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në vitin 2015, për shpërblim dëmi. Për kthimin e shumës, palët kanë nënshkruar kontratë porosie për përfitim apartamenti në vitin 2016, në vlerën 5,000,000 lekë.

- 23.2** Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: sasia monetare e përfituar nga vendimi i datës 12.1.2015 për shpërblim dëmi. Kjo deklaratë noteriale përbën titull ekzekutiv dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor është nxjerrë urdhërekzekutimi (deklarata e datës 12.1.2015).

- 23.3** Për të provuar deklaramet e saj, subjekti ka paraqitur këto dokumente:

- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2015;
- vendim nr. *** akti, datë 15.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e urdhërekzekutimit për aktin noterial me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2015;
- kontratë porosie apartamenti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2016.

Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.6.2015, rezulton se z. S.Sh. i detyrohet z. A.B. në shumën 5,000,000 lekë.

- 23.4** Në datën 19.9.2016 është lidhur kontrata e porosisë nr. *** midis shoqërisë “****” sh.p.k. me administratorë z. S.Sh. dhe z. A.B.. Bazuar në nenin 1, objekti i kësaj kontrate është apartamenti i ndodhur në katin 3 të banimit me sip. 86.7 m², ndodhur në pallatin e ri që është në ndërtim e sipër me vendndodhje rruga “****”. Afati i dorëzimit është data 1.3.2017. Nëse objekti nuk dorëzohet në afatin e caktuar porositësi ka të drejtë të kërkojë kthimin mbrapsht të shumës 10,000,000 lekë nga shoqëria dhe përfaqësuesi S.Sh. Në nenin 3 përcaktohet se vlera totale e apartamentit është 5,000,000 lekë dhe se shuma është likuiduar nga palët përpara nënshkrimit të kësaj kontrate në datën 19.6.2015, sipas deklaratës për njohje detyrimi.

Bazuar në deklaramet e interesave private të vitit 2016 të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit rezulton se shuma e përfituar nga vendimi i gjykatës si shpërblim nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” i është dhënë në formë huaje z. S.Sh. Kjo hua nuk rezulton e deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2015. Nëse i referohemi nxjerrjes së llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 19.6.2015 z. A.B. ka tërhequr shumën 5,000,000 lekë, ndërkohë që në deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.6.2015, deklaruesi S.Sh. deklaroi: “...njoh dhe pranoj detyrimin monetar...”.

Për ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv, z. A.B. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendim nr. *** akti, datë 15.10.2015, ka vendosur lëshimin e urdhërekzekutimit të deklaratës noteriale nr. ***. Në arsyetimin e vendimit, gjykata shprehet: “... detyrimi që përmban kjo deklaratë noteriale nuk është i lidhur me plotësim afatesh apo rrethanash të tjera dhe mbi të gjitha i pakushtëzuar nga rrethana apo detyrime të tjera”.

- 23.5** Në po të njëjtën datë, 19.6.2015, ish-bashkëshorti i subjektit, së bashku me shtetasin Sabri Shera kanë nënshkruar përpara të njëjtit noter, me një numër rep. dhe kol. më poshtë, një kontratë huaje me nr. *** rep., nr. *** kol.

Sipas kësaj kontrate z. A.B. i jep hua shumë 5,000,000 lekë me detyrimin për t'ia kthyer pas një afati 12-mujor deri në datën 19.6.2016. Bazuar në këtë kontratë, afati do të quhet i plotësuar në datën 19.6.2016, ora 12:00. Si garanci për shlyerjen e plotë të detyrimit pala huamarrëse, në cilësinë e administratorit dhe përfaqësuesit të shoqërisë “***” sh.p.k., do të lërë një pasuri të paluajtshme të llojit “apartament” i ndodhur në pallatin e ri që është në ndërtim e sipër me vendndodhje në rrugën “***” kati 3 banimi me sip. 86.7 m². Mënyra e likuidimit të huas në kontratë është përcaktuar të paguhet çdo muaj në shumë 400,000 lekë, ndërsa shuma 200,000 lekë do të likuidohet në momentin që do të nënshkruhet deklarata e likuidimit total mes palëve.

Në kontratë parashikohet edhe fakti se: *“Në rast mosrealizimi të detyrimit kontraktor nga pala huamarrëse/apo përfaqësuesi i saj ligjor në ditën, orën dhe vendin e përcaktuar në kontratë, pala huadhënëse ka të drejtë të shndërrojë kontratën në titull ekzekutiv dhe të kalojë për llogari të tij pasurinë e paluajtshme të lënë si garanci konform germës ‘d’, të nenit 510, të Kodit të Procedurës Civile. Mbarimi i afatit mund të vlerësohet nga palët si i mbaruar përpara afatit, vetëm në qoftë se palët likuidohen plotësisht ndërmjet tyre përpara afatit të caktuar në këtë kontratë...”*

- 23.6** Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Nga ana ime është pasqyruar se bashkëshorti i ka dhënë një shumë parash shtetasit S.Sh. Gjithashtu, është përcaktuar se kjo shumë është shuma që bashkëshorti ka fituar si shpërblim dëmi me vendim gjyqate. Për këtë veprim, i cili është ‘një’ dhe i vetëm, janë përpiluar disa akte noteriale, kontratë huaje, deklaratë njohje detyrimi dhe kontratë porosie. Por, në fakt, veprimi i kryer është i vetëm dhe është thjesht dhënia e sasisë monetare hua shtetasit S.Sh., në shumë prej 5,000,000 lekësh. Të gjitha veprimet e bëra, janë bërë për efekt të sigurimit të kthimit të shumës në kohën e duhur, gjë në fakt e cila nuk ka ndodhur dhe sot e kësaj dite.*

Burimi i të ardhurave për huan e mësipërme ka qenë ekzekutimi i titullit ekzekutiv (Vendimi gjyqësor), mbi djegien e banesës së bashkëshortit në Tropojë. Vlera e vetme monetare e dhënë hua tek shtetasi S.Sh. nga ana e bashkëshortit tim ka qenë shuma prej 5,000,000 lekë. Duke qenë se kanë kaluar të gjitha afatet mbi kthimin e huas, palët kanë nënshkruar kontratë porosie me qëllim dhënien e një banese në këmbim të huas, duke përcaktuar një penalitet. Sqaroj se e gjithë kjo ka si qëllim përmbushjen e detyrimit. Duke qenë se shtetasi S.Sh. kishte dështuar në kthimin e huas, shuma prej 10 milionë lekësh do të përbënte vlerën e dhënë, si edhe penalitetin nëse porosia nuk përmbushej”.

- 23.7** Rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, kur është hartuar deklarata noteriale, por një vit më vonë. Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi:

“- Bëj me dije se vlera e dhënies së kësaj huaje përbën një pasuri vetjake të ish-bashkëshortit të krijuar nga shpërblimi personal i dëmit i akorduar me vendim gjyqate të formës së prerë.

- Gjatë hetimit rezulton që janë administruar të gjitha aktet noteriale mbi këtë hua.

- *Mosdeklarimi i kësaj huaje në DPV-në e vitit 2015, ka qenë një harresë e ish-bashkëshortit, por menjëherë mbi këtë harresë në DPV-në e vitit 2016 kjo marrëdhënie huaje është shpjeguar detajisht.*

- *Kjo marrëdhënie huaje është bërë me akt noterial publik dhe nuk mund të pretendohet për mosdeklarim apo fshehje të saj”.*

23.8 Konkluzion i Komisionit

- Në lidhje me këtë marrëdhënie detyrimi, Komisioni konstatoi se kemi të bëjmë me një marrëdhënie detyrimi të lidhur mes ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe një të treti. Objekti i marrëdhënies së detyrimit është një vlerë monetare në pronësi individuale të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të krijuar mbi kushte thellësisht personale (shpërblim dëmi personal), për të cilat subjekti nuk ka tërhequr dhe nuk ka përfituar asnjë të drejtë.
- Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këto të drejta reale të përfituara nga ish-bashkëshorti i subjektit.

24. Të drejta reale nga shtetasi G.H. në vlerën 2,000 euro

- 24.1** Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.8.2015, rezulton se z. G.H. i detyrohet z. A.B. shumën 2,000 euro dhe se shtetasi G.H. e njeh detyrimin prej 2,000 euro të marrë ndaj ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
- 24.2** Në datën 6.11.2015, me vendimin nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lëshimin e urdhërkzekutimit për titullin ekzekutiv të deklaratës noteriale nr.***.
- 24.3** Kjo sasi monetare është përfituar nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga të ardhurat si noter dhe kjo shumë është përfshirë në analizën financiare.
- 24.4** Nga nxjerrja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se ky vendim është ekzekutuar në datat: 19.5.2017 shuma 1,000 euro; 28.7.2018 dhe 31.7 2018 shuma 500 euro.
- 24.5** Nga Komisioni nuk u konstatuan problematika për këtë deklaram të subjektit.

25. Të ardhura nga shitja e pasurive të mëparshme

- 25.1** Rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.9.2015, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur pasurinë nr. ***, në vlerën 300,000 lekë, në Tropojë. Pasuria është regjistruar më parë pranë ZVRPP-së Tropojë, në emër të ish-bashkëshortit të subjektit.
- 25.2** Kjo pasuri rezultoi se është përfituar me anë të parashkrimit fitues sipas vendimit gjyqësor datë 18.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Shuma prej 300,000 lekësh, i ka kaluar ish-bashkëshortit në llogarinë bankare të tij në datën 13.10.2015, me përshkrim “transfertë për shitblerje shtëpie”.
- 25.3** Nuk kanë lindur dyshime lidhur me këtë pasuri, si dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e saj, pasi është finalizuar me kontratën noteriale dhe veprimet bankare.

26. Analiza financiare

- 26.1** Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin e rivlerësimit Elizabeta Imeraj dhe ia dërgoi asaj në përfundim të hetimit.

- 26.2** Bazuar në analizën financiare²⁹, subjekti ka një pamjaftueshmëri financiare për shtimin e likuiditetit dhe shpenzimet e kryera.
- 26.3** Analiza financiare e hartuar nga Komisioni, iu kalua subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- 26.4** Në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me analizën financiare, subjekti deklaroi:
“- *Kërkoj të bëhen disa saktësime lidhur me analizën financiare për vitet 2007 – 2009.*
- *Kërkoj të merren parasysh të ardhurat e qirave, për të cilat kam provuar burimin e ligjshëm dhe pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse.*
- *Kërkoj të merren në konsideratë të ardhurat e ish-bashkëshortit nga veprimtaria si avokat.*
- *Kërkoj të merren në konsideratë shpjegimet lidhur me shpenzimet e udhëtimit për vitin 2009.*
- *Kërkoj të merren parasysh të ardhurat e vëllait të ish-bashkëshortit, të dërguar dhe provuar me transaksione bankare në mënyrë të rregullt”.*
- 26.5** Pas përgjigjeve të rezultateve të hetimit, Komisioni përfundoi analizën financiare për këtë subjekt rivlerësimi, sipas tabelës vijuese:

²⁹Shihni analizën financiare të dërguar subjektit me rezultatet e hetimit.

ANALIZE FINANCIARE SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ELIZABETA A. IMERAJ															
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	0	0	270,382	1,913,620	11,869,007	6,329,927	1,088,621	11,403	819,728	525,999	-30,312	1,210,248	3,245,355	4,713,744	31,967,721
Pasuri 61 m2 ***, DR - A. B. - 2.000.000 leke - 2005 - 100%					2,000,000										2,000,000
Truall 332 m2 *** - A. B. - 2006 - 3.300.000 leke - 100%					3,300,000										3,300,000
Shtepi banimi 5 kateshe - Kati 3 - Rr. *** - A. B. - 100%					4,000,000			128,045							4,128,045
Apartament 66 m2, Rr. ***, TR - A. B. - 2008 - 4.000.000 leke - 100%						5,543,213									5,543,213
Shtese 1 kat 70.4 m2 Rr.***, TR - A. B.- Legalizuar 2015 - 100%												1,601,426			1,601,426
Banese , Tropejo, 140.4 m2 - A. B. - Shitur 2015 - 100%															0
Apartament 73 m2, Kati 1, Rr. ***, TR -A.B.- 500.000 leke - 2008 - 100%						500,000									500,000
Apartament 86.7 m2, Rr. ***, TR - A. B. - 2016 - 5.000.000 leke - 100%														5,000,000	5,000,000
Toke arë 532 m2, *** - A. B. - 1.700.000 leke - 2007 - 100%					1,700,000					-1,700,000					0
Toke arë 532 m2, *** - A. B. - 2006 - 1.750.000 leke - 100%					1,750,000					-1,750,000					0
Toke arë 400 m2, *** - A. B. - 2007 - 1.000.000 leke - 100%					1,000,000					-1,000,000					0
Toke truall 2.500m2, Rr. ***, - A. B.- 2012 - 100%										4,450,000					4,450,000
Automjet Land Rover *** - A. B. - 2014 - 500.000 leke - 100%												500,000			500,000
Automjet VW Passat *** - A. B. - 2011 - 3.000€ - 100%									414,900						414,900
Automjet Opel Astra *** - A. B. - 8.300 € - 2009 - 2011 - 100%							1,138,511		-1,138,511						0
Automjet BMW X5 *** - A. B. - Janar - Dhjetor 2011 - 100%									1,138,511						1,138,511
Makine Nissan Micra *** - Elizabeta Imeraj - 2005 - 100%			250,000												250,000
Automjet Toyota *** - A. B. - 2011 - 2013 - 100%									327,538						327,538
Motor *** Mondial *** - A. B. - 2010-2015 - 100%								90,000							90,000
Arme gjahu - 2009 - 2015 - A. B. - 100%							30,000								30,000
Dhurime nga familjaret per raste festash			24,000	92,000	28,000	28,000	20,850								192,850
Ndryshim ne likuiditet	0	0	-3,618	1,821,620	-1,908,993	258,714	-100,740	-206,642	77,290	525,999	-30,312	710,248	1,643,929	-286,256	2,501,239
DETYRIME	0	0	214,244	1,945,709	-2,063,253	11,561,530	-948,282	-977,539	-1,278,550	-1,297,021	-1,430,968	-1,595,077	-6,796,817	3,133,911	743,187
Kredi BKT - 100.000 € - 2008 - A. B.						11,642,835	-932,888	-977,539	-1,278,550	-1,297,021	-1,430,968	-1,595,077	-1,521,517	-1,866,089	743,187
Kredi konsumatore NBG - 250.000 leke - 2005 - Elizabeta Imeraj			214,244	-47,449	-70,094	-81,306	-15,395								0
Kredi BKT - 2.000.000 leke - 2006 - Elizabeta Imeraj				1,993,159	-1,993,159										0
Hua dhene nga A. B. per z. S. Sh. - 5.000.000 leke - 2015												-5,000,000	5,000,000		0
Hua dhene nga A. B. per z. G. H. - 2.000 € - 2015												-275,300			0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	0	0	56,138	-32,089	13,932,260	-5,231,603	2,036,903	988,942	2,098,279	1,823,019	1,400,656	2,805,325	10,042,172	1,579,833	31,224,534
TE ARDHURA dokumentuar	351,920	496,343	926,224	1,171,992	15,500,690	1,952,875	3,388,104	3,429,893	11,115,545	7,570,106	3,339,509	7,411,325	12,469,722	4,709,277	73,833,525
Te ardhura Elizabeta Imeraj nga puna	351,920	496,343	902,224	1,079,992	1,129,180	1,462,875	1,368,084	1,407,893	1,408,665	1,450,754	1,382,821	1,580,344	1,716,014	1,629,175	17,366,284
Te ardhura A. B. nga biznesi noteri/avokati dhe qiraja	0				1,556,000	462,000	1,862,000	2,022,000	6,940,880	4,442,712	1,629,150	5,130,981	3,697,643	3,080,102	30,823,468
Te ardhura nga pasuria paramartesore A. B. (Truall, banesa, likuiditetet)					12,787,510										12,787,510
Te ardhura nga shitja e baneses ne Tropejo 2015													300,000		300,000
Dhurata nga familja dhe kunati			24,000	92,000	28,000	28,000	20,850			1,676,640		700,000	853,430		3,422,920
Te ardhura nga zhdemtimi CEZ per demet ne pronen, Tropejo 2015													5,032,084		5,032,084
Te ardhura nga fondi familjeve te demtuara Bashkia Tropejo, 2015													780,551		780,551
Te ardhura nga shitja e automjetit Toyota - 3.500 € - 2013											327,538				327,538
Te ardhura nga shitja e automjetit Nissan Micra - 1.000 € - 2009							137,170								137,170
Te ardhura nga shitja e motorit Huaitian Mondial - 40.000 leke - 2015													40,000		40,000
Te ardhura nga shitja e BMW X5 - 20.000€									2,766,000						2,766,000
Te ardhura nga shitja e armes se gjahut - 2015													50,000		50,000
SHPENZIME	93,964	93,964	153,111	412,063	558,346	7,242,951	1,657,991	1,634,651	5,653,569	2,284,075	1,861,188	2,985,959	1,904,152	1,914,860	28,450,845
Shpenzime jetese	93,964	93,964	109,557	109,557	409,860	409,860	409,860	409,860	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	6,432,714
Paguar M. D. 45.000€ per kthim borxhi te kunatit A. B. - 2008						5,543,213									5,543,213
Kaluar vella G. I.									180,000	240,000	55,500				475,500
Shpenzime interesi kredi NBG 250.000 leke - 2005-2009			43,554	40,042	34,116	15,396	487								133,596
Shpenzime interesi & tjera kredi BKT - 100.000 € - 2008-2016						1,074,483	1,232,873	1,004,791	968,529	798,768	672,565	404,013	307,452	261,075	6,724,549
Shpenzime interesi & tjera, kredi BKT - 2.000.000 leke - 2006-2007				109,272	114,369										223,641
Shpenzime per fond pensioni SiCred Credins Invest 2015-2016 - Elizabeta Imeraj													14,000	24,000	38,000
Shpenzime mobilimi						200,000		220,000	500,000	370,000	150,000	200,000			1,640,000
Shpenzime importi BMW X5- 2011									671,735						671,735
Shpenzime importi Land Rover *** - 2014												462,052			462,052
Shpenzime riparimi Nissan Micra - 2006			100,000												100,000
Shpenzime arsimimi										139,720	332,998.75	385,302.50	433,598	561,371	1,852,989
Shpenzime doktorature 2014												204,600			204,600
Shpenzuar vlera 20.000€ nga te ardhurat e shitjes se automjetit BMW X5									2,766,000						2,766,000
Shpenzime udhetimi				53,192			14,771	0	20,825	177,395	86,028	450,000	251,998	128,046	1,182,256
Analiza dokumentuar	257,956	402,379	716,975	792,018	1,010,085	-58,473	-306,791	806,300	3,363,697	3,463,012	77,665	1,620,041	523,399	1,214,585	13,882,847
												Pamundesia financiare			-365,264

26.6 Komisioni konstatoi pamundësi financiare në total në vlerën 365,264 lekë për vitet 2006 – 2016. Pas analizimit të pamundësisë financiare dhe vlerës përkatëse, Komisioni konstatoi se kjo pamundësi nuk përbën shkak për të penalizuar subjektin e rivlerësimit dhe dhënien e masës “shkarkim nga detyra”.

26.7 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Credins Bank”, “Tirana Bank”, “Raiffeisen Bank”, BKT, “Intesa Sanpaolo Bank”, NBG Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Shkollën e Magjistraturës bursë 2002 – 2004, Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër për periudhën 2004 – 2005, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për periudhën 2005 – 2016, Universitetin *** për vitin 2008, W*** U*** për periudhën 2015 – 2016.

Për ish-bashkëshortin e subjektit:

ii) Kontrata e shërbimit me shoqërinë “***” sh.p.k. për periudhën 2004 – 2007, kontrata e shërbimit me “***” sh.a. për periudhën 2011 – 2013, nga biznesi i avokatisë për periudhën 2007 – 2013, nga biznesi i noterisë për periudhën 2014 – 2016, të ardhurat nga pagat për vitet 2014 – 2016 të kaluara me bankë dhe të zbritura nga të ardhurat e biznesit për vitet përkatëse në bilanc.

Për sa i përket të ardhurave nga avokatia, për periudhën 2004 – 2007, ka një mospërputhje informacioni mes të ardhurave të deklaruara nga subjekti për ish-bashkëshortin dhe të ardhurave që vërtetoheshin nga Drejtoria e Tatimeve për të. Biznesi i ish-bashkëshortit të subjektit, sipas vërtetimit të Bashkisë Tiranë, ka qenë biznes me xhiro 0 – 2.000.000 gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar dhe ka paguar të gjitha detyrimet tatimore lidhur me biznesin. Në përgjigje të rezultateve të mëparshme të hetimit, subjekti paraqet një përgjigje me nr. *** prot., datë 4.11.2019, nga Drejtoria e Tatimeve, e cila konfirmon dorëzimin e pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve, elektronikisht nga shtetasi A.B. Nga këto pasqyra janë marrë fitimet *neto* dhe pagesat e kësteve të tatimit të biznesit të vogël, të cilat janë përfshirë në analizën financiare. Këtu bën përjashtim viti 2009, i cili sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 1.11.2018, të mëparshëm të Drejtorisë së Tatimeve, vërtetonte një fitim pas tatimi në vlerën 342,000 lekë (vlerë kjo e përfshirë në analizë).

Pas rishikimit të provave të sjella nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, për vitet 2008 dhe 2009, të ardhurat *neto* nga biznesi janë marrë nga pasqyrat financiare të dorëzuara duke zbritur nga fitimi vjetor këstet e tatimit mbi biznesin e vogël. Sigurimet e paguara për këto dy vite, të pretenduara nga subjekti si të ardhura shtesë për ish-bashkëshortin nga biznesi në këto dy vite, nuk janë përfshirë si të ardhura për vitin. Ato janë thjesht kontributet e sigurimeve të detyrueshme për t’u paguar pranë organeve shtetërore dhe jo të ardhura shtesë.

Gjithashtu, përjashtim bën edhe viti 2012. Sipas pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve të konfirmuara si të dorëzuara elektronikisht nga z. A.B., xhiroja e vitit, madje edhe fitimi *neto* është mbi 2.000.000, ndërkohë që tatimi i biznesit të vogël është paguar për xhiron 0 – 2.000.000. Si rrjedhim, për këtë vit, në analizë është

aplikuar marzhi i fitimit 80% mbi xhiron maksimale të mundshme prej 2.000.000 lekësh/vit.

iii) Të ardhurat nga qiraja për pasuritë në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit për periudhën 2005 – 2016 – lidhur me këto të ardhura, subjekti sjell një përgjigje me nr. *** prot., datë 11.11.2019, nga Drejtoria e Tatimeve, e cila konfirmon pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja sipas deklaratave DIVA të individit A.B.. Përveç kësaj, në kontratat e qirasë, është cilësuar qartë se detyrimi për pagimin e detyrimeve tatimore të lidhura me kontratën janë në ngarkim të qiramarrësit. Pjesa tjetër e kontratave të qirasë, ku ky detyrim bie mbi qiradhënësin, e kanë konfirmimin për pagimin e tatimit nga qiradhënësit.

Janë rishikuar vlerat e të ardhurave nga qiraja, të konsideruara në rezultatet e hetimit, duke u mbështetur në shpjegimet e subjektit dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 11.11.2019 të sjellë nga organet tatimore.

Në analizën financiare janë trajtuar si të ardhura të ligjshme edhe të ardhurat nga qiraja në vitet 2005 – 2007, për pasuritë në emër të z. A.B.

iv) Të ardhurat nga shitja e banesës në ***, Tropojë në vitin 2015.

v) Të ardhurat nga zhdëmtimi i CEZ-it dhe fondi i emergjencave civile të Tropojës në vitin 2015.

vi) Të ardhurat nga shitja e automjeteve tip “Toyota”, “Nissan Micra”, “BMW X5”, motorit Huaitian Mondial dhe armës së gjahut.

vii) Të ardhurat nga dhurimet e kunatit të subjektit të rivlerësimit, A.B., në shumat e deklaruara në deklaratimet vjetore dhe në deklaratën *Vetting*. Bazuar në dokumentacionet e sjella nga subjekti në përgjigje të rezultateve të mëparshme të hetimit, duket se nga të ardhurat *neto* të z. A.B. në Mbretërinë e Bashkuar, ekziston mundësia financiare e dërgimit të këtyre shumave të deklaruara si dhurime vëllait të tij A.B. në vitet 2012, 2014 dhe 2015.

Ndërkohë, subjekti paraqiti dokumentacion financiar përmes të cilave provohet se përgjatë viteve 2004 – 2007 (para lidhjes së martesës), ish-kunati A.B. ka pasur mundësi të krijonte të ardhurat për të justifikuar me burime të ligjshme dërgesat e bëra me bankë, ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i).

ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.), datë 22.5.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ ish-bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrimi pranë të afërmeve.

Janë marrë parasysh shpjegimet e subjektit lidhur me udhëtimin e bërë në Angli në vitin 2009. Shpenzimet e qëndrimit janë trajtuar sipas vendimit të sipërcituar duke marrë në konsideratë deklaratën noteriale të z. A.B., i cili deklaroi se subjekti dhe ish-bashkëshorti kanë qëndruar në banesën e tij gjatë ditëve të udhëtimit dhe se ai u ka mbuluar shpenzimet e udhëtimit.

iii) Shpenzime mobilimi të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

iv) Shpenzime interesash, principali dhe shpenzime të tjera të lidhura me kreditë në NBG dhe BKT.

v) Shpenzim importi për automjetet tip “BMW X” dhe “Land Rover”.

vi) Shpenzime të deklaruara për riparim të automjetit tip “Nissan Micra”.

vii) Shpenzime arsimimi për fëmijët dhe doktoraturë për subjektin e rivlerësimit.

viii) Kalimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit të vëllai i saj G.I. për periudhën 2011 – 2013.

ix) Shpenzim për shlyerje huaje të kunatit A.B të shtetasit M. dhe M.D.

x) Shpenzime për investim në fondin “SiCred” nga subjekti i rivlerësimit.

xi) Shpenzimi i vlerës 20,000 euro nga shitja e automjetit tip “BMW X5” në vitin 2011, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive³⁰.

Arsyetimi ligjor i Komisionit

Në lidhje me kriterin e pasurisë, Komisioni vlerëson të marrë në analizë kuadrin e plotë ligjor, mbi bazën e të cilit lind detyrimi i subjektit të rivlerësimit dhe mbi bazën e të cilit shtrihet hetimi i Komisionit për efekt të aplikimit të ligjit me nr. 84/2016.

Në funksion të procesit të rivlerësimit dhe më konkretisht të vlerësimit të pasurive, subjekti është i ngarkuar nga ligji nr. 84/2016 me dy detyrime specifike, të cilat janë si vijon:

Së pari, detyrimi për të deklaruar, pra për të identifikuar pasuritë në pronësi, zotërim ose gëzim dhe burimet përkatëse të të ardhurave.

Së dyti, detyrimi për të justifikuar, pra për të paraqitur dokumentet përkatëse që vërtetojnë ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave.

Në rastin konkret, në lidhje me pasuritë e përshkruara si më sipër, si të deklaruara nga personi i lidhur/ish-bashkëshorti, pasuri të cilat nuk kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, ka detyrimin e saktësisë së deklarimit dhe saktësisë së dhënies së burimit të ligjshëm.

Paragrafi “d” i Aneksit të Kushtetutës përcakton se qëllimi i vlerësimit të pasurisë është të zbulohet njëra nga situatat e mëposhtme:

i. Subjekti ka fshehur të ardhurat/pasuritë ose nuk i ka treguar ato.

ii. Subjektet të cilët “posedojnë ose kanë në përdorim pasuri më të mëdha sesa mund të justifikohen në mënyrë legjitime”.

Kjo do të thotë se dispozitat kushtetuese për vlerësimin e pasurisë prezantojnë, që nga fillimi, një tablo të qartë midis dy fazave themelore: momenti i “deklarimit” dhe momenti i “justifikimit”.

Paragrafët 2 dhe 3 të neni D janë në përputhje me të dyja fazat kur përshkruhen detyrimet e vendosura mbi subjektin gjatë vlerësimit të pasurisë.

³⁰ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

Paragrafi 2 i neni D rregullon “përcaktimin”, d.m.th. një sjellje të një natyre deklarative, ndërsa paragrafi 3 i neni D normon arsyetimin (d.m.th. një sjellje të natyrës shpjeguese, provave).

Dy paragrafët e fundit të neni D të Aneksit të Kushtetutës përcaktojnë sanksionet për sjelljet e sipërpërmendura, duke ndjekur vazhdimisht të njëjtën linjë logjike.

Paragrafi 5, i neni D, të Aneksit të Kushtetutës sanksionon ato që quhen shkelje, duke parashikuar shkarkimin për ato subjekte që “kanë marrë masa për të deklaruar në mënyrë të pasaktë apo kanë fshehur pasurinë/të ardhurat”.

Formulimi i bërë nga paragrafi 5, i neni D, të Aneksit të Kushtetutës (“Marrja e masave”) tregon qartë se deklarimi i pasaktë është i sanksionuar për atë që rezulton në një deklaram të pavërtetë para organeve të *Vetting*-ut.

Me fjalë të tjera, sanksioni i parashikuar nga paragrafi 5 i neni D parashikon që organet e *Vetting*-ut arrijnë gjatë hetimit të gjejnë prova për pavërtetësinë e deklaramit të subjektit.

Neni 31 i ligjit nr. 84/2016 imponon detyrimin për të përpiluar deklaratën e pasurisë, duke zbritur kështu në nivelin e ligjit të zakonshëm parashikimin e paragrafit 2, të neni D, të Kushtetutës. Neni 32 imponon detyrimin për të justifikuar pasurinë.

Neni 33 i ligjit nr. 84/2016 ofron një përkrahje të përgjithshme të procedimit të vlerësimit të pasurisë.

Kjo dispozitë sqaron funksionet dhe qëllimet e hetimit administrativ, duke përsëritur dallimin midis *justifikimit* (germa “b”, paragrafi 5, neni 33) dhe *deklaratës* (germat c dhe ç, paragrafi 5, neni 33).

Normat ligjore të zbatueshme lidhen detyrimisht me kuadrin ligjor në fuqi, që përfshin edhe normat e Kodit të Familjes, si dhe normat e Kodit Civil.

I gjithë kuadri ligjor gjen zbatim në aplikim, duke mos kundërshtuar normat ligjore të vendosura dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Bazuar në nenin 77 “Pasuria vetjake” të Kodit të Familjes, parashikohet se: “*Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:*

- *Pasuria e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi.*
- *Pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit.*
- *Pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort.*
- *Mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit.*
- *Pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë.*
- *Pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura.*
- *Shkëmbimi i tyre kur kjo është deklaruar...”.*

Referuar situatës faktike të subjektit të rivlerësimit, Elizabeta Imeraj, në bazë të kontratës së regjimit pasuror martesor në raport me përcaktimet e Kodit të Familjes, rezulton se pasuritë e subjektit përbëjnë pasuri të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të krijuara para martesë dhe me regjim pasuror të pasurive të ndara.

Për krijimin e këtyre pasurive nuk rezultoi të jetë shprehur ndonjë vullnet i subjektit të rivlerësimit, nuk rezultoi ndonjë akt në të cilin subjekti të ketë disponuar në çfarëdolloj forme ndonjë nga këto pasuri, si dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë përfutuar apo deklaruar interesa pasurore apo të ketë përdorur këtë pasuri.

Bazuar në dokumentacionin e origjinës së këtyre pasurive, konfirmohet se ato janë në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe në të gjitha aktet shkresore për posedimin e saj ka qenë vullnet i vetëm i pronarit.

Pavarësisht rezultateve mbi hetimin e këtyre pasurive dhe mundësisë financiare të krijimit të tyre, Komisioni, si dhe në raste të tjera, të cituara sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi.

Siç e përmendëm, për të arritur në konkluzionin e mësipërm Komisioni i referohet edhe praktikës së deritanishme të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për sa i përket trajtimit që iu janë bërë pasurive apo të drejtave të krijuara nga personat e lidhur para martesë.

Subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore në drejtim të saktësisë së deklaramit dhe saktësisë së tregimit të burimeve.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016 ka paraqitur në Komision raportin përfundimtar ku rezulton se:

- Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Elizabeta A. Imeraj.

Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna dhe dyshime nga Komisioni edhe pas verifikimit të dosjes së subjektit në SHISH në mënyrë të përsëritur.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- A. Raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme.
- B. Denoncimet e paraqitura në Komision, si dhe dosjet e administruara prej saj.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë

15.4.2019, të hollësishëm dhe të arsyetuar. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.
- 2) Pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë:
 - Në Prokurorinë e Përgjithshme - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënies me Publikun, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënies me Shërbimet Informative, Zyra e Informacionit të Klasifikuar dhe Sektori i Protokoll-Arkivit.
 - Arkivi i 23 Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

I. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka deklaruar të dhënat statistikore që lidhen me veprimtarinë në përgjegjësinë e tij, duke referuar si periudhë të rivlerësimit “1.1.2014 – 31.12.2016”.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, konstatohet se në periudhën tetor 2004 – tetor 2005, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, tetor 2005 – aktualisht, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Ndërsa me urdhrin nr. ***, datë 1.8.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm është caktuar në pozicion të përkohshëm si Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Fusha e së drejtës në të cilën ka punuar subjekti është fusha penale. Fillimisht ka qenë pjesë e seksionit të krijuar në Prokurori që merrej me ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale “trafikimi i personave” dhe “trafikimi i të miturve”, parashikuar nga nenet 110/a dhe 128/b të Kodit Penal.

Gjatë viteve 2014-2015, subjekti ka hetuar edhe çështje që kanë të bëjnë me veprat penale me qëllime terroriste.

Në korrik të vitit 2016 e në vazhdim është bërë pjesë e seksionit të krijuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe hetimin e pasurive kriminale.

d) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Sa iu përket trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit deklaroi në formular se *3 vitet e fundit nuk ka kryer trajnime pranë Shkollës së Magjistraturës, por ka kryer trajnime në vitet më parë pranë kësaj shkolle.*

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në formularë trajnime të numërtuara, kualifikime të ndryshme duke paraqitur të njehsuara me origjinalin dy dëshmi të gjuhëve të huaja dhe një certifikatë gjuhe të huaj.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nga momenti i përfundimit të Fakultetit të Drejtësisë dhe në vazhdim ka bërë disa publikime, botime dhe marrë pjesë në disa konferenca të ndryshme.

e) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit diskutime përfundimtare:

1. Diskutim përfundimtar për çështjen penale nr. *** të vitit 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për veprën penale të parashikuar nga nenet 231 e 25, 232/a e 25 dhe 266 e 25 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve G.B., G.P., B.H., O.R., V.M., Z.I., A.T., E.B. dhe F.M. (Flete 66).
2. Diskutim përfundimtar për çështjen penale nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për veprën penale të parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a/1 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve N.P. etj.
3. Diskutim përfundimtar për çështjen penale nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për veprën penale të parashikuar nga nenet 110/a/4 dhe 128/b/3 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve Sh. dhe B.S. (20 faqe).

II. Përshkrimi dhe Gjetjet e pesë dosjeve të përzgjedhura me short

1. Vendimi i datës 2.3.2015, “Për pushimin e procedimit penal nr. * të vitit 2014”**

Nga aktet e administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, rezulton se procedimi penal nr. ***, i vitit 2014, është ndër procedimet e shortuara për subjektin dhe është sipas afateve të parashikuara në ligjin për rivlerësimin e subjekteve.

Nga vëzhgimi i fashikullit të procedimit penal të pushuar, rezulton se Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, Sektori për Narkotikët dhe Trafiket, datë 27.8.2014, ka referuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, kryerjen e veprës penale “trafikimi i personave të rritur”, parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal.

Mbi këtë bazë, subjekti i rivlerësimit me urdhër të datës 11.9.2014 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “trafikimi i personave”, parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, si dhe ngarkuar oficerët e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore.

Në këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit, bazuar në gërmën “dh”, të paragrafit 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, në datën 2.3.2015, ka vendosur:

1. Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, regjistruar për veprën penale “trafikimi i personave” parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal.
2. Vendimi t’i njoftohet të dëmtuarës.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ose te prokurori më i lartë.

Me urdhrin e datës 11.9.2014 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal mbështetur në nenet 75/a dhe 30/2 e 33/1/2 të Kodit të Procedurës Penale, për veprën penale “trafikimi i personave”, parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal.

Me urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka ngarkuar oficerët e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe për kryerjen e disa veprimeve hetimore për të cilat është caktuar afati kohor brenda datës 11.10.2014.

Nga vëzhgimi i akteve të këtij procedimi penal rezultoi se vendimi i pushimit të procedimit penal është i bazuar në prova dhe në ligj dhe është marrë pasi janë kryer veprimet e nevojshme dhe të mundshme hetimore për sqarimin e veprës penale të kryer dhe rrethanat e kryerjes së saj, por, duke mbetur në kushtet e pamundësisë së grumbullimit të provave të plota.

Vendimi i pushimit të hetimeve konstatohet i përpiluar me qartësi dhe i argumentuar drejt, duke justifikuar shkakun për të cilin është vendosur pushimi për mungesë provash.

Vendimi për pushimin e hetimeve të çështjes penale konstatohet i strukturuar në mënyrë logjike dhe me gjuhë të kuptueshme, në respektim të plotë të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Vendimi është ndërtuar sipas standardit të një vendimmarrjeje të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese dhe argumentuese, dispozitivin e vendimit dhe parashtrim të bazës ligjore.

Nga pikëpamja e strukturës, përgjithësisht, në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit u konstatuan se janë respektuar mirë rregullat e drejtshkrimit. Ka përdorur referencat e duhura ligjore dhe arsytim të qartë lidhur me përshkrimin e tyre. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm.

Përmenden në kërkesë baza ligjore nga Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale.

Problematikat e konstatuara nga Komisioni

Në zbatim të parashikimeve të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, përpara ndryshimeve të tij me ligjin nr. 35/2017, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (hyrë në fuqi më 1.8.2017) rezulton se procedimi penal i pushuar datë 2.3.2015, kishte detyrim për të kaluar për studim dhe kontroll te Drejtuesi i Prokurorisë. Kjo procedurë duket se nuk është ndjekur në këtë rast.

Në pikën 2 të vendimit të pushimit është cituar se vendimi t’i njoftohet të dëmtuarës, por në dosje nuk u konstatua për dërgimin dhe marrjen dijeni nga pala paditëse të vendimit të pushimit.

Për këto konstatime të bëra nga Komisioni subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në rezultatet e hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi:

“- Konstatimi i Komisionit nuk qëndron pasi sipas procedurës ligjore dosja ka kaluar për studim dhe kontroll dhe Drejtuesi i Prokurorisë duke qenë dakord me vendimmarrjen nuk ka kryer ndonjë veprim për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes.

- Nuk është mbajtur procesverbal për kontrollin pasi nuk ndodhte në të shumtën e rasteve mbajtja e një procesverbali të tillë, nuk ishte e përcaktuar formalisht.

- Njoftimi është bërë në formën e duhur nëpërmjet shërbimit postar ose duke u depozituar vendimi i pushimit në sekretari, ndaj konstatimi i bërë nuk qëndron.

- Asnjë nga konstatimet e paraqitura nuk qëndrojnë duke qenë se janë kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore në përputhje me ligjin”.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

2. Procedimi penal nr. *, i vitit 2014, hetimet e të cilit janë pushuar me vendimin e datës 22.2.2016**

Nga aktet e administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, rezulton se procedimi penal nr. ***, i vitit 2014, është ndër procedimet e shortuara për subjektin e rivlerësimit dhe është sipas afateve të parashikuara në ligjin për rivlerësimin e subjekteve.

Nga aktet voluminoze të administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, rezulton se: me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2013, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, informacionin për referimin e veprave penale të ardhura nga Shërbimi Informativ Shtetëror.

Mbi këtë bazë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë 20.12.2013, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprat penale të parashikuara nga nenet 231 dhe 232/a të Kodit Penal.

Në këtë procedim penal si dokument ligjor i përzgjedhur në mënyrë rastësore për subjektin të rivlerësimit, kjo e fundit, bazuar në nenet 304 dhe 328 paragrafi 1, germa “dh” e Kodit të Procedurës Penale, në datën 22.2.2016, ka vendosur:

- Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015, në ngarkim të personave nën hetim: Sh.K., M.M. dhe Sh.D.
- Shuarjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin e datës 10.3.2014, në ngarkim të shtetasit Sh.K.
- Shuarjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin e datës 10.3.2014, në ngarkim të shtetasit M.M.
- Shuarjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin e datës 10.3.2014, në ngarkim të shtetasit Sh.D.
- Ky vendim të njoftohet sipas rregullave procedurale të hetuarve apo mbrojtësve të tyre.
- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim sipas parashikimeve të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga studimi i akteve të këtyre fashikujve, siç u parashtrua edhe më sipër, del në dukje se pas regjistrimit të procedimit penal datë 20.12.2013, nga subjekti i rivlerësimit në datën 5.3.2014, është urdhëruar regjistrimi i emrave të personave që u atribuohen veprat penale dhe konkretisht ato të personave të dyshuar G.B., G.P., B.H., Sh.D., E.B., V.M., F.M., Sh.K., O.R., Z.I., A.T., A.D. dhe M.M.

Për faktin se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si një ndër tri dokumentet e përzgjedhura “diskutimet përfundimtare të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013”, u konstatua se datë 25.2.2015, është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim në ngarkim të të gjykuarve G.B., G.P., B.H., E.B., V.M., F.M., O.R., Z.I. dhe A.T., ndërsa për të dyshuarit Sh.D., Sh.K. dhe M.M. nuk është ngritur akuzë në ngarkim të tyre, por është vendosur veçimi i akteve për të kryer hetime të mëtejshme.

Lidhur me këtë akt janë parashtruar hollësisht të dhëna të kësaj çështjeje, si dhe janë trajtuar edhe dispozitivët e dy shkallëve të gjykimit për të gjykuarit e sipërpërmendur.

Ndërsa, në vendimin për pushimin e hetimeve të procedimit penal, pasi është bërë analizë e detajuar e të gjitha rrethanave, provave të shumta me dëshmitarë, komunikimeve të ndryshme telefonike, sms, facebook etj., është arritur në përfundimin se për sa i përket faktit të ndodhur nuk provohet se shtetasit M.M., Sh.K. dhe Sh.D. kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen dhe për të cilat janë caktuar masat e sigurimit personal në ngarkim të tyre.

Nga vëzhgimi i vendimit të pushimit të procedimit penal të datës 22.2.2016, u konstatua se është sipas akteve të tilla procedurale dhe i përbërë nga tri pjesë: hyrëse, përshkruese arsyetuese dhe konkluduese.

Nga pikëpamja e strukturës, përgjithësisht, në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit u konstatua se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdorur referencat e duhura ligjore dhe arsyetim i plotë lidhur me argumentimin e vendimit të pushimit. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, ndonëse në disa raste fjalitë janë të gjata.

Ndaj këtij vendimi të pushimit nuk rezulton të jetë bërë ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

3. Procedimi penal nr. *, viti 2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për të cilin datë 30.12.2014, është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim**

Në këtë procedim penal si dokument ligjor i përzgjedhur në mënyrë rastësore për subjektin e rivlerësimit, e cila, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë 30.12.2016, ka vendosur:

- Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit Xh.O., të akuzuar se ka kryer veprën penale “trafikimi i të miturve” e kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

Nga vëzhgimi i akteve të procedimit penal u konstatua se mbi bazë të akteve procedurale në ngarkim të shtetasit Xh.O., të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, me shkresën nr. ***, datë 6.6.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, datë 6.6.2014, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, për veprat penale të referuara nga kjo drejtori.

Mbi këtë bazë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe konkretisht subjekti i rivlerësimit, me urdhër të datës 6.6.2014, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “trafikimi i të miturve”, parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal.

Në fashikullin e gjykimit gjendet edhe kërkesa për gjykim në emër të subjektit të rivlerësimit Elizabeta Imeraj, si dhe diskutim përfundimtar në emër të subjektit të rivlerësimit Elizabeta Imeraj. Po kështu, në këtë fashikull gjendet edhe vendimi nr. ***, datë 10.6.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kërkesa për gjykim dhe konkluzionet përfundimtare, si akte të fundit të prokurorit në këtë procedim penal, përmbajnë: strukturë të përcaktuar nga legjislacioni procedural, në të cilat paraqiten gjeneralitetet e të pandehurve; parashtrimin e faktit, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal; burimet e provave dhe faktet që ato u referohen; si dhe nënshkrimin e prokurorit.

Problematikat e konstatuara nga Komisioni

Konstatohet se vendimi i gjykatës ende nuk është i formës së prerë pasi deri në momentin e dërgimit të dosjes nuk është bërë një shënim i tillë për marrjen formë të prerë të vendimit. Gjithashtu, nuk evidentohet nëse për këtë vendim është ankim ose jo.

Nuk përcaktohet në dosje nëse subjekti i rivlerësimit ka marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor nëse ka marrë formë të prerë.

Për këto konstatime të bëra nga Komisioni subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi:

- *“Në momentin që dosja është arshivuar, vendimi i gjykatës nuk ka qenë i formës së prerë dhe, për pasojë, nuk është pjesë e fashikullit të dosjes.*

- *Të gjitha vendimet e formës së prerë vihen në ekzekutim jo nga prokurori që ka ndjekur çështjen por nga prokurorët e seksionit të ekzekutimeve dhe për rastin në fjalë ka një praktikë të plotë për ekzekutimin e këtij vendimi, sipas parashikimeve të nenit 462 e vijues të Kodit të Procedurës Penale”.*

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

4. Procedimi penal nr. *, viti 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për të cilin në datën 20.6.2014 është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim**

Në këtë procedim penal si dokument ligjor i përzgjedhur në mënyrë rastësore për subjektin e rivlerësimit, e cila në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë 20.6.2014, ka vendosur:

*Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurve:*

- *M.B., i biri i shtetasve A. dhe E., i datëlindjes 12.4.1992.*
- *E.Zh. (R.) i biri i shtetasve M. dhe H., i datëlindjes 19.6.1979,*

Duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikim i të miturve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

Nga vëzhgimi i akteve të procedimit penal u konstatua se mbi bazë të vendimit të datës 22.8.2013, “për shpalljen e moskompetencës lëndore në hetim”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjekti i rivlerësimit, me vendim të datës 3.9.2013, ka vendosur pranimin e akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, të Prokurorisë Sarandë.

Mbi këtë bazë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe konkretisht subjekti i rivlerësimit, me urdhër të datës 3.9.2013, ka vendosur pranimin e akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, të Prokurorisë Sarandë.

Ndërsa në datën 16.1.2014, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, atë të personit nën hetim E.Zh.

Gjithashtu, në datën 20.6.2014, subjekti i rivlerësimit, prokurore Elizabeta Imeraj, ka hartuar kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim, duke i kërkuar gjykatës gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurve: M.B., i biri i shtetasve A. dhe E., i datëlindjes 12.4.1992; E.Zh.(R.) i biri i shtetasve M. dhe H., i datëlindjes 19.6.1979, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikimi i të miturve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

Po kështu, në këtë fashikull gjenden edhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe vendimi nr. ***, datë 7.7.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Nga shënimet në vendimin e gjykatës konstatohet se çështja ka kaluar për gjykim nëpërmjet ankimit të të pandehurve dhe në dy shkallët e tjera të gjykimit, të cilat kanë lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Siç del nga vendimet e gjykatave, edhe në shkallët e tjera të gjykimit është pranuar kualifikimi ligjor dhe masa e dënimit për dy të gjykuarit sipas kërkesës dhe akuzës së ngritur nga subjekti i rivlerësimit.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar paraqitet pa të meta, pasi në të gjitha rastet u gjetën të plota dhe të nënshkuara nga subjekti i rivlerësimit dhe subjekte të tjerë në procedim. Aktet paraqiten të plota dhe të inventarizuara sipas inventarit përkatës.

Kërkesa për gjykim dhe konkluzionet përfundimtare, si akte të fundit të prokurorit në këtë procedim penal, përmbajnë: strukturë të përcaktuar nga legjislacioni procedural, në të cilat paraqiten gjeneralitetet e të pandehurve; parashtrimin e faktit duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal; burimet e provave dhe faktet që ato u referohen; si dhe nënshkrimin e prokurorit.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

5. Procedimi penal nr. *, i vitit 2015, që bën fjalë për veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/c dhe 22 të Kodit Penal – vendosur dërgimi për gjykim në datën 28.12.2015**

Në këtë procedim penal si dokument ligjor i përzgjedhur në mënyrë rastësore për subjektin e rivlerësimit, e cila në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë 28.12.2015, ka vendosur:

- Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit D.I., të akuzuar se ka kryer veprën penale të parashikuar nga nenet 79/c dhe 22 “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” mbetur në tentativë.

Nga vëzhgimi i akteve të procedimit penal u konstatua se mbi bazë të kallëzimit penal të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, me shkresën nr. ***, datë 16.11.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë 16.11.2015, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/c dhe 22 të Kodit Penal.

Në datën 28.12.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim, gjithashtu, në datën 28.12.2015, subjekti i rivlerësimit ka hartuar kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim, duke i kërkuar gjykatës gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit D.I., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/c dhe 22 të Kodit Penal.

Siç del nga vendimet e gjykatave, në të dyja shkallët e gjykimit është pranuar kualifikimi ligjor dhe masa e dënimit për të gjykuarin sipas kërkesës dhe akuzës së ngritur nga subjekti i rivlerësimit.

Aktet paraqiten të plota dhe të inventarizuara sipas inventarit përkatës që, përgjithësisht, korrespondon me inventarin përkatës.

Kërkesa për gjykim dhe konkluzionet përfundimtare, si akt i fundit i prokurorit në këtë procedim penal, përmbajnë: strukturë të përcaktuar nga legjislacioni procedural, në të cilat paraqiten gjeneralitetet e të pandehurit; parashtrimin e faktit, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal; burimet e provave dhe faktet që ato u referohen; si dhe nënshkrimin e prokurorit.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

III. Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme

Sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë periudhës së rivlerësimit, për subjektin Elizabeta Imeraj nuk kanë rezultuar ankesa të asnjë natyre dhe as masa disiplinore, të përfunduara apo në fuqi.

Sipas të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që për subjektin:

- të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer;
- të ketë të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);
- të ketë pasur ndaj tij procedime penale të pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Megjithatë, sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin Elizabeta Imeraj ka rezultuar të gjenden disa ankesa, të cilat do të sqarohen më poshtë dhe një kallëzim penal, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e vlerësimit, rezultoi se ka të arkivuara në sektorin e burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësimet e punës të kryera për tri vitet e periudhës së rivlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

Ankesa dhe kallëzime penale për subjektin e rivlerësimit

Me shkresën nr. ***, datë 23.10.2018, të Drejtorisë Gjyqësore, në bazë të kërkesës për informacion nr. *** prot., datë 18.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u kryen verifikimet në Zyrën e Protokoll-Arkivës, Zyrën e Informacionit të Klasifikuar, si dhe Drejtorinë e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në 23 Prokuroritë e Shkallës së Parë, për subjektin e rivlerësimit, nga përgjigjet e të cilëve, nuk rezultoi të ketë të dhëna që kanë të bëjnë me *indicie* apo të dhëna të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillim hetimesh, përfshirje drejtpërdrejt apo indirekt në veprime të dyshimta etj.

1) Megjithatë, konstatojmë se kërkesës nr. ***, datë 23.10.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është përgjigjur me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2018, me të cilën është sqaruar shprehimisht: “Në përgjigje të shkresës suaj nr. *** prot., ju informojmë se: ‘Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të kallëzimeve dhe procedimeve penale për periudhën kohore 1.1.2006 e deri në kthimin e përgjigjes nga ana jonë rezultoi se: ‘Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit

*Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi E.Sh. ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2017, kallëzim për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimin e datës 31.7.2017”.*

Nga vëzhgimi i fashikullit të mosfillimit të datës 31.7.2017, i ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2018, konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. ***, prot., datë 23.6.2017, ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimin penal të paraqitur pranë kësaj gjykate, gjatë seancës gjyqësore të datës 26.7.2017, nga të pandehurit E.Sh. dhe G.D., për prokurorët e çështjes Elizabeta Imeraj dhe E.N.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, lidhur me këtë kallëzim penal, ka urdhëruar sekretarinë e gjykatës të dërgojë në rrugë administrative kallëzimin penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky kallëzim është regjistruar në regjistrin e kallëzimeve penale në Prokurori me nr. ***, datë 3.7.2017.

Me shortin manual të datës 3.7.2017, kallëzimi i është shortuar për ndjekje prokurores A.Q., e cila në datën 31.7.2017, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në bazë të germës “ç”, të pikës 1, të neneve 290 dhe 291, të Kodit të Procedurës Penale.

Në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, prokurorja e ngarkuar ka arsyetuar se: “Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 23.6.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është përcjellë kallëzimi penal i shtetasve G.D. dhe E.Sh., si dhe akte bashkëlidhur, mbi bazën e të cilit është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 3.7.2017.

Nga përmbajtja e materialit kallëzues rezulton se:

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është për gjykim çështja penale nr. *** akti, datë 13.4.2017, regjistrimi me palë: kërkuar- Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurve E.Sh., G.D., E.Q., E.Z. dhe B.Sh., të akuzuar për kryerjen e veprave penale: “shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar, parashikuar nga nenet 109/b/1 dhe 28/4 të Kodit Penal; “kanosje për shkak të detyrës”, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar, parashikuar nga nenet 238 dhe 28/4 të Kodit Penal; “shkatërrim të pronës me eksploziv”, “grup i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 333/a/1 të Kodit Penal; “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334/1 i Kodit Penal etj.

Në gjykim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përfaqësohet nga prokurorët Elizabeta Imeraj dhe E.N.

Në seancën gjyqësore të datës 20.6.2017, nga të pandehurit G.D. etj., u paraqit një kallëzim penal në ngarkim të dy prokurorëve Elizabeta Imeraj dhe E.N., duke pretenduar se prej tyre janë veprat penale të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 etj., të Kodit Penal. Materiali kallëzues dhe aktet bashkëlidhur janë përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkëlidhur shkresës përcjellëse nr. ***, datë 23.6.2017.

Kallëzuesit E.Sh. dhe G.D. pretendojnë se procesverbali i pyetjes së shtetasit Y.B. datë 27.7.2016, ora 10:00, është i falsifikuar nga prokurorët e çështjes, duke hequr dhe shtuar fjali, të cilat nuk tregojnë realitetin, por përshtatin “fjalët” deklarin e shtetasit Y.B. në dëm të interesave të tyre. Bashkëlidhur kallëzimit, për të mbështetur pretendimet e tyre paraqesin dy procesverbalet (fotokopje) e së njëjtës datë, të së njëjtës orë, të nënshkruar nga prokurorët

e çështjes, të cilët sipas kallëzuesve, në thelb kanë përmbajtje të ndryshme dhe nuk janë të njëjtë.

Në analizë të faktit objekt kallëzimi, referuar nenit 186 të Kodit Penal: objekt i veprës penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të administratës publike, personave juridikë, të organizatave etj., mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale. Objekti material i krimit të falsifikimit mund të jetë dokumenti zyrtar apo privat. Nga ana objektive vepra penale kryhet nëpërmjet falsifikimit të një dokumenti, si dhe nëpërmjet përdorimit të dokumentit të falsifikuar. Nga ana subjektive vepra penale e falsifikimit të dokumenteve kryhet vetëm me dashje direkte. Personi e di që paraqet rrethana të rreme në një dokument dhe e dëshiron një gjë të tillë. Subjekti i veprës penale, në varësi të përcaktimit të figurës së veprës penale dhe kategorizimit sipas paragrafëve, mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm ose subjekti i posaçëm.

Mbështetur në sa më sipër, në analizë të faktit objekt kallëzimi, tërësisë së akteve të materialit kallëzues nr. ***, elementet e figurës së veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, rezulton se fakti në tërësinë e tij, për të cilin është bërë kallëzim penal, nuk përmban elementë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Kodi i Procedurës Penale, në përmbajtje të tij, përcakton qartësisht kuptimin e provës dhe dëshmisë si një ndër llojet e provave. Dëshmia formohet në gjykim. Dëshmia, si provë në procesin penal, përfitohet nga procesi i pyetjes së dëshmitarit, proces i cili zhvillohet në seancë gjyqësore. Pyetja e dëshmitarit bëhet nën debatin kontradiktor të palëve në proces. Gjithashtu, aktet procedurale të përpiluara gjatë hetimit paraprak i nënshtrohen shqyrtimit dhe verifikimit të gjykatës. Kodi i Procedurës Penale përcakton qartësisht instrumente procedurale penale nëpërmjet të cilëve mund të kërkohet pavlefshmëri apo papërdorshmëri të akteve procedurale, kërkime të cilat mbeten në vlerësimin e gjykatës.

Në këto kushte, kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, në mbështetje të gurmës “ç”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale në datën 31.7.2017, ka vendosur:

- Mosfillimin e procedimit penal lidhur me materialin procedural nr. *** regj., viti 2017.
- Të njihen me vendimin personat e interesuar.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5 ditëve nga njoftimi.

Sa më sipër, konstatohet se kallëzimi i bërë ndaj prokurorëve nga të pandehurit e sipërpërmendur ka qenë në kuadrin e mbrojtjes dhe taktikës së tyre të përdorur gjatë procesit gjyqësor penal të zhvilluar kundër tyre në gjykatë, nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, siç me të drejtë është vlerësuar edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

2) Gjithashtu, në sektorin e protokoll arkivës në Prokurorinë e Përgjithshme, shoqëruar me shkresën e Sektorit të Protokoll-Arkivës nr. ***, datë 6.11.2018, u gjetën disa ankesa të drejtuara nga shtetas të ndryshëm në emër të subjektit të rivlerësimit Elizabeta Imeraj, të depozituar pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe konkretisht:

- praktika nr. ***, viti 2014, nga shtetasi S.K.;
- praktika nr. ***, viti 2014, nga shtetasi M.L.;
- praktika nr. ***, viti 2015, nga shtetasja F.K.;
- praktika nr. ***, viti 2018, nga shtetasi F.F.;
- praktikat nr. ***, viti 2018 dhe nr. ***, viti 2016, nga shtetasi R.K.

a. Ankesa nr. *, datë 28.5.2014, e shtetasit S.K., nga Delvina, drejtuar Prokurorit të Përgjithshme**

Nga vëzhgimi i kësaj ankese dhe akteve verifikuese të shqyrtimit të saj, konstatohet se i quajturi S.K., lindur dhe banues në Delvinë, është prindi i shtetasës F.K., e cila është e dëmtuar nga vepra penale “shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, kryer në bashkëpunim nga shtetasit M.B., E.Zh. dhe B.Z.

Në ankim ky shtetas duke vlerësuar se prokurore Elizabeta Imeraj ka kryer hetime të njëanshme në lidhje me shtetasin B.Z., i cili është personi që e ka shfrytëzuar vajzën e tij F.K. për 15 ditë rresht në hotelet e Sarandës, ka kërkuar zëvendësimin e saj me një tjetër prokuror. Gjithashtu, shtetasi ankohet se prokurorja sillet shumë keq me të dëmtuarën dhe me prindërit e saj.

U konstatua se me shkresën nr. ***, datë 27.6.2014, Prokuroria e Përgjithshme me lëndë “Mbi kërkesën e shtetasit S.K.”, ka dërguar në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë, ankesën me këtë përmbajtje:

“Në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 28.5.2014, është depozituar për dijeni kërkesa e shtetasit S.K., banor i rrethit të Delvinës, nëpërmjet së cilës kërkohet zëvendësimi i prokurores Elizabeta Ymeri, në kuadrin e procedimit penal ku e dëmtuar është vajza e kërkuesit.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit nga ana juaj të kërkesës sipas përcaktimeve dhe afateve të parashikuara në nenet 110/2 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, për vendimin përkatës të njoftohet kërkuesi dhe Prokuroria e Përgjithshme”.

U konstatua se pothuajse me të njëjtën përmbajtje, në Prokurorinë e Përgjithshme, ka arritur edhe një ankesë nga shtetasi S.K., e cila është protokolluar me nr. *** prot., datë 9.6.2014. Kjo ankesë është përpunuar nga sektori i marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme datë 2.7.2014, duke e arkivuar me shënimin e drejtuesit, datë 7.7.2014.

Gjithashtu u konstatua se kjo ankesë nga shtetasi S.K. ishte dërguar për dijeni edhe në disa drejtime të tjera, prandaj ajo ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila është protokolluar me nr. ***, datë 4.7.2014. Kjo praktikë rezulton se është arkivuar pa kryer veprime të tjera, pasi i ishte dhënë zgjidhje ankimit të ardhur drejtpërdrejt në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

b. Kërkesë e shtetasve M. dhe V. L., e protokolluar me nr. *, datë 18.2.2014, në sektorin e marrëdhënieve me publikun, drejtuar Drejtuesit të Krimeve të Rënda**

Nga vëzhgimi i kërkesës dhe akteve bashkëlidhur saj, konstatohet se në adresë të Drejtuesit të Krimeve të Rënda ka arritur në Prokurorinë e Përgjithshme kërkesa e shtetasve M. dhe V.L., e cila është regjistruar me nr. ***, datë 18.2.2014, në sektorin e marrëdhënieve me publikun, pranë këtij institucioni.

Kërkesa e këtyre shtetasve, e shkruar me shkrim dore në katër faqe, bën me dije se ka tre vjet që një trafikant 40-vjeçar, ka marrë vajzën e tyre në vitin e katërt të shkollës “****”, në Kamzë dhe kërkon që të hetohet me objektivitet. Sipas kërkesës për këtë fakt, i ka bërë të ditur çdo gjë prokurores Elizabeta Imeraj, por nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk po punohet për të kryer hetime të plota, për të ditur se ku e ka vajzën dhe se kush e mban dhe e shfrytëzon atë.

Në këto kushte, duke bërë me dije se një letër e ka drejtuar dhe në adresë të Prokurorit të Përgjithshëm, i kërkon Drejtuesit të Krimeve të Rënda zbulimin e autorëve dhe shfrytëzimit

të vajzës së tij.

U konstatua se me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2014, nga Drejtori i Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale të Veprave të Tjera dhe të të Miturve, është kërkuar informacion nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, lidhur me ankesën e shtetasit M.Ll.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, gjendet i administruar informacioni në lidhje me hetimin e çështjes penale nr. ***, viti 2013. Ky informacion ka të bëjë me procedimin penal nr. ***, të regjistruar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit M.Ll., që lidhet me largimin nga banesa të vajzës së tij B.Ll. për në drejtim të panjohur, duke pretenduar se është e trafikuar.

Pas marrjes së këtij informacioni dhe pas një analize të kryer në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimeve dhe Ndjekjes Penale, me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2014, janë dërguar në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë, në mënyrë të shkruar, një sërë detyrash për t'u kryer nga prokurorja Elizabeta Imeraj.

Në këto kushte, kërkesa e sipërpërmendur është arkivuar pas dërgimit të detyrave hetimore të përpiluara në shkresën e mësipërme, të cilat kanë dalë edhe në analizën e përbashkët të zhvilluar në prani të prokurores së çështjes subjekt i rivlerësimit.

Sa më sipër, rezulton që gjatë shqyrtimit të kërkesës së letërshkruesve nuk janë konstatuar veprime të papërshtatshme në detyrën e prokurores, subjekt rivlerësimi, gjatë kryerjes së hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2013, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Në përfundim të analizës dhe verifikimeve nuk u konstatuan probleme nga Komisioni.

c. Ankimi nr. *, viti 2015, nga shtetasja F. K., drejtuar prokurorit të Krimeve të Rënda Tiranë dhe për dijeni Prokurorit të Përgjithshëm dhe trupit gjykues në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë**

Nga vëzhgimi i këtij ankimi dhe akteve bashkëlidhur tij, konstatohet se me nr. ***, datë 24.2.2015, në sektorin e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar ankimi i shtetasës F.K.

Kjo shtetase ankohet ndaj prokurores Elizabeta Imeri, "për mosarrestimin e shtetasit B.T., si autor i dy veprave penale "shfrytëzim i prostitucionit me të mitura" dhe "mbajtje e hotelit për prostitucion", të parashikuara nga nenet 114/a dhe 115 të Kodit Penal. Kjo shtetase ka pretenduar se shtetasit M.B., E.Zh. dhe B.T., të tre së bashku janë personat që e kanë shfrytëzuar për prostitucion në rrethana rënduese, trafikuar të mitur dhe mbajtje e lokaleve për prostitucion shtetasen F.K.

Dy personat e parë janë të arrestuar pas disa përprjekjeve të babait të së dëmtuarës nga Policia Sarandë dhe më pas nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

Është bërë sigurimi i provës me kërkesën e të dëmtuarës dhe prokurores Elizabeta Ymeri, pasi personi B.T., që ndodhet jashtë hekurave kërcënon të dëmtuarën dhe familjen e saj se do t'i vrasë. Nga sigurimi i provës rezulton se shtetasi B.T. është personi kryesor që ka shfrytëzuar për prostitucion në lokalit të tij të dëmtuarën F.K. Janë të gjitha provat për të marrë të pandehur edhe personin tjetër B.T. për krimin që ka bërë dhe që kërcënon se do t'i vrasë.

Prokuroria nuk ka dashur që të vërë pas hekurave shtetasin B.T. edhe pse është kryesori në këtë veprë penale ndaj të dëmtuarës. Po ju dërgojmë kallëzimin që ka bërë e dëmtuara pranë organit të policisë, sigurimin e provës marrë nga gjykata dhe aktekspertimin mjeko-ligjor.

Nga vëzhgimi i akteve rezultoi se në zgjidhje të kësaj ankese, me shkresën nr. *** prot., datë

17.3.2015, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore ka kërkuar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë dosjen hetimore që lidhet me rastin e pretenduar, nëse hetimi i saj ka përfunduar dhe në rast të kundërt, nëse dosja është në hetim është kërkuar një informacion rreth çështjes.

Konstatohet se prokurorja Elizabeta Imeraj, në përgjigje të kërkesës së mësipërme, ka sjellë një informacion prej tre faqesh me të cilin ka informuar për ecurinë e hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Mbi këtë bazë, nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, me shkresën nr. ***, datë 15.4.2015, i ka kthyer përgjigje rreth ankimit shtetas F.K.

Konstatohet se gjatë shqyrtimit të ankimit të mësipërm, nga Drejtoria e Inspektimit nuk janë vërejtur qëndrime apo veprime të papërshtatshme nga prokurorja Elizabeta Imeraj, subjekt rivlerësimi, gjatë kryerjes së hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2013, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Konstatim i Komisionit

Procedimi penal për të cilin ankohet znj. F.K. është pjesë e pesë dokumenteve të shortuara për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me këtë procedim është konstatuar se:

Në këtë procedim penal si dokument ligjor i përzgjedhur në mënyrë rastësore për subjektin e rivlerësimit Elizabeta Imeraj, e cila në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, datë 20.6.2014, ka vendosur: *Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, viti 2013, në ngarkim të të pandehurve:*

- M.B., i biri i shtetasve A. dhe E., i datëlindjes 12.4.1992;
- E.Zh. (R.), i biri i shtetasve M. dhe H., i datëlindjes 19.6.1979,

duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikim i të miturve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal.

Nga vëzhgimi i akteve të procedimit penal u konstatua se mbi bazë të vendimit datë 22.8.2013, “për shpalljen e moskompetencës lëndore në hetim”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, subjekti i rivlerësimit, me vendim të datës 3.9.2013, ka vendosur pranimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2013, i Prokurorisë Sarandë.

Mbi këtë bazë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe konkretisht prokurorja Elizabeta Imeraj/subjekt rivlerësimi, me urdhër të datës 3.9.2013 ka vendosur pranimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2013, të Prokurorisë Sarandë.

Ndërsa në datën 16.1.2014, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, atë të personit nën hetim E.Zh.

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet në të cilat dokumentohen veprimet hetimore të kryera rezultoi se shtetasja F.K., e bija e shtetasve S. dhe E, të datëlindjes 13.3.1997, është lidhur në një marrëdhënie dashurore me shtetasin M.B. E dëmtuara F.K. jetonte me familjen e saj të përbërë nga babai, nëna dhe motra e mitur në qytetin e Delvinës. Për disa kohë me radhë e dëmtuara ka mbajtur lidhje me shtetasin M.B., duke u shoqëruar dhe duke dalë me të. Gjatë kohës që e dëmtuara ka qenë e lidhur me të pandehurin M.B., ky i fundit i ka propozuar për të shkuar në Greqi, me qëllim që të jetonin aty për një jetesë më të mirë. I pandehuri M.B. i kishte treguar të dëmtuarës se për lëvizjen në drejtim të Greqisë do t'i ndihmonte një shok i tij i quajtur E.Zh. Udhëtimi për në drejtim të Greqisë është bërë më 3.7.2013 dhe udhëtimi është planifikuar të realizohet

nëpërmjet pikës së kalimit të kufirit K***. E dëmtuara ka qenë duke udhëtuar me automjetin e të pandehurit E.Zh. dhe në praninë e të pandehurit M.B. Këta shtetas kanë udhëtuar me automjetin me targa ***.

Në momentin që kanë mbërritur në Greqi e dëmtuara F.K. është strehuar në një banesë, e cila ishte marrë me qira nga i pandehuri E.Zh., banesë në të cilën jetonte edhe një vajzë tjetër, që sipas të dëmtuarës quhej A. dhe ushtronte prostitucion në Greqi për llogari të shtetasit E.Zh. Me t'u vendosur në këtë banesë e dëmtuara është përballur me propozimin që duhej të punonte si prostitutë, për të realizuar përfitime për të pandehurit M. dhe E., propozim ky që i është bërë edhe nga i pandehuri M.B. dhe nga i pandehuri E.Zh. Nga ana tjetër e dëmtuara është vendosur në kushtet e trysnisë psikologjike dhe fizike duke qenë se është dhunuar fizikisht dhe seksualisht nga i pandehuri E.Zh. Pasi ka qëndruar për pak kohë në banesën e të pandehurit E.Zh., e dëmtuara ka mundur të largohet fshehurazi nga banesa e tij, duke i marrë këtij të fundit telefonin e tij. Pasi është larguar prej andej ka komunikuar në telefon me të pandehurin M.B., duke i treguar se ku ndodhej dhe faktin se dëshironte të takohej me të. Në marrjen e një vendimi të tillë ka ndikuar dhe mosha e të miturës dhe fakti që ndodhej në një qytet të panjohur për të dhe pa mbështetje. Pasi është takuar me shtetasin M.B., e dëmtuara është kthyer në Shqipëri ku M. e ka prezantuar te familjarët e saj si personin me të cilin kishte një lidhje dashurore. Pasi kanë qëndruar për disa ditë në banesën e të dëmtuarës, i pandehuri M.B. dhe e dëmtuara kanë dalë duke jetuar më vete, ku gjatë kësaj kohe i dyshuari M.B. e ka detyruar të dëmtuarën F.K. të kryejë marrëdhënie seksuale kundrejt pagesës me persona të panjohur prej saj. Në lidhje me këtë veprimtari përfitimet monetare merreshin nga i pandehuri M.B.

Në lidhje me subjektin M.B.konkludohet se ky shtetas, në bashkëpunim me shtetasin E.Zh., ka kryer veprime aktive me qëllim trafikimin e të dëmtuarës së mitur F.K.

Në drejtim të realizimit të veprimtarisë së tij i dyshuari në mënyrë të vazhdueshme ka kryer veprime aktive duke e joshur të dëmtuarën, duke realizuar lidhje me të, duke i krijuar asaj besimin se ishte i dashuruar me të, përgatit planin për lëvizjen jashtë shtetit, konkretisht në Greqi për ta vendosur në gjendje vulnerabël për efekt shfrytëzimi.

Veprimet e kryera nga i pandehuri M.B. në bashkëpunim me të pandehurin E.Zh. konsistojnë në: marrjen e masave të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë; gjetjen e vajzës; joshjen e saj; dërgimin e saj në banesë; sigurimi i automjeteve (automjeti me të cilin kanë udhëtuar, banesa në Greqi), etj.; kryerjen e veprimeve aktive në bashkëpunim.

Për sa më sipër, konstatohet se bëhet fjalë për një veprimtari të shtrirë në kohë në drejtim të rekrutimit, mbajtjes për qëllim të shfrytëzimit të femrës për prostitucion me qëllim fitimi të një shtetaseje të mitur.

Për sa më sipër, rezulton se në bazë të akteve që ndodhen në dosje të pandehurit kanë kryer veprën penale të trafikimit të të miturve, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b/3, në dëm të shtetasës F.K.

Siç rezulton më lart emri i z. B.T. (B.Z.) për të cilën e dëmtuara deklaron se e ka shfrytëzuar nuk rezulton të jetë pjesë e këtij procedimi.

Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja që subjekti i rivlerësimit nuk ka përfshirë në këtë procedim penal edhe shtetasin B.T. (B.Z.).

Për këtë çështje subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me kërkesat e bëra dhe kthimin e përgjigjes për përfshirjen ose jo të personit tjetër në hetim të shtetasit B.Z., sqarime për mospërfshirjen e këtij shtetasi nën hetim, si dhe informacion lidhur me të gjitha veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi:

- Çështja penale ka pasur në themel të hetimit deklaratimet e dhëna nga vetë e dëmtuara dhe përputhshmëria e këtyre deklaratimeve me prova të tjera.

- Për ato pjesë të deklaratimeve të mbështetura me prova është vendosur ngritja e akuzës dhe dërgimi i çështjes për gjykim.

- Pretendimi si një ndër 'klientët' për shtetasin B.T. ka mbetur vetëm në deklaratimet e të dëmtuarës.

- Çështja lidhet me momentin e çmuarjes së provave të administruara nga magjistrati gjatë hetimit.

- Një referim të qëndrimit ka mbajtur edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin me nr. 28 datë 23.10.2020.

- Vendimmarrja ime si prokurore nuk paraqet asnjë defekt në mënyrën e arsytimit dhe argumentimit të kësaj çështjeje”.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

d. Letra nr. *, datë 17.8.2018, e shtetasit F.F., nga I EVP-ja Fier, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm**

Nga vëzhgimi i kësaj ankese dhe akteve verifikuese të shqyrtimit të ankesës, konstatohet se i quajtori F.F. është person i dënuar duke vuajtur dënimin penal pranë I EVP-së Fier. Ky person është ankuar se ai dhe shtetasi D.K. janë dënuar pa pasur prova në ngarkim të tyre, por prokurorët P.K. dhe Elizabeta Imeraj nuk dinë se ku i gjetën ato prova duke pretenduar më tej se nga ana e tyre u janë dërguar njerëz për të paguar një shumë prej 20-25 mijë euro që të liroheshim. Por, sipas tij, ai dhe D.K. nuk kishin lekë për të paguar dhe për këtë janë dënuar me nga 10 vjet burg.

Nga vëzhgimi i akteve rezultoi se me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2018, Drejtoria e Ndhmës për Subjektet e Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Studimeve, Projekteve, i ka kthyer përgjigje shtetasit F.F., si vijon:

“Vendimi penal me të cilin jeni dënuar rezulton se ka marrë formë të prerë.

Në bazë të nenit 449 të Kodit të Procedurës Penale, ky vendim mund të priset vetëm me kërkesë për rishikimin e tij.

Për këtë arsye, nëse juve keni shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 35/2017, për disa shtetas dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, mund t’i drejtoheni Gjykatës së Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, me kërkesë për rishikimin e vendimit të dënimit.

Gjithashtu, nëse për gjithë pretendimet që ju ngrini keni të dhëna të bazuara në dokumente që vërtetojnë kryerjen e ndonjë vepre penale në dëm të interesave tuaja nga punonjës shtetërorë, apo në shërbimin publik ose nga persona të tjerë, ju mund të bëni kallëzim me shkrim drejtuar Prokurorisë kompetente”.

Në këto kushte, ankesa është arkivuar dhe lidhur me këtë përgjigje nuk rezultoi të ketë pasur reagim tjetër nga ankuesi.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

e. Letra e shtetasit R.K., ardhur nga Ministria e Drejtësisë, e protokolluar me nr. *, në vitin 2016, etj., në sektorin e marrëdhënieve me publikun**

Nga vëzhgimi i kësaj praktike ankimore dhe akteve verifikuese bashkëlidhur saj konstatohet se i quajtori R.K., me banim në B*** Kamzë Tiranë, në vitin 2016, i është drejtuar me ankesë Prokurorit të Përgjithshëm, duke kërkuar përshpejtim të hetimit ndaj djalit të tij të quajtur E.K.

Në lidhje me këtë ankesë, drejtoresha e kabinetit pranë Prokurorit të Përgjithshëm me shkresën nr. ***, datë 11.1.2017, e ka dërguar për kompetencë dhe zgjidhje ligjore letrën e tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke sugjeruar se në lidhje me vendimmarrjen të njoftohet letërshkruesi. Me këtë shkresë është vënë në dijeni edhe shtetasi R.K.

Gjithashtu, në sektorin e marrëdhënieve me publikun është regjistruar letra me nr. ***, datë 24.1.2017, e shtetasit R.K., tashmë e ardhur në Prokurori të Përgjithshme nga Kryeministria, me sugjerimet përkatëse.

Të ndodhur në kushtet që letra e mëparshme ishte dërguar për kompetencë dhe për të ishte vënë në dijeni letërshkruesi, kjo praktikë është arshivuar pa u kryer veprime të mëtejshme.

Më tej konstatohet se, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në Prokurorinë e Përgjithshme është shënuar telegram me nr. ***, datë 9.2.2017, që shtetasi R.K. i ka drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, me këtë përmbajtje *“Unë R.K. të kam dërguar dy letra dhe nuk janë marrë parasysh nga ana juaj. Djali im E.K. ka 6 muaj në burg pa prova pa fakte. Unë dua takim me juve”*. Në fund ka dhënë adresën e tij dhe numrin e telefonit celular.

Në sektorin e marrëdhënieve me publikun, në Prokurorinë e Përgjithshme ka ardhur letër tjetër me nr. ***, datë 26.12.2017/ ***, e këtij shtetasi tashmë drejtuar Prokurores së Përgjithshme A.M.

Në këtë letër, pasi bën të ditur se djali i tij është dënuar pa asnjë provë dhe për letrat e mëparshme të drejtuara në drejtime të ndryshme, pretendon se kjo ka ardhur si rezultat i prokurorëve të Krimeve të Rënda, B.H. dhe Elizabeta Imeraj, të cilët kanë ndërtuar një proces fiktiv dhe pa asnjë provë ndaj djalit, pasojë e të cilave ky i fundit vuan një dënim të pamerituar. Shtetasi R.K. shprehet se: *“Këta dy prokurorë, me anë të sekserëve më kanë kërkuar 50.000 euro që ta lirojnë tim bir, por unë edhe po të kisha nuk ua jepja, se kështu do të pohoja një krim që im bir nuk e ka kryer”*.

Nga vëzhgimi i akteve rezultoi se me shkresën nr. ***, datë 2.2.2018, Drejtorja e Ndhmës për Subjektet e Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Studimeve, Projekteve, i ka kthyer përgjigje shtetasit R.K., si vijon:

“Në lidhje me kërkesën tuaj drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ju informojmë se:

Pas njohjes me pretendimet tuaja dhe siç shpreheni se aktualisht procedimi penal po gjykohet në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në mbështetje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, pretendimet mbi rregullsinë e procesit të hetimit apo veprimeve hetimore të kryera, janë objekt vlerësimi gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën kompetente, e cila vlerëson provat e mbledhura gjatë hetimit të organit të prokurorisë.

*Ju bëjmë me dije se të gjitha pretendimet që ju keni me procedimin penal, duhet t'i paraqitni përpara Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda ku jeni edhe në pritje të vendimit. Gjithashtu, nëse për gjithë pretendimet që ju ngrini keni të dhëna të bazuara në dokumente që vërtetojnë kryerjen e ndonjë veprë penale në dëm të interesave tuaja nga punonjës shtetërorë apo në shërbimin publik ose persona të tjerë, ju mund të bëni kallëzim me shkrim drejtuar Prokurorisë së Rrethit tuaj Gjyqësor”. Gjithashtu, brenda kësaj praktike është regjistruar me nr. ***, datë 21.2.2018, ankesa e shtetasit R.K., e ardhur tashmë nga Ministria e Drejtësisë.*

Edhe në këtë letër të drejtuar para Ministrisë së Drejtësisë, letërshkruesi rezulton të ketë pretenduar për veprime korruptive të prokurorëve B.H., Elizabeta Imeraj dhe S.A.”.

Përsëri me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2018, Drejtoria e Ndhmës për Subjektet e Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Studimeve, Projekteve, i ka kthyer përgjigje shtetasit R.K., si vijon:

“Nga institucioni i Ministrisë së Drejtësisë është paraqitur për trajtim në adresë të Prokurorisë së Përgjithshme ankesa juaj, në të cilën, ngrini pretendime në lidhje me akuzën e ngritur nga Prokuroria për Krime të Rënda në ngarkim të djalit tuaj E.K., si dhe ndaj vendimeve të gjykatës, e cila e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me 20 vjet burg.

Ju bëjmë me dije se sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale si dhe ligjit nr. 96/2016 “Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prokurorët janë të pavarur në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim. Në këto rrethana, Prokurori i Përgjithshëm nuk ka asnjë të drejtë të vlerësojë drejtësinë e vendimeve/akteve të prokurorit të çështjes. Sipas ligjit, vetëm gjykata është institucioni që vlerëson akuzën e ngritur nga prokurori.

Sa i takon pretendimit tuaj se disa prokurorë të Prokurorisë për Krime të Rënda, kanë kryer veprime korruptive duke iu kërkuar sekserëve 50.000 euro, juve kini të drejtën të bëni kallëzim penal sipas formës së parashikuar nga ligji”.

Në këto kushte, ankesa është arkivuar dhe lidhur me këtë përgjigje nuk rezultoi të ketë pasur reagim tjetër nga ankuesi.

Në përfundim të verifikimeve dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika.

IV. Analiza e Gjetjeve³¹

Analiza e Gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se bën referim të saktë dhe të drejtë në normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi analizon normën penale të zbatueshme, në raport me faktet dhe provat, duke bërë referime dhe në ligje të tjera që kanë lidhje me çështjen konkrete.

Subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj është vlerësuar si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

³¹ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet, kërkesat dhe aktet e tjera të përpiluara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Përgjithësisht, respekton mirë rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit procedural të prokurorit. Struktura e dokumenteve ligjore të saj u konstatua e qëndrueshme, e mirorientuar dhe e standardizuar, bazuar në formularët standard në nivel prokurorie. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe analizon në tërësi rrethanat e faktit. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti u ka kushtuar rëndësi analizës së normave ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë, duke hetuar e përfaqësuar në gjykim kryesisht vepra penale si “trafikimi i personave” dhe “trafikimi i të miturve”, të parashikuara respektivisht nga nenet 110/a dhe 128/b e Kodit Penal, kryerja e veprave penale me qëllime terroriste, si dhe në korrik të vitit 2016 e në vazhdim veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe hetimin e pasurive kriminale.

Sa iu përket të dhënave statistikore nga prokurori Elizabeta Imeraj janë deklaruar 144 çështje të caktuara përgjatë viteve 2014 – 2016, ka përfunduar 109 çështje dhe ka mbartur gjithsej 35 çështje nga viti 2016 për vitin 2017.

Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësi në organizimin e punës, respektim të afateve hetimore dhe përpjekje për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen. Edhe në rastet e procedimit penal ku janë zgjatur afatet hetimore, vendimi është i arsyetuar duke përmendur shkaqet që e kanë diktuar atë, në mënyrë të justifikuar. Nga aktet e analizuara nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje të qëllimshme në kryerjen e veprimeve hetimore apo në kalimin për veprim të tyre të shërbimit të policisë gjyqësore, që ka çuar edhe në zgjidhjen e tyre sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj është eficient dhe efektiv në drejtim të kohës së hetimit. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së saj nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila për natyrën e çështjeve të hetuara vlerësohet se ka qenë relativisht e lartë. Në pjesën më të madhe të çështjeve të ndjekura prej saj, hetimet kanë përfunduar në afate të arsyeshme.

Subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj është vlerësuar si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve hetimore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Nuk u konstatuan mungesa në përmbajtjen formale të akteve, si shënimi i datave, nënshkrimi i pjesëmarrësve në të. Në fashikuj përfshihen të gjitha aktet që i përkasin çdo çështjeje konkrete.

Subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj për tre vitet e fundit është vlerësuar si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe angazhimet e shumta profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të saj, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Prokurorja Elizabeta Imeraj, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore dhe u konstatua se për tre vitet e fundit subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj është vlerësuar si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur formularit të vetëvlerësimit profesional dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore nuk u evidentuan raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Elizabeta Imeraj. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i saj nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim të tyre. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Duke marrë parasysh të dhënat arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj për tre vitet e fundit është vlerësuar si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit me palët e tjera në proces dhe me gjykatën. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur një sjellje shumë të mirë, të komunikueshme dhe me kompetencë profesionale në diskutime teknike, për çështje të ndryshme. Ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është e hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

Subjekti i rivlerësimit Elizabeta Imeraj për tre vitet e fundit është vlerësuar, si vijon:

- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2014;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2015;
- vlerësimi “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2016.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është e gatshme të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese. Është e hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2001, ka marrë titullin “Jurist” në Universitetin e Tiranës, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, profili prokuror, gjatë viteve 2001 – 2005.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe paraqitur dokumentet vërtetuese se marrë titullin “Doktor i Shkencave Juridike” me datë 24.3.2015, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe titullin “Profesor i Asociuar”, me vendimin nr. ***, datë 23.6.2016, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, datë 16.9.2016.

Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka deklaruar dhe paraqitur dokumente specializimi në të drejtën penale, si dhe publikime të shumta, monografi dhe botime në vite të ndryshme çka flet për një angazhim të gjithanshëm të aktivitete të shumta profesionale, personale dhe etiko- morale gjatë punës së saj si prokurore.

Konstatohet dukshëm se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit ashtu dhe në periudha të tjera të mëparshme, duke paraqitur dokumentet që vërtetojnë pjesëmarrjen në këto aktivitete.

Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, subjekti deklaroi se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh jashtë Shkollës së Magjistraturës, brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në drejtime të ndryshme të fushës penale, në lidhje me veprat penale të korrupsionit, trafikimit të genieve njerëzore, terrorizmit, krimin ekonomik-financiar, pastrimit të parave dhe veprave penale kompjuterike, duke shprehur gatishmërinë e lartë të saj për t'u rritur nga ana profesionale.

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 37 denoncime. Disa denoncime janë përsëritur dhe gjithsej janë 26 denoncime. Me shkresën nr. ***, datë 19.2.2020, iu kërkua informacion Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe verifikim të rasteve të denoncimeve të paraqitura. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020, KLP-ja ka kthyer përgjigje shoqëruar me dokumentacionin e mbledhur për çështjet e shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit. Pas administrimit të dokumenteve të nevojshme nga denoncimet dhe praktikën e dërguar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, u analizua dhe u përgatit relacioni lidhur me të gjitha denoncimet e paraqitura për këtë subjekt.

1. Denoncim i shtetasit A.M., i cili në aspektin profesional është bërë me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka mbyllur një çështje penale për zhdukjen e një shtetasi me shtetësi maqedonase në vitin 1995. Për këtë çështje rezultoi se prokuroria (përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit) ka ndjekur procedurat hetimore dhe ka dërguar për gjykim disa nga të pandehurit përkatës dhe njëri nga të pandehurit është dënuar nga gjykata me 15 vjet burgim. Për disa të pandehur të tjera akuza nuk është gjetur e provuar. Procesi penal ka ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit deri në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga Prokuroria dhe mbrojtësi i të pandehurit.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë çështje të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, pasi çështja ka ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit në gjykatë.

2. Denoncim i shtetasës A.H., i cili është me të njëjtin objekt si në pikën 1 më sipër.

3. Denoncim i shtetasve A. dhe M.Ll., i cili është bërë me pretendimin e zvarritjeve të hetimit për 15 muaj. Kallëzimi i këtyre shtetasve është bërë në Prokurorinë e Tiranës dhe më pas ky kallëzim i ka kaluar për ndjekje Prokurorisë së Rrethit Durrës.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë çështje, pasi çështja në këtë procedim penal i ka kaluar Prokurorisë Durrës për shkak të kompetencës.

4. Denoncim anonim nr. ***, datë 24.7.2019, paraqitur në Komision, i cili është bërë me pretendimin për shkelje ligjore të subjektit dhe dërgimi i disa çështjeve të hetuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në prokuroritë e rretheve për qëllime korruptive.

Nuk rezultuan problematika, pasi denoncuesi është anonim dhe nuk ka paraqitur dokumente shoqëruese për vlerësim për asnjë çështje konkrete.

5. Denoncim i shtetasit A.Z., i cili ka të bëjë me pretendimin për kryerjen e veprimeve të njëanshme të subjektit dhe shkelje ligjore.

Çështja për këtë denoncues është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Pas hetimeve të kryera subjekti ka kërkuar dënimin e shtetasit A.Z., për veprën penale “korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror”. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në vitin 2018 ka vendosur dënimin e shtetasit A.Z. me 5 vjet burgim. Çështja pritet të shqyrtohet në Gjykatën e Lartë. Denoncuesi në datën 5.6.2018 ka depozituar kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit dhe prokuroria në datën 18.6.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim, i cili nuk është ankimuar nga denoncuesi.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë çështje, pasi subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionet e saj si prokurore në këtë procedim penal dhe vendimmarrje për deklarim ose jo fajtor të subjektit i përket gjykatës.

6. Denoncim i shtetasit A.Ç., i cili është bërë sipas formularit standard nuk ka të përcaktuar qartë shkaqet e ankimit. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përcjellë aktet e prokurorëve të çështjes (subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar si prokurore e çështjes për çështjen e mësipërme). Subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar funksionet e prokurorit të çështjes, pasi çështja është hetuar nga prokuror tjetër.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

7. Denoncim i shtetasve A.B. dhe avokatit F.Gj., i cili ka të bëjë me pretendimin për shpërdorim detyre. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe avokati, si dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë vendimmarrëse në procedimet penale që lidhen me shtetasin A.B. Subjekti i rivlerësimit ka firmosur aktet e Prokurorisë së Tiranës në vitin 2018, si Drejtuese e Prokurorisë dhe jo si prokurore e çështjes.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

8. Denoncim i shtetasit D.B., i cili është bërë sipas formularit standard nuk ka të përcaktuar qartë shkaqet e ankimit. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e hetimit, procedimi penal apo vendimmarrje si prokurore e çështjes lidhur me këtë shtetas.

Subjekti nuk ka ushtruar rolin e prokurorit të çështjes.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim i shtetas D.Xh., i cili ka të bëjë me pretendimin për shkelje ligjore për të cilin ka depozituar dhe një kallëzim penal. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesja dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e procedimit penal si prokurore e çështjes lidhur me këtë shtetase, por ka firmosur shkresat përcjellëse në rolin e Drejtueses së Prokurorisë.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

10. Denoncim i shtetasit D.M., i cili ka të bëjë me pretendimin për korrupsion politik ose paaftësi në zbatimin e ligjit. Denoncuesja ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, por nuk jep detaje dhe sqarime lidhur me shkeljet e pretenduara të kryera nga subjekti.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

11. Denoncim i shtetas E.C., i cili ka të bëjë me pretendimin për mosfillimin e procedimit penal. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesja dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e procedimit penal si prokurore e çështjes lidhur me këtë shtetase, por ka ushtruar funksionet në rolin e Drejtueses së Prokurorisë.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

12. Denoncim i shtetasit E.P., i cili ka të bëjë me pretendimin për mitmarrje. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e hetimit, procedimi penal apo vendimmarrje si prokurore e çështjes lidhur me çështjen objekt denoncimi (çështja është ndjekur nga prokurori L.F.).

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

13. Denoncim i shtetasit E.L., i cili ka të bëjë me pretendimin për falsifikim dhe mashtrim. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se nga ky shtetas janë bërë 15 kallëzime penale. Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi në asnjë rast si prokurore që ka ndjekur dhe kryer hetimin penal lidhur me këtë shtetas. Praktikrat janë firmosur nga subjekti i rivlerësimit në rolin e Drejtueses së Prokurorisë.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim procedural apo vendimmarrje lidhur me këtë denoncues.

14. Denoncim i shtetasit E.C., i cili ka të bëjë me pretendimin për ndikim të paligjshëm të subjektit të rivlerësimit. Nuk rezultoi se subjekti i rivlerësimit të ketë pasur në proces çështje penale të denoncuesit, por këto çështje janë ndjekur nga prokurorë të tjerë. Praktikrat janë firmosur nga subjekti i rivlerësimit vetëm në rolin e Drejtueses së Prokurorisë.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim procedural apo vendimmarrje lidhur me këtë denoncues.

15. Denoncim i shtetasit F.K., i cili ka të bëjë me pretendimin për sorollatje dhe zvarritje të kallëzimit të bërë nga ky shtetas. Denoncimi është bërë për disa gjyqtarë dhe çështja i është drejtuar për ndjekje prokurorisë përkatëse. Nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë firmosur dhe ndjekur çështjen apo të ketë dërguar praktikën e dërgimit për kompetencë. Dërgimi për kompetencë në prokurorinë përkatëse është bërë nga drejtuesi i seksionit përkatës (prokurori G.Q.).

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim, pasi subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë kryer asnjë veprim procedural, vendimmarrje apo veprime të tjera lidhur me këtë denoncues, si prokurore e çështjes.

16. Denoncim i shtetasit G.H., i cili është bërë sipas formularit standard nuk ka të përcaktuar shkaqet e ankimit, të dhënat rreth shkeljes ligjore dhe veprimin dhe praktikën e dyshuar.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

17. Denoncim i shtetasit Gj.M., i cili ka të bëjë me pretendimin për nivel të ulët profesional. Çështja penale e denoncuar nga shtetasi Gj.M. është ndjekur nga një tjetër prokuror. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pranuar zëvendësimin e prokurorit të çështjes, pasi nga Drejtuesja e Prokurorisë nuk është gjetur e drejtë kërkesa për zëvendësim (vendimi i datës 15.10.2019).

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

18. Denoncim i shtetasit H.T., i cili nuk ka të bëjë me ndonjë çështje direkte të denoncuesit, por denoncimi është bërë për disa çështje në mënyrë të përgjithshme. Denoncuesi nuk e ka shoqëruar denoncimin e tij me asnjë dokument provues për t'u vlerësuar nga Komisioni.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

19. Denoncim të shtetasve K. dhe A.C., i cili ka të bëjë me pretendimin për pushim të padrejtë të hetimeve dhe falsifikim. Ankimi ndaj vendimit të pushimit nuk i ngarkohet subjektit të rivlerësimit por prokurorit të çështjes (prokurori i çështjes Gj.T.). Ankuesi i është drejtuar gjykatës për kundërshtim të vendimit të pushimit dhe çështja pritët të shqyrtohet nga gjykata.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit, e cila nuk rezultoi të ketë qenë prokurore e çështjes dhe çështja është objekt shqyrtimi gjyqësor.

20. Denoncim i shtetas R.Rr., i cili ka të bëjë me pretendimin për mosfillim procedimi penal. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e hetimit, procedimi penal apo vendimmarrje si prokurorë e çështjes lidhur me këtë shtetas (ndjekur nga prokurori E.M.).

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

21. Denoncim i shtetasit S.K., i cili ka të bëjë me pretendimin për hetim të njëanshëm. Subjekti i rivlerësimit ka ndjekur një çështje penale për veprën e trafikimit të të miturve, kryer në bashkëpunim. Në përfundim të hetimit ka dërguar për gjykim 2 shtetas, të cilët janë deklaruar fajtorë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda dhe lënë në fuqi nga gjykatat e shkallëve të tjera. Pra, është çështje e përfunduar nga gjykatat me vendim të formës së prerë.

Kjo është trajtuar më sipër në seksionin e ankesave të paraqitura pranë Prokurorisë së Përgjithshme (pika 2/c).

22. Denoncim i shtetasit S.H., i cili ka të bëjë me pretendimin për mosnjoftim të kallëzimit të bërë ndaj televizionit “****”. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurori i çështjes, por çështja është ndjekur nga prokurori E.B.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

23. Denoncim i shtetasit S.T., i cili ka të bëjë me pretendimin për falsifikime lidhur me problematika disa vjeçare dhe shumë çështje civile dhe penale për 27 gjyqtarë dhe prokurorë. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në rolin e ndjekjes, hetimit dhe as vendimmarrëse e çështjeve të përmendura nga denoncuesi.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

24. Denoncim i shtetasit V.Ç. – nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurori dhe vendimmarrëse e çështjeve të përmendura nga denoncuesi, por ka firmosur korrespondenca me cilësinë e Drejtueses së Prokurorisë.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

25. Denoncim i shtetasit T.Gj., i cili ka të bëjë me pretendimin për arrestim të padrejtë. Nga praktika e dorëzuar nga denoncuesi dhe provat e administruara nga KLP-ja, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurori që ka ndjekur procesin penal ndaj denoncuesit as për masën e sigurimit as për gjykimin e çështjes për gjykim.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

26. Denoncim i shtetasit Rr.Sh., i cili, ndër të tjera, lidhur me aspektin profesional, ka të bëjë me pretendimin për 2 çështje në proces pranë Prokurorisë Tiranë. Çështja e mbikalimit të sheshi “****” dhe çështja e familjes T****.

Për këtë është kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kjo Prokurori në datën 5.11.2020 ka kthyer përgjigje. Pas vlerësimit të përgjigjes nuk rezultoi se këto 2 çështje të jenë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Çështjet penale të sipërpërmendura janë caktuar me short prokurorëve S.S. dhe S.M.

Nuk rezultuan problematika lidhur me këtë denoncim për subjektin e rivlerësimit.

Nga analiza e bërë për denoncimet e mësipërme, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

GJETJE TË TJERA

1. Vëzhguesi ndërkombëtar, në datën 6.8.2020, ka dërguar në Komision Gjetje³² bazuar në 2 çështje profesionale (çështja Xh.M. dhe B.Pl.).

a) Çështja që përfshin shtetasin Xh. M. (Xh.M.)

Pas analizimit të dosjeve të kësaj çështjeje, u konstatua se Prokuroria e Krimeve të Rënda (PKR) ka filluar një hetim kundër shtetasit Xh.M. në bazë të nenit 283/2 të Kodit Penal, “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, pas deklarimit të moskompetencës nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në korrik të vitit 2010.

Subjekti i rivlerësimit E.I. e ka regjistruar fillimisht çështjen penale nr. *** bazuar në informacionin e SHISH-it të muajit shkurt 2010 mbi persona të përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike. PKR-ja ka regjistruar gjithashtu procedimin penal nr. *** të lidhur me një tjetër tentativë për trafikim të lëndëve narkotike, i cili ka ndodhur më 29-30 mars 2010. Emrat e personave të përfshirë në aktivitet të paligjshëm gjendeshin në të dhënat e PKR-së, për shkak të përgjimeve ose raportimit nga policia/SHISH të aktivitetit të paligjshëm.

Subjekti i rivlerësimit ka vendosur në qershor të vitit 2011 të dërgojë shtetasit A.M. (prodhim sipas ngjarjes së qershorit), I.T. dhe D.S. (të dy për prodhim dhe trafikim në lidhje me ngjarjet e marsit dhe qershorit të vitit 2010), për gjykim, por duke zgjedhur një strategji tjetër procedurale për shtetasin Xh.M., i cili po hetohet veçmas vetëm për prodhim të lëndëve narkotike (si A.M.³³) dhe pavarësisht informacionit të përfshirjes së shtetasit XH.M., gjithashtu në ngjarjen e marsit të vitit 2010 ose edhe më përpara.

Gjetje mbi mënyrën e trajtimit të hetimit:

- i. Është provuar se hetimi dhe shtyrjet janë të pambështetura dhe absolutisht të pajustificuara. Pavarësisht sa më sipër, më 29.12.2011, subjekti i rivlerësimit vendosi të shtyjë hetimin, të ndajë çështjen e shtetasit Xh.M. nga procedimi kryesor nr. ***, si të shpallë moskompetencë dhe ta transferojë çështjen në Prokurorinë e Gjirokastrës, duke arsyetuar se gjykimi ndaj shtetasve A.M., I.T. dhe D.S. në lidhje me ngjarjet e qershorit të vitit 2010 (si dhe me atë të marsit të vitit 2010 për shtetasit I.T. dhe D.S.) ka avancuar dhe ka arritur në atë fazë që e bën proceduralisht të pamundur që subjekti i rivlerësimit t’i drejtohet gjykatës me një kërkesë për gjykim për shtetasin Xh.M. gjithashtu. Dhe për sa kohë që shtetasi Xh.M. është i akuzuar vetëm për prodhim, sipas subjektit të rivlerësimit, vepra është jashtë kompetencës së KPR-së, prandaj e ka transferuar çështjen në Prokurorinë e Gjirokastrës.
- ii. Është provuar se qasja e subjektit të rivlerësimit ndaj shtetasit Xh.M. është e pajustificuar, krahasuar me të paktën një prej të hetuarve të tjerë dhe personave të akuzuar - A.M. Duhet të theksohet gjithashtu se pas transferimit të çështjes së shtetasit Xh.M., nga PKR-ja te PRRGJ-ja, pozita e personit të hetuar ishte qartësisht më e favorshme. Në vitin 2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë e shpalli shtetasin Xh.M. të pafajshëm.

b) Procedimi penal kundër shtetasit B.P.

Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 16.11.2013, për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

³²Shihni Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar dërguar pranë Komisionit më 6.8.2020.

³³Procedimi nr. ***, siç është regjistruar nga Prokuroria për Krimet e Rënda për ngjarjet e marsit 2010. Subjekti i rivlerësimit ka bashkuar dhe ndarë vazhdimisht këto procedime nën procedimin nr. ***.

Shtetasit e akuzuar u shpallën fajtorë dhe u dënuan me vendimin nr. ***, datë 18.5.2016, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Për shtetasin B.P. dhe të tjerët (G.J.C. dhe P.R.), gjithashtu të arrestuar në kuadër të ngjarjes për çështjen më sipër, hetimet vazhdonin. Shtetasit B.P. etj., janë arrestuar më 29.9.2014, rrugës për në Shkodër, kur udhëtonin në një kamion kargo. Në kamionin kargo, policia gjeti një gomë rezervë që kishte 4 rrotulla të pahapura natriban (lëndët narkotike të gjetura ishin mbështjellë me këtë material), dy pako të përdorura natriban, 5 palë doreza, 3 pako qese plastike dhe 3 palë doreza të tjera u gjetën në derën e automjetit.

Pas ricaktimit të çështjes në Prokurorinë për Krime të Rënda, çështja iu caktua prokurorëve Elizabeta Imeraj dhe D.P.

Më 12.5.2017, prokurorët Elizabeta Imeraj dhe D.P. nxorën një urdhër për regjistrimin e emrave të shtetasve B.P., G.J.C., dhe P.R., në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në kuadër të procedimit nr. ***, të vitit 2013, si persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale “trafikim i lëndëve narkotike” të nenit 283/a/2 të Kodit Penal, në bashkëpunim (neni 22).

Më 25.5.2017, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Elizabeta Imeraj, ka paraqitur pranë gjykatës një kërkesë për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” kundër shtetasit B.P., e cila ishte pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. ***, datë 27.5.2017.

Më 18.6.2017, me kërkesë të Prokurorisë (prokurorët Elizabeta Imeraj dhe D.P. që përfaqësonin prokurorinë), masa e sigurimit për shtetasin B.P. ndryshon në “detyrim paraqitje” (vendimi i gjykatës nr. ***, datë 18.6.2017, me kërkesë të Prokurorisë).

Ndërsa më 24.7.2017, Prokuroria (prokurorët Elizabeta Imeraj dhe D.P.) merr vendimin t'i njoftojnë akuzën shtetasit B.P. Akuzat e komunikuar nuk janë për veprën penale “trafikim i lëndëve narkotike”, por për veprën e parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal “moskallëzim krimi”. Për shkak se vepra e moskallëzimit të krimit nuk është në kompetencën e Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda, prokurorët (Elizabeta Imeraj dhe D.P.) dolën me vendimin datë 28.7.2017 dhe shpallën moskompetencën mbi çështjen. Po të njëjtën gjë bënë për dy të pandehurit e tjerë të arrestuar së bashku me shtetasin B.P.

Gjetje: mbi vendimin e prokurorëve Elizabeta Imeraj dhe D.P. për të shpallur moskompetencën në çështjen e shtetasit B.P.

- i. Mbetet e pashpjegueshme se çfarë hetimesh të mëtejshme (të ndryshme nga sa dihej nga fillimi) janë kryer dhe cilat prova janë gjetur nga subjekti i rivlerësimit dhe prokurorët e tjerë që ka çuar në vendimin për shpalljen e moskompetencës në çështjen e shtetasit B.P.
- ii. Mbetet e pashpjegueshme se përse Prokuroria (prokurorët Elizabeta Imeraj dhe D.P., të cilët kanë marrë vendimin e moskompetencës) thekson mungesën e provave daktiloskopike në lëndën narkotike të konfiskuar, kur rolet në krimin e organizuar janë të ndryshme dhe jo çdokush nevojshmërisht është në rolin e atij që kryen krimin dhe prandaj shenjat e gishtave e jo të gjithë anëtarëve mund të gjenden në lëndën narkotike të konfiskuar, kur mungojnë hetimet dhe argumentet e forta mbi rolet e tjera të mundshme. Për më tepër, fakti se dorezat u gjetën në kamionin me të cilin po udhëtonte B.P. mund të shpjegojnë mungesën e shenjave të gishtave.
- iii. Mbetet e pashpjegueshme se cilat ishin hapat hetimorë proaktivë nga subjekti i rivlerësimit, krahas gjetjeve të deklaruara dhe përgjimeve, për të përcaktuar se nuk kishte asnjë marrëveshje ndërmjet shtetasit B.P. dhe të tjerëve për të kryer veprën penale, por ai thjesht kishte dijeni për të dhe nuk e kallëzoi.

- iv. Mbetet e pashpjegueshme se përse subjekti i rivlerësimit dhe prokurori tjetër theksojnë vetëm faktin se në kamionin në të cilin po udhëtonte shtetasit B.P. etj. nuk janë gjetur lëndë narkotike ndërsa nuk japin argumente se çfarë është gjetur në kamion dhe shpjegime se përse për Prokurorinë kjo nuk qëndronte. Specifikisht, përse të pandehurit duhej të kishin 4 rrotulla të pahapura natriban (i njëjti material që përdoret për të mbështjellë lëndën narkotike të gjetur dhe konfiskuar), dy rrotulla natriban të përdorura, 8 palë doreza dhe 3 rrotulla me qese plastike.
- v. Mbetet e pashpjegueshme se përse subjekti i rivlerësimit dhe prokurori tjetër nuk analizojnë se përse personat e dënuar do t'i raportonin një miku se si po e shtronin rrugën me 20 kamionë rërë që do t'i lejonte transportin e lëndëve narkotike nga automjeti te motobarka.
- vi. Së fundmi, duke parë provat ekzistuese (nga viti 2014) mbi përfshirjen potenciale të z. B.P. në tentativë të veprës penale “trafikim i lëndëve narkotike” në bashkëpunim, çështja është mbyllur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda (prokurorët Elizabeta Imeraj dhe D.P.) për moskompetencë dhe është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër:
 - pa hetim gjithëpërfshirës dhe të plotë që mund të kishte çuar në mbledhjen e më shumë provave mbi përcaktimin e fajësisë së mundshme për një veprë penale dhe përcaktimin e rolit të z. B.P. në aktivitetin e trafikimit të lëndëve narkotike; dhe
 - me argumente të paqarta dhe kundërshtuese mbi provat ekzistuese.

Për Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit për këtë çështje, deklaroi:

“Për çështjen ndaj shtetasit Xh.M.

*Pas analizimit të dosjeve të kësaj çështjeje u konstatua se Prokuroria e Krimeve të Rënda ka filluar një hetim në kuadër të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2010. Ky procedim penal është hetuar duke përdorur hetimin proaktiv, me anë të kryerjes së veprimeve të përgjimit telefonik dhe ambiental, sipas parashikimeve të nenit 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.*

Nga ky hetim i zhvilluar është marrë vendim dhe është operuar me:

- miratimin e një plani hetimor;
- zbatimin e planit hetimor;
- konkludimin me vendimmarrje.

*Nga hetimi i procedimit penal me nr. ***, të vitit 2010, rezulton se është autorizuar përgjimi për subjekte të ndryshme, përgjime nga të cilat janë arritur të arrestohen një numër i madh personash dhe të dërgohen për gjykim.*

*Në rang të prezantimit të një fakti real se si ka ndodhur ngjarja dhe cili ka qenë hetimi i zhvilluar ju bëj me dije se një grup personash janë vënë në përgjim duke përdorur këtë metodë hetimi, si persona që në fshatin *** të Gjirokastrës kultivonin dhe më pas shisnin bimë narkotike të llojit Cannabis Sativa. Për shkak të shtrirjes shumë të madhe që pati në atë periudhë kohore, ky fenomen në zonën e *** është operuar me vënien e numrave të shumtë telefonikë në përgjim. Nga përgjimet dhe rezultatet e tjera të hetimit ka rezultuar se persona të ndryshëm janë furnizuar me lëndë narkotike te persona të tjerë në ***, ku një ndër të dyshuarit ishte dhe Xh.M.*

*Nga ana jonë, si Prokurori e Krimeve të Rënda qëllimi ka qenë hetimi i disa subjekteve, të cilët merrnin lëndën narkotike në *** dhe e dërgonin atë jashtë shtetit dhe, për këtë qëllim, janë prodhuar disa hetime të tjera si procedimi penal me nr. ***, me të hetuar T.B., i cili është dërguar për gjykim për kryerjen e veprës penale ‘trafikim i narkotikëve’, kryer në*

*bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenst 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal. Si rasti i këtij të hetuari ka pasur disa procedime të tjera të dala nga hetimi i zhvilluar për çështjen penale me nr. ***, të vitit 2010. Kjo metodikë hetimi është përdorur në mënyrë që të goditeshin në përgjegjësi penale personat për të cilët kishim informacione, që kryenin veprimtarinë e trafikimit të lëndëve narkotike dhe që furnizoheshin në ***.*

Ndërsa i hetuari Xh.M., përfaqëson të hetuarin, i cili kultivonte dhe më pas ua shiste lëndën narkotike të hetuarve të tjerë që e trafikonin atë. Që në fillim të procedimit, në ngarkim të shtetasit Xh.M., ky shtetas është hetuar për veprën penale sipas nenit 283/2 të Kodit Penal dhe jo sipas neneve 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal. Edhe masa e sigurimit personal 'arrest në burg' i është caktuar këtij shtetasi sipas nenit 283/2 të Kodit Penal. Në këtë mënyrë, qëndrimi i Prokurorisë për Krime të Rënda ka qenë i qëndrueshëm në raport me kualifikimin që i është bërë veprës penale të kryer nga Xh.M.

Cilado qoftë arsyeja, e vërteta qëndron se vëzhguesi ndërkombëtar ka krijuar perceptim të gabuar në lidhje me hetimin e kësaj çështjeje.

*Siç dhe referohet nga vëzhguesi ndërkombëtar, fillimisht, është regjistruar çështja penale nr. ***, bazuar në informacionin e SHISH-it, të muajit shkurt 2010, mbi persona të përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike. PKR-ja ka regjistruar gjithashtu procedimin penal nr. ***, të lidhur me një tjetër tentativë për trafikim të lëndëve narkotike, i cili ka ndodhur më 29-30 mars 2010. Emrat e personave të përfshirë në aktivitet të paligjshëm gjendeshin në të dhënat e PKR-së, për shkak të përgjimeve ose raportimit nga policia/SHISH të aktivitetit të paligjshëm.*

Ndërsa në qershor të vitit 2010, pati një tentativë tjetër për transportimin e lëndëve narkotike, e cila dështoi si pasojë e ndërhyrjes së policisë, për të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër regjistroi veprën penale dhe, kjo e fundit deklaroi moskompetencën duke e dërguar çështjen pranë PKR-së. PRK-ja vazhdoi hetimet mbi këtë çështje, e cila përfshinte drejtpërsëdrejti shtetasit XH.M. (në cilësinë e shitësit të lëndës narkotike), A.M. dhe I.T. (si bashkëpunëtorë në transportin e drogës) dhe D.S.

*Edhe procedimi penal për të cilin i referohet vëzhguesi ndërkombëtar është përfutur në bazë të hetimit të zhvilluar në kuadër të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2010, në Prokurorinë për Krimet e Rënda. Në një mënyrë më të saktë dhe më të drejtpërdrejtë, vetë procedimi në ngarkim të T.B. etj., ka dalë nga përgjimet dhe veprimet e tjera hetimore të kryera në kuadër të procedimit me nr. ***, të vitit 2010, por për shkak mosdekonspirimit e hetimit, i cili ishte në vijim me përgjime, rasti është trajtuar si një episod i shkëputur.*

*Sidoqoftë, në hetimin e procedimit penal me nr. ***, të vitit 2010 dhe, për pasojë, në hetimin e zhvilluar në ngarkim të Xh.M., Prokuroria për Krime të Rënda ka bashkëpunuar në mënyrë të plotë dhe në çdo etapë të procesit me Shërbimin Informativ dhe strukturat e Policisë së Shtetit. Çdo vendimmarrje në raport me këtë çështje në hetim, kur bëhet fjalë për çështje i referohem procedimit me nr. ***, të vitit 2010, është bërë mbi bazën e një plani hetimor për të cilin është rënë dakord nga disa institucione bashkërisht.*

- Gjetja mbi mënyrën e trajtimit të hetimit, duke i konsideruar zgjatjet e afatit të pajustificuara, si dhe interpretimi mbi vendimmarrjen për kalim kompetence nuk qëndron si më poshtë:

Në një mënyrë paradoksale, vëzhguesi ndërkombëtar arrin në konkluzionin e gabuar se zgjatja e hetimeve ka qenë e pajustificuar. Një konkluzion i tillë shkon përtej kompetencës që i ka dhënë

ligji, jo vetëm vëzhguesit ndërkombëtar në rolin e tij, por vjen në kundërshtim me disa parashikime ligjore që lidhen me funksionet e prokurorit, hetimin e çështjes dhe vendimmarrjen.

Funksionet dhe kompetencat e prokurorit trajtohen dhe parashikohen si të tilla në normat e Kodit të Procedurës Penale.

Sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale parashikohej 'funksionet e prokurorit' (shtuar pika 5 me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999 dhe me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002), nga të cilat rezulton se: 'Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë kod. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal në rastet e parashikuara në këtë kod.'

Nga ana tjetër, në kohën në të cilin është kryer ky hetim, Prokuroria karakterizohej nga të qenurit një organ i centralizuar dhe kjo gjen përcaktim në parashikimet e nenit 24, pika 5, e Kodit të Procedurës Penale, i cili thekson se 'Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.'

Në rastin e hetuar nuk rezulton të jetë bërë një gjë e tillë, pasi vendimmarrja është konsideruar shumë e drejtë dhe ka ardhur si rezultat i një analize të bërë, jo vetëm nga prokurori i çështjes.

Neni 304 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se si kryhet veprimtaria hetimore e prokurorit. Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit dhe ballafaqimet, në të cilat merr pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Në këtë rast, policia gjyqësore respekton dispozitat për caktimin dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit në veprimet hetimore.

Për veprime të veçanta që duhen kryer në një rreth tjetër, kur nuk mendon të procedojë personalisht, mund të delegojë, sipas kompetencës lëndore përkatëse, prokurorin e atij rrethi. Kur ka arsye të ngutshme ose shkaqe të rëndësishme, prokurori i deleguar ka të drejtë të kryejë me iniciativën e tij çdo veprim të domosdoshëm për qëllimet e hetimit.'

Edhe në rastin në fjalë hetimi është zhvilluar sipas parashikimeve procedurale.

*Në asnjë akt të dosjes në ngarkim të të hetuarit Xh.M., por edhe në analizë të hetimit në tërësi të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2010, nuk ka asnjë arsye ligjore dhe faktike mbi të cilat të konkludohet se zgjatjet e afatit për të hetuarin Xh.M. janë bërë në mënyrë të pajustificuar.*

Justifikimi i këtyre zgjatjeve gjen më së miri arsyetim te fakti që bëhej fjalë për një hetim më të madh në vijim, hetim nga i cili është arritur të vihen para përgjegjesisë penale disa të hetuar, të cilët janë dënuar si të përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike. Ndaj dhe konkluzioni për zgjatje të pajustificuara është një perceptim jo i drejtë, i gabuar dhe i pambështetur në fakte dhe prova.

Për sa i përket vendimmarrjes sime si prokuror i çështjes, në lidhje me shpalljen e moskompetencës lëndore, në lidhje me procedimin me të hetuar Xh.M., vendimi i marrë nga ana ime si prokuror është i drejtë dhe në përputhje me parashikimet procedurale ligjore. I hetuari Xh.M. është hetuar që në fillim të procedimit penal, regjistruar në ngarkim të tij, për veprën penale sipas nenit 283/2 të Kodit Penal. Organi i Prokurorisë ka mbajtur

qëndrim të njëjtë për këtë të hetuar, qoftë sa i përket kualifikimit të veprës për të cilën dyshohej, qoftë edhe për mbajtjen e tij në masë sigurimi personal 'arrest në burg' sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale.

Vepra penale sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale nuk hynte në kompetencën lëndore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. I hetuari Xh.M. është hetuar në të njëjtën çështje për shkaqe se kishte rëndësi për të hetuarit e tjerë që dyshoheshin për veprën penale të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim për interpretimin e ligjit në rastin e subjektit të rivlerësimit F.V. me vendimin nr. ***, datë 23.10.2020, për sa i përket vendimmarrjes së magjistratit.

Në këtë vendimmarrje arsyetohet se: 'Kolegji konstaton se të gjitha vlerësimet e Komisionit lidhen dhe i adresohen zgjidhjes në themel të çështjes penale, duke tentuar të kryejë një arsyetim dhe analizë të ndryshme të fakteve dhe rrethanave të çështjes nga ajo që ka kryer vetë Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Në këto konkluzione të Komisionit, Kolegji verën se gjendemi para një tejkalimi të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit dhe verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit.

Kolegji çmon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore.

Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4, e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: 'Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet', dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1, e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër ligjor të zbatueshëm, Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin dhe çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit.'

Edhe në rastin konkret, pikërisht, vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar dhe vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit.

Ndaj dhe konkluzioni i përcjellë në formë Gjetjeje nga vëzhguesi ndërkombëtar, me anë të së cilës i ka hyrë analizës mbi bazueshmërinë ose jo të vendimmarrjes për zgjatje të afatit të hetimeve dhe vendimmarrjes për kalimin e kompetencës, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

Në vijim të këtij arsytimi, vendimmarrja për kalimin e kompetencës nuk paraqet asnjë defekt në mënyrën se si ai është arsyetuar dhe argumentuar, por shoqërohet nga një vijë logjike dhe interpretative e arsyeshme mbi provat, përdorimin dhe aplikimin e harmonizuar të legjislacionit të brendshëm dhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke plotësuar në këtë mënyrë rekuizitat e nenit 72, pika 2, e ligjit nr. 96/2016, për sa u përket elementeve që vlerësojnë njohuritë ligjore dhe arsytimin ligjor.

Nuk ka asnjë qasje të ndryshme, as në rang objektiv dhe as subjektiv, për të hetuarin Xh.M. në raport me të hetuarit e tjerë.

Për aq kohë sa unë si prokuror i çështjes kam konkluduar me vendimmarrje të tilla si:

- *Urdhër për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal.*
- *Kërkesë për caktim mase sigurimi personal 'arrest në burg', në gjykatë për këtë të hetuar.*
- *Mbajtjen e qëndrimit për 'arrest në burg' për këtë të hetuar edhe në rastin e zbatimit të masës së sigurimit sipas nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale.*
- *Mbajtjen e qëndrimit për 'arrest në burg' për këtë shtetas edhe në seancën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të paraqitur nga ky shtetas.*
- *Zbatim rigoroz i procedurës penale sipas nenit 75/a për gjykatën kompetente që do merrej me shqyrtimin e çështjes.*
- *Analizë e plotë e dosjes në hetim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese të përfshira në hetimin e këtij rasti.*
- *Nga ana e Prokurorisë pritëse nuk është bërë konflikt kompetence.*
- *Si dhe duke marrë në konsideratë faktin se institucionet ligjzbatuese operojnë mbi baza informacionesh që jepen nga persona të infiltëruar në një veprimtari kriminale, si burime të besueshme, por të pashënuara në dokumente.*

Çdolloj analize tjetër dhe interpretim është i gabuar dhe i pabazuar në prova dhe akte.

Për sa më sipër, në analizë të akteve, provave të administruara, si dhe legjislacionit në fuqi, kolaudojmë se:

- *Vëzhguesi ndërkombëtar ka konkluduar në perceptime të gabuara, të pabazuara në prova dhe akt.*
- *Perceptimet e gabuara nuk janë në përputhje me parashikimet e ligjit me nr. 84/2016, për sa i përket rolit të vëzhguesit, por dhe detyrës së organeve të Vetting-ut për kryerjen e vlerësimit.*

Në rastin e hetuar janë respektuar të gjitha normat ligjore në fuqi, në respektim të plotë të zhvillimit të një hetimi rigoroz, objektiv dhe në respektim të parimeve kushtetuese dhe ligjore.

Qasja si prokuror në këtë çështje është mëse e qartë dhe evidente, është bërë një hetim i plotë, është caktuar masë sigurimi për të hetuarin 'arrest në burg', sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale është operuar me rrëzim kërkesë për zëvendësim mase sigurimi, prandaj çdolloj perceptimi tjetër është në kundërshtim të plotë me sa analizuam më sipër.

Për çështjen ndaj shtetasit B.P.

Edhe në këtë rast, fillimisht, kam konstatuar mungesën thelbësore të akteve shkresore mbi të cilat rezulton si e mbështetur kjo Gjetje. Për efekt të analizës ligjore në lidhje me konkluzionet e nxjerra nga vëzhguesi ndërkombëtar në lidhje me këtë çështje të hetuar nga ana ime, ndalojmë në tre momente kryesore:

Së pari: ana formale ku mbështetet mendimi dhe gjetja.

Së dyti: mjetet e kërkimit të provës dhe provat e administruara që mbështesin mendimin dhe Gjetjen.

Së treti: arsyetimi në rang ligjor i përdorur për të konkluduar në këtë Gjetje.

Për sa i përket pikës së parë, konstatoj që në aktet që më keni vënë në dispozicion nuk ka asnjë shkresë apo kërkesë të bërë nga KPK-ja, mbi bazën e të cilës aktet e procedimit penal në ngarkim të shtetasit B.P. të jenë administruar nga ana juaj me cilësinë e provës. Kjo

qëndron e lidhur ngushtë me pikën e dytë duke qenë se nuk janë respektuar normat ligjore sipas nenit 49 të ligjit me nr.84/2016.

Për sa i përket arsyetimit ligjor të përdorur nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar, analizojmë se vëzhguesi ndërkombëtar, në analizën e tij, ka bërë çmuarje të provave duke i dhënë vetes një atribut që jo vetëm nuk ia jep ligji me nr. 84/2016, por duke hyrë në një atribut të cilin në bazë të normave ekzistuese i përket vetëm magjistratit në detyrë. Forma e kontrollit të çmuarjes së provave të mbledhura gjatë një hetimi shkon nëpërmjet qëndrimit që mbahet nga Gjykata në vendimmarrje. Vëzhguesi ndërkombëtar i jep vetes attribute që neni 304 i Kodit të Procedurës Penale ekskluzivisht ia ka dhënë vetëm prokurorit të çështjes, duke qenë se parashikohet se: 'Veprimtaria hetimore drejtohet nga prokurori, i cili delegon detyrat dhe kryen vetë çdo detyrë që e çmon të arsyeshme'.

Në këtë këndvështrim, në legjislacionin shqiptar procesin që lidhet me çmuarjen ia atribuon magjistratit, ku në rastin konkret ia atribuon prokurorit të çështjes. Nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar referohet për 'mbyllje' të çështjes nga Prokuroria për Krime të Rënda, ndërkohë që nuk ekziston as si koncept dhe as si vendimmarrje mbyllja e çështjes të paktën jo proceduralisht. E parë në këtë këndvështrim, ose vëzhguesi ndërkombëtar nuk ka marrë të gjitha aktet e përkthyer në gjuhën që ai e kupton, ose konkluzioni i nxjerrë prej tij është një perceptim i gabuar i rrethanave faktike në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi.

Procedimi penal në ngarkim të shtetasit B.P. ka kaluar për moskompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme dhe ka konkluduar me një akuzë, e cila nuk ishte në kompetencën e saj.

Në lidhje me konstatimet e bëra nga vëzhguesi ndërkombëtar, vlerësoj se së pari nga analiza që u bëhet dispozitive ligjore në fuqi në kohën e hetimit të kësaj çështjeje, Kodi i Procedurës Penale nuk ka pasur asnjë parashikim ligjor i cili të ndalonte prokurorin për vendimmarrje në bazë të provave dhe bindjes së brendshme të krijuar.

Në këto kushte, duke pasur parasysh sa më sipër, rezulton mëse e qartë që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me anë të prokurorëve Elizabeta Imeraj dhe D.P. ka synuar goditjen e veprimtarisë kriminale të të hetuarit B.P., duke dispozuar me caktim masë sigurimi personal 'arrest në burg', sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vendimmarrje nuk ishte bërë më parë nga prokurori tjetër që ka ndjekur çështjen që në fillim të hetimit, prokurori B.D., ku për ironi të dy këta prokurorë e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, konform parashikimeve të ligjit me nr. 84/2016. Duke analizuar situatën në të gjitha llojet e drejtimeve në aspektin hetimor, në lidhje të ngushtë kjo me procesin e rivlerësimit, konstatoj se për shkak të disa rrethanave të faktit situata ligjore e prezantuar nga vëzhguesi ndërkombëtar nuk rezulton të ketë ndodhur.

Rrethanat që e kundërshtojnë totalisht këtë arsyetim lidhen me:

- Vetëm me caktimin si prokurorë të D.P. dhe Elizabeta Imeraj, i hetuari B.P. u arrit të vihet në hetim dhe ndaj tij të caktohet mase sigurimi personal,

- Nga ana jonë si prokurorë u morën të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e një akuze në drejtim të trafikimit, sipas nenit 283/a/2, si të kryer nga B.P., po largësia në kohë e veprimeve hetimore për shkak se prokurori që kishte hetuar më parë çështjen nuk kishte vepruar, si dhe fakti që asnjë nga të dënuarit nuk pranoi të jepte deklarime të tjetra, përpos atyre që ishin dhënë, nuk u arrit baza e plotë e të dhënave të mjaftueshme për ngritjen e një akuze.

Pasi shqyrtojmë në analizë të gjitha rrethanat e faktit, konkludojmë me bindje të plotë se konstatimet në formë Gjetjeje të vëzhguesit ndërkombëtar jo vetëm nuk qëndrojnë por bien në kundërshtim me ligjin, për aq kohë sa këto Gjetje i referohen vendimmarrjes mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes së marrë në shqyrtim. Nga natyra e çështjes dhe arsyetimi i përdorur, perceptohet qartë se evidentimi i problematikës që ngrihet si e konstatuar lidhet me gjykimin dhe vlerësimin nëse bindja e brendshme e krijuar prej meje si prokuror dhe prokurorit D.P., mbi analizën e provave të marra gjatë procesit e në kuptim e zbatim të ligjit material, është e drejtë ose jo.

Kjo situatë, mbetet shumë e debatueshme për konkluzion në çfarëdolloj rrethane, aq më tepër kur bëhet fjalë mbi një çështje tejet të debatueshme e profesionale siç është analiza mbi ekzistencën e lidhjes shkakësore në kryerjen e një vepre penale, se nuk ekziston lidhja shkakësore midis veprimeve të të hetuarit dhe pasojës së ardhur.

*Sa me sipër, por përsëri në referim të vendimit me nr. ***, datë 23.10.2020, për subjektin e rivlerësimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrim duke nënvizuar se 'Komisioni tejkalon kompetencën e tij kushtetuese e ligjore duke vlerësuar vendimmarrjen dhe zgjidhjen në themel të një çështjeje, atribut vetëm i një gjykate më të lartë'.*

Në këtë arsyetim, vlen të silltet në vëmendje se edhe sistemi i vlerësimit periodik të magjistratëve, i parashikuar prej ligjit nr. 96/2016, nuk parashikon matjen e aftësive për gjykim apo arsyetimin ligjor të magjistratëve në varësi të qëndrimit që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet e tyre.

Kjo lidhet ngushtë edhe me qëndrimet e mbajtura në rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Lartë në Shqipëri, parimet e gjithëpranuara të Bangalores mbi sjelljen e gjyqësorit, të cilat janë të qarta dhe eksplicite në këto raste, për mospërdorimin e një vendimi të një gjykate më të lartë për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët.

Edhe në rastin në fjalë, çmuarja në mënyrë të ndryshme që iu bën provave vëzhguesi ndërkombëtar në lidhje me çështjen në ngarkim të B.P., nuk mundet të ndikojë dhe për më tepër të ketë lidhje me procesin e rivlerësimit të magjistratit.

Sipas nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Në nenin 6 të Kushtetutës parashikohet se 'Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe'.

Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

Parimet e mësipërme kushtetuese nuk mundet të shkelen për asnjë arsye dhe, për pasojë, asnjë lloj organi nuk mundet të çmojë ndryshe një tagër apo atribut që ligji ia ka caktuar një organi tjetër.

Edhe në parimet e Bangalores citohet si një ndër parimet bazë, parimi i pavarësisë. Në raport me Gjetjen e datës 6.8.2020, bërë nga vëzhguesi ndërkombëtar për çështje të hetuara nga ana ime si prokuror, konkludoj se nuk qëndrojnë për arsye se Gjetja i referohet vendimmarrjes sime si prokuror dhe, si e tillë, vëzhguesi ndërkombëtar është në tejkallim të kompetencave që i jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji me nr. 84, viti 2016, qëndrim ky i njehsuar tashmë me vendimin e KPA-së me nr. 28, datë 23.10.2020.

Po theksoj në këtë analizë dhe faktin se të dy prokurorët që kanë hetuar të njëjtën çështje si B.D. ashtu edhe D.P. kanë kaluar procesin e rivlerësimit me formë të prerë, duke qenë aktualisht prokurorë që ushtrojnë detyrën në Prokurorinë e Posaçme”.

Në lidhje me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi Gjetjen e paraqitur si më sipër nga vëzhguesi ndërkombëtar, janë depozituar dhe administruar aktet shkresore si vijojnë:

- urdhërregjistrim procedimi penal për çështjen në lidhje me shtetasin XH. (nga i cili rezulton se për të njëjtën vepër për të cilën është regjistruar procedimi për të njëjtën vepër është konkluduar për shpallje moskompetence, çfarë dëshmon trajtimin ligjor të qëndrueshëm në raport me këtë shtetas);
- vendim caktim mase sigurimi në ngarkim të shtetasit Xh.M. (nga ku rezulton se dhe masa e sigurimit “arrest në burg” i është caktuar sipas nenit 283/2, nen për të cilin është shpallur dhe moskompetenca);
- procesverbal për ekzekutimin e masës së sigurimit nga e cila provohet se ekzekutimi i masës në ngarkim të këtij shtetasi është bërë në bazë të urdhrit të prokurorit të nxjerrë në kohën e duhur;
- vendim shpallje moskompetence për shtetasin B.P., i cili tregon çmuarjen që u është bërë provave nga prokurorët e çështjes;
- urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 12.8.2012, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- vendim i Komisionit për konfirmimin në detyrë të prokurorit që ka ndjekur çështjen B.D.;
- vendim i Komisionit për konfirmimin në detyrë të prokurorit tjetër të çështjes D.P..

Konkluzion i Komisionit

Komisioni, lidhur me 2 çështjet e mësipërme në arritjen e konkluzioneve për vlerësimet profesionale për subjektin e rivlerësimit, i referohet praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrim për interpretimin e ligjit lidhur me vlerësimin profesional për çështje të shqyrtuara nga subjektet e rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si magjistratë.

Vendimmarrja dhe qëndrimi i Kolegjit ka të bëjë më rastin e subjektit të rivlerësimit F.V. (vendimi nr. 28, datë 23.10.2020).

Në këtë vendimmarrje të Kolegjit arsyetohet se: *“Kolegji konstaton se të gjitha vlerësimet e Komisionit lidhen dhe i adresohen zgjidhjes në themel të çështjes penale, duke tentuar të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve dhe rrethanave të çështjes nga ajo që ka kryer vetë Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Në këto konkluzione të Komisionit, Kolegji verën se gjendemi para një tejkalimi të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit dhe verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit.*

Kolegji çmon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore.

Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4, e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: ‘Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqararit që vlerësohet’, dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1, e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër ligjor të zbatueshëm, Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të

jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit”.

Në rastet konkrete më sipër, Komisioni mban qëndrimin se vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit nuk mund të bëhet duke gjykuar e vlerësuar logjikën, interpretimin apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes. Për më tepër që këto vendime të subjektit nuk janë kundështuar nga prokuroritë e rretheve Gjyrokastër dhe Shkodër të cilave u janë përcjellë për kompetencë.

Siç shihet është një vendimarrje që prek disa magjistratë në qëndrimet e tyre për efekt të arsytimit ligjor dhe veprimeve procedurale. Sjellja në mënyrë të njëjtë, në raport me vendimarrjen dhe që lidhet me faktin se prokuroritë e rretheve nuk kanë ushtruar të drejtën e konfliktit të kompetencës dhe as nga gjykatat nuk kanë ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e veprës penale, për rrjedhojë nuk mund të ngarkohet subjekti me përgjegjësi.

Sa më sipër Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve nga ana e subjektit në cilësinë e magjistratit.

2. Vëzhguesi ndërkombëtar, më 30.9.2020, ka dërguar Gjetje³⁴ bazuar në “Deklaratën e fjalës së nderit, dërguar nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar gjyqtari H.K. nga Holanda më 5.9.2020, si dhe në denoncimin e marrë nga IMO më 24.8.2020, dërguar nga shtetasi R.Sh.”.

Sipas “Deklaratës së fjalës së nderit” të gjyqtarit H.K. të datës 5.9.2020, ish-vëzhguesi ndërkombëtar deklaroi se:

1) *Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përjashtimin e tij si vëzhgues ndërkombëtar nga ndjekja e procesit të rivlerësimit të çështjes së saj.*

2) *Subjekti i rivlerësimit e ka kontaktuar atë drejtpërdrejt me e-mail në mënyrë që t'i shpjegonte situatën e saj personale.*

3) *Ai ka marrë nëpërmjet burimeve të besueshme shqiptare informacion se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të plotë të vendndodhjes së tij dhe udhëtimeve të tij jashtë shtetit dhe dispononte një material video të tij dhe të të ‘dashurës së tij’.*

4) *Ishte i informuar nga një burim joshqiptar i besueshëm se ai ishte përndjekur nga subjekti i rivlerësimit, e cila e kishte fotografuar dhe filmuar atë.*

Komunikimi i drejtpërdrejtë me një vëzhgues ndërkombëtar, i cili ka një rol specifik në procesin e rivlerësimit, me qëllimin e vetëm të ushtrimit të ndikimit ndaj tij me qëllim favorizimin e pozitës si subjekt rivlerësimi, jashtë qëllimit të procedurave të rregullta siç përcaktohen në kuadrin ligjor është plotësisht e papranueshme dhe joprofesionale.

Asnjë dispozitë ligjore nuk i pengon subjektet e rivlerësimit t'i paraqesin vëzhguesve ndërkombëtarë prova për të garantuar shqyrtimin e plotë në procesin e rivlerësimit, por në këtë rast, përmbajta e e-mailit, dërguar nga subjekti i rivlerësimit më 4.11.2019, nuk mund të lexohet ndryshe përveçse një përpjekje e qartë për të ushtruar ndikim ndaj vëzhguesit ndërkombëtar me qëllim trajtimin preferencial ndaj saj, ndryshe nga ai që pritet në bazë të dosjes së saj të rivlerësimit. Kjo nuk mund të perceptohet ndryshe përveçse një ndërhyrje e drejtpërdrejtë ndaj pavarësisë dhe paanshmërisë së vëzhguesve ndërkombëtarë dhe tregon një model “ujdie” në një mënyrë informale dhe jashtë qëllimit të procedurës së rregullt ligjore, e cila është e papranueshme. Koha e e-mailit të dërguar gjyqtarit H.K. nga subjekti i rivlerësimit më 4.11.2019, menjëherë pas mbërritjes së tij me fluturimin e mëngjesit nga

³⁴Shihni Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar dërguar pranë Komisionit më 30.10.2020.

Amsterdami, mund të perceptohet si synim i saj për të treguar dijeninë e vendndodhjes së vëzhguesit ndërkombëtar. Ky fakt mbështetet nga denoncimi i dërguar nga shtetasi Rr.Sh., referuar më lart: *“Thuhet se Elizabeta Imeraj ka financuar në mënyrë sekrete dhe të paligjshme survejimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, duke abuzuar me të dhënat e të afërmeve të tyre, nëpërmjet përdorimit të fakteve të nxjerra nga konteksti dhe kuptimi i tyre (...)”*.

Këto lloj “veprimesh” në lidhje me zyrtarët e përfshirë në procesin e rivlerësimit kanë, pa dyshim, një efekt intimidues të një mase që pengojnë rrjedhën normale të rivlerësimit. Këto fakte mund të tregojnë një model sjelljeje që është absolutisht joetik, veçanërisht duke mbajtur parasysh se subjekti i rivlerësimit thekson në mënyrë konstante të drejtën e saj të privatësisë. Është e qartë se këto praktika, me qëllim pengimin e hetimit të Komisionit duke bërë presion mbi anëtarët e institucionit të përfshirë në procesin e rivlerësimit dhe që potencialisht dëmtojnë reputacionin e tyre, janë të papranueshme në një shtet demokratik dhe qartësisht nuk kontribuojnë në kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë shqiptare.

Në lidhje me Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit³⁵ për këtë çështje deklaroi: *“Pasi u njoha me Gjetjen e datës 30.9.2020, të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me qëllim analizimin e situatës së prezantuar në këtë perceptim të vëzhguesit ndërkombëtar të quajtur ‘Gjetje’, po ndaloj në analizimin e situatës së prezantuar, duke e trajtuar si më poshtë:*

Së pari: një pretendim i tillë i paraqitur është sa i pavërtetë, aq edhe i çuditshëm. Ndihej e fyer, e keqardhur dhe madje e intimiduar, duke u gjendur përballë një pretendimi të tillë të prezantuar si Gjetje.

Nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar është pretenduar se: sipas ‘deklaratës së fjalës së nderit’ të gjyqtarit H.K. të datës 5 shtator 2020, ish-vëzhguesi ndërkombëtar deklaroi se: (1) subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përjashtimin e tij si vëzhgues ndërkombëtar nga ndjekja e procesit të rivlerësimit të çështjes së saj; (2) subjekti i rivlerësimit e ka kontaktuar atë drejtpërdrejt me e-mail në mënyrë që t’i shpjegonte situatën e saj personale; (3) ai ka marrë nëpërmjet burimeve të besueshme shqiptare informacion se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të plotë të vendndodhjes së tij dhe udhëtimeve të tij jashtë shtetit dhe dispononte një material video të tij dhe të ‘dashurës së tij’; (4) se ai ishte informuar nga një burim joshqiptar i besueshëm se ai ishte përndjekur nga subjekti i rivlerësimit, e cila e kishte fotografuar dhe filmuar atë.

Sipas pretendimeve të vëzhguesit ndërkombëtar këto përbëjnë:

- 1. sjellje joprofesionale;*
- 2. sjellje joetike/ushtrim i ndikimit të paligjshëm në procesin e rivlerësimit.*

Në parantezë të arsytimit ligjor dhe logjik të mungesës totale të vërtetësisë të këtij pretendimi absurd të prezantuar si Gjetje, po ndaloj fillimisht në detajimin e situatës, që konsiston në mekanizmin procedural të përdorur nga ana e Komisionit apo dhe nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë për: hetimin; evidentimin; mbledhjen e informacionit, për një situatë të tillë, procedurë kjo që duhet të jetë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, pasi në bazë të kësaj procedure ka ardhur si pasojë konkludimi i vëzhguesit ndërkombëtar me këtë Gjetje.

Në referencë të ligjit nr. 84/2016, që në nenin 1 të tij përcaktohet si qëllim i këtij ligji ‘vënia e rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe

³⁵ Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës’.

E parë në këtë frymë të ligjit, ka një tërësi rregullash të posaçme mbi bazën e të cilave kryhet procedura e rivlerësimit të çdo subjekti në rivlerësim, procedurë kjo e cila në bazë të nenit 18 të Kushtetutës që reflekton barazinë para ligjit si parim, nuk mundet të jetë e ndryshme nga çdo lloj procedure e ndjekur për çdo subjekt rivlerësimi dhe s’ka pse të jetë e ndryshme as për mua, si subjekt rivlerësimi. Në nenin 2 të këtij ligji, parashikohen të standardizuara: 1. parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët; 2. metodologjia, procedurat dhe standardet e rivlerësimit.

Normalisht, parimet e sanksionuara janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha palët në një proces, qoftë ky edhe procesi i rivlerësimit. Është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme të dalë në pah mekanizmi hetimor që është përdorur në Gjetjen e datës 30.9.2020, për të vërtetuar fakte dhe rrethana, të cilat jo vetëm më adresohen mua personalisht, pa pasur bazën minimale të të dhënave informative apo të provave, por edhe avancohet çuditshëm në interpretimin si shkelje etike dhe shkelje profesionale. Në çdo procedurë, qoftë kjo edhe procedura e rivlerësimit në rang të ligjit nr. 84/2016, fakte dhe rrethana që i adresohen një subjekti në formë akuze, duhet dhe të argumentohet sa më poshtë:

- fakti dhe rrethanat të kenë rezultuar nga një veprim hetimor;
- ky veprim hetimor ka nxjerrë në pah këto prova;
- ka një lidhje shkakësore mes veprimit dhe pasojës.

Dhe e gjithë kjo interpretohet në raport me bazueshmërinë apo jo në ligj të veprimit apo mosveprimit të kryer.

Është mëse normale që nga ana ime të shtrohet si pyetje:

- Çfarë është hetuar në raport me këto pretendime?
- Cilat janë veprimet konkrete të kryera prej meje, në çfarë kohe dhe për çfarë arsye?
- Cilat janë provat e mbledhura nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar për të konkluduar në këtë Gjetje?

Në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohen rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes. Ky nen parashikon se anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

A mundet të më bëhen me dije si është kryer hetimi i fakteve dhe rrethanave të prezantuara në këtë Gjetje të datës 30.9.2020? Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në referencë të këtij parashikimi ligjor a mundet të më tregoni se çfarë informacionesh ka kërkuar vëzhguesi ndërkombëtar tek subjektet e së drejtës publike, për të konkluduar me paraqitjen e këtyre fakteve dhe rrethanave?

Parashikimet sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, konkretizojnë se:

- Duhet administruar dokumente që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit.

A mundet të më thoni se çfarë dokumentesh janë administruar nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar apo nga ana e Komisionit për të vërtetuar një veprim i cili çuditërisht më adresohet mua si subjekt? Në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016 parashikohen mjetet për

kërkimin e provës. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë:

- a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2 e këtij ligji;
- b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku;
- c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj ose dokumenteve të marra nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
- d) të këqyrë dhe të kontrollojë sende të luajshme ose të paluajshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

A mundet të më tregohet se për rastin e fakteve dhe rrethanave të prezantuara në këtë Gjetje:

1. Çfarë dokumentesh ligjore janë mbledhur në rang të hetimit?
2. Çfarë deklaratash keni marrë nga persona të ndryshëm dhe kush janë ata?
3. Çfarë dokumentesh shkresore keni mbledhur si prova?
4. Çfarë këqyrjesh keni realizuar?

Është e parashikuar konkretisht në ligj se: 'Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera'.

Në rastin konkret nuk ekziston:

- asnjë dokument nga burime të njohura;
- asnjë provë konkrete,
- dhe asnjë indicie për rastin e paraqitur si Gjetje.

Ka vetëm një e-mail të z. K., i cili thotë, më kanë thënë dy persona, që s'ua them dot kush janë...

Sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: Gjetja e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë.

Në këtë mënyrë siç dhe ligji e kërkon, duhet të plotësohen disa kushte kumulative që të ndodhemi përballë Gjetjes në kuptim ligjor, kushte të cilat renditen si më poshtë:

Së pari: analiza e anës formale të Gjetjes;

Së dyti: përmbajtja e saj.

Në rangun e analizës formale Gjetja prezantohet në formën e një deklaratë, raporti apo dokumenti dhe dëshmon një fakt ose standard ligjor që ka ndodhur ose ekziston. Në këtë mënyrë, brenda kuadrantit formal të prezantimit të Gjetjes, duhet domosdoshmërisht që të jepen të dhënat informative, provuese, të cilat janë të një niveli të tillë që mund të dëshmojnë. Ndërsa në aspektin e përmbajtjes gjëja e parë që duhet zgjidhur është përcaktimi dhe vërtetimi që fakti ekziston ose ka ndodhur. Në rastin konkret nuk ka asnjë provë, dokument apo çfarëdolloj indicieje e cila të konkludojë që fakti ka ndodhur ose minimalisht të konkludojë që fakti ka ndodhur dhe ka lidhje me mua si subjekt rivlerësimi. E kam të pamundur të besoj që një vëzhgues ndërkombëtar të jetë përndjekur apo të jetë fotografuar, dhe për çfarë arsye, dhe në mënyrë kategorike që një rrethanë e tillë nuk mundet të më adresohet mua.

Ndërsa paraqitja e kërkesave formale, të nënshkruara në formë të rregullt, apo dhe e-maili si komunikim me adresë zyrtare, janë veprime korrekte dhe që s'kanë asnjë ndalesë ligjore, siç dhe pranohen vetë nga vëzhguesi ndërkombëtar.

Për sa i përket pretendimeve të ngritura, analizoj sa më poshtë:

Në lidhje me pikën e parë, që lidhet me kërkesën për përjashtim:

- *Kërkesa e bërë nga ana ime është paraqitur në mënyrë të rregullt konform parashikimeve ligjore në fuqi, në respektim të etikës, si në aspektin formal, ashtu dhe në përmbajtje. Për të paraqitur një kërkesë të tillë kanë ndikuar rrethanat e situatës së krijuar, ku nga njëra anë ngrihej një pretendim për shprehje mendimi paraprak nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar, dhe nga ana tjetër ekzistonte dyshimi i arsyeshëm e konkluduar në rezultat dhe pasojë se ish-relatorja e procesit tim të rivlerësimit ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit. E parë në këtë këndvështrim, nga ana ime është parë e nevojshme që të operoj me kërkesë formale në mënyrë që vëzhguesi ndërkombëtar, brenda rolit të tij në proces, të kishte mundësinë e të vëzhguarit të këtij procesi edhe në drejtim të të drejtave të subjektit, pasi në mënyrë të qartë, siç dhe rezultoi më vonë, ish-relatorja ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.*

Këto pretendime nga ana ime janë ngritur në formë të shkruar në përputhje të plotë me:

- *Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut;*
- *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;*
- *Ligjin nr. 84/2016;*
- *Kodin e Procedurave Administrative.*

Siç edhe pranohet nga ana juaj, asnjë dispozitë ligjore nuk i pengon subjektet e rivlerësimit t'i paraqesin vëzhguesve ndërkombëtarë prova për të garantuar shqyrtimin e plotë në procesin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, asnjë dispozitë ligjore nuk i pengon subjektet e rivlerësimit të bëjnë kërkesat që i çmojnë të domosdoshme në procesin e tyre, për aq kohë sa këto kërkesa janë në rregull, për sa i përket anës formale dhe nuk përmbajnë asnjë lloj elementi i cili mundet të cenojë figurën, dinjitetin apo punën në raport me përmbajtjen. Ndaj dhe kërkesat e bëra nga ana ime janë në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, sipas parashikimeve të nenit 6 të KEDNj-së.

Kërkesat e bëra nga ime nuk mundet dhe s'kanë asnjë arsye të lexohen në mënyrë të ndryshme, përveçse siç janë prezantuar prej meje, duke u paraqitur edhe formalisht. Çdo lloj interpretimi tjetër, i cili është në kundërshtim të plotë jo vetëm me frymën e ligjit por dhe me praktikën për çfarëdolloj procesi, nuk është gjë tjetër veçse shprehje e një perceptimi të gabuar të ligjit dhe në rastin më të keq shprehje e diçkaje më të rëndë. Dëshiroj të theksoj se në çdo proces penal apo civil elementët që lidhen me 'shfaqjen e mendimit për çështjen në gjykim' përbëjnë shkaqe përjashtimore. Një parashikim i tillë gjen vend si shkak përjashtimor në të drejtën tonë të brendshme, qoftë në Kodin e Procedurës Civile, ashtu edhe në Kodin e Procedurës Penale.

Për sa më sipër, kërkesat e paraqitura nga ana ime janë bërë në mënyrë të rregullt formalisht dhe janë perceptuar si të drejta në përmbajtje, duke marrë në analizë të gjitha rrethanat faktike.

Për të argumentuar qëndrimet e mësipërme shërbejnë dhe ju vë në dispozicion aktet e mëposhtme:

- *letër nga T.Gj., ku nga ana e tij pretendohet se vëzhguesi ndërkombëtar në proces është H.K. dhe ky ishte përbetuar për shkarkimin tim;*
- *kërkesë për përjashtim e paraqitur nga ana ime për ish-relatoren e çështjes;*
- *vendim i KPK-së për përjashtimin e ish-relatores, znj. B.*

Në këto kushte, në kohën e paraqitjes së letrës nga T.Gj., unë si subjekt nuk kisha asnjë lloj dijenie në lidhje me faktin se kush ishte personi që luante rolin e vëzhguesit ndërkombëtar. Dhe

për çudinë time, persona që në prokurori kishin cilësinë e të hetuarit dhe të të pandehurit ishin në dijeni totale të procesit tim të rivlerësimit. Kjo situatë më ka bërë të perceptoj pretendimet e ngritura në kërkesën konkrete, në përputhje me ligjin. Asnjë interpretim tjetër nuk ka parashtrimi i kësaj kërkesë, dhe për më tepër nuk ka pse të vendoset në kalata të ndryshme nga e vërteta.

Në lidhje me pikën e dytë, që i referohet dërgimit të një e-maili nga ana ime, në datën 4.11.2019, arsyetoj sa më poshtë: e-maili i dërguar nga ana ime në datën 4.11.2019 nuk përfaqëson asnjë gjë tjetër veçse një shprehje të drejtpërdrejtë komunikimi me personin që në bazë të Kushtetutës dhe ligjit ka rolin e vëzhguesit ndërkombëtar. Në perceptimin ligjor dhe në perceptimin tim personal 'vëzhgues', nënkupton mbikëqyrjen për efekt të pavarësisë dhe paanësisë së procesit të rivlerësimit. E ndjerë në kushtet e inimitimit nga prania në procesin tim të rivlerësimit të ish-relatores në konflikt të hapur të interesit, e kam çmuar të arsyeshme t'i drejtohem me postë elektronike ish-vëzhguesit ndërkombëtar.

Fakti që dërgimi i e-mailit nuk ka pasur asnjë lloj nënkuptimi, lidhet ngushtë edhe me faktin se ky e-mail është dërguar nga ana ime, nga posta elektronike dhe adresa e e-mailit zyrtar, çfarë domethënë që as nuk ka pasur tendencë fshehje apo asnjë lloj tendence tjetër. Ndihej e keqardhur nëse një veprim i tillë pa asnjë lloj nënkuptimi dhe mbikuptimi, me përjashtim të realitetit faktik është keqkuptuar nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar dhe po kaq ndihem e çuditur që ky keqkuptim i ka lindur ish-vëzhguesit ndërkombëtar disa muaj më vonë, edhe pasi është larguar nga Shqipëria. Fakti që ish-vëzhguesi ndërkombëtar nuk është shtetas shqiptar më bën të hyj në analizën e botëkuptimit të ndryshëm që mundet të na karakterizojë për shkak të normave të ndryshme të sjelljes në shoqëri apo edhe për shkaqe të tjera. Por kurrësi të mos mendohet se botëkuptimi i ndryshëm që mundet të kemi, botëkuptim ky që ndikon dhe perceptimin apo në qasjen e secilit prej nesh, të interpretohet si një shkelje pa baza ligjore.

Së pari, duke pasur funksionin e prokurorit më ka rastisur për vite me radhë të bashkëpunoj me partnerë ndërkombëtarë të vendeve të ndryshme, qofshin ata të Bashkimit Evropian apo dhe ata të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Së dyti, kam pasur rastin të jem pjesë e trajnimeve të shumta brenda dhe jashtë vendit, duke pasur kontakte dhe bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Së treti, kam pasur rastin të kryej hetime të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë. Në asnjë moment nuk e kam kuptuar dhe as nuk më është përcjellë si mangësi, shkelje, apo mungesë etike, e aq me pak profesionale 'komunikimi i drejtpërdrejtë'.

Sidoqoftë, për t'i qëndruar strikt normave që lidhen me etikën dhe sjelljen si prokuror i Republikës së Shqipërisë, në asnjë normë kushtetuese, në asnjë normë ligjore, dhe në asnjë normë procedurale, dhe në veçanti në ligjin nr. 84/2016, nuk është parashikuar si shkelje e drejta për të komunikuar.

Në asnjë moment, e-maili i dërguar nga ana ime në përmbajtjen e tij nuk ka pasur tendencë ndikimin për trajtim preferencial. Dhe për aq kohë sa ky komunikim nuk është i ndaluar në ligj, atëherë do kërkoja që ky veprim të interpretohej normalisht, natyrshëm, ashtu siç dhe realisht ka ndodhur, duke u bazuar në normat e sjelljes së shoqërisë shqiptare. Nga ana tjetër, unë vetë personalisht kam pritur dhe mirëpritur vëzhgues ndërkombëtarë në zyrë, ku kanë ardhur për të biseduar, për të marrë informacion dhe kanë dashur vetë të jenë të pranishëm në prokurori.

Në asnjë rast, asnjë kërkesë e bërë nga ana e tyre, pra, nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë, në formë të shkruar me shkresë formale apo me e-mail, edhe pse lidhej me punën në prokurori, apo dhe me çështje që mundet të ishin në hetim, nuk janë interpretuar nga ana ime si intimidim, si ushtrim ndikimi apo si sjellje joprofesionale. Rregullat dhe ligjet janë të njëjta për të gjithë dhe

zbatohen njësoj për të gjithë, ndaj dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk ka se si të jetë më diskriminuese për një shqiptar, që në rastin konkret jam unë.

Në lidhje me pikën e tretë, sipas së cilës ish-vëzhguesi ndërkombëtar, nëpërmjet burimeve të besueshme shqiptare, ka marrë informacion se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të plotë të vendndodhjes së tij dhe udhëtimeve të tij jashtë shtetit dhe dispononte një material video të tij dhe të 'dashurës së tij', arsyetoj sa më poshtë:

Ndihem e shokuar nga ky perceptim i gabuar, i krijuar nga një vëzhgues ndërkombëtar.

Një perceptim i tillë s'mundet të jetë asgjë më shumë sesa një prezantim i një situatë që jo vetëm s'ka ndodhur ndonjëherë, por s'ka asnjë lloj arsye ligjore, njerëzore dhe morale të ndodhë.

Edhe pse ndihem jokomode që më duhet të marr përsipër të vërtetë të vërtetën, gjë e cila nuk është bërë as nga ana e Komisionit dhe as nga vëzhguesi ndërkombëtar, me qëllim që dhe ju të jeni të qartë, por dhe ish-vëzhguesi ndërkombëtar të qartësohet, u jam drejtuar me kërkesë disa institucioneve, duke kërkuar çdo lloj të dhëne, informacioni, ankese apo kërkesë të bërë për personin tim dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni nga çdo lloj burimi.

Arsyeja e këtyre kërtimeve lidhet me faktin që jo vetëm ju, jo vetëm vëzhguesit ndërkombëtarë, dhe jo vetëm unë, por mbarë opinioni publik të mësojë se kjo e pavërtetë nuk mund të njollosë jo vetëm procesin tim të rivlerësimit, jo vetëm figurën time si prokuror, por as dinjitetin tim si njeri, si nënë, si femër.

Ju bëj me dije në fjalën time të nderit se asnjë lloj situatë e tillë, e prezantuar si gjetje nuk është e vërtetë.

Nuk kam asnjë lloj dijenie për asnjë lloj situatë të jetesës personale, të ish-vëzhguesit ndërkombëtar H.K. dhe as kam pasur ndonjëherë dijeni për një gjë të tillë. Ndihem e keqardhur për perceptimin jo të drejtë të krijuar nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar H.K., duke qenë se populli shqiptar, duke përfshirë edhe mua, mbahemi për tradita mikpritëse.

Në rreshtat e mëposhtëm do ndaloj në mënyrë të detajuar në një analizë më specifike në lidhje me këtë situatë, ndërsa në këtë pikë do trajtoj mungesën totale të bazueshmërisë në prova të një pretendimi të tillë. Sipas ligjit nr. 84/2016, dhe konkretisht neni 25 i këtij ligji, parashikon se: 'Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, personat e lidhur me ta, personeli i institucioneve të rivlerësimit, si dhe personeli mbështetës i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e veçantë'.

1. Me qëllim vërtetimit të një fakti të drejtë dhe ekzistues që lidhet me pavërtetësinë totale të Gjetjes së datës 30.9.2020, i jam drejtuar me kërkesë institucionit të Gardës së Republikës, nga ku kam kërkuar informacion në lidhje me sa më poshtë:

- Nga viti 2018 e deri më sot, a ka ndodhur të keni pasur informacione të shkruara ose jo në lidhje me ndonjë problematikë që lidhet me Elizabeta Imeraj, problematikë kjo e përcjellë nga përfaqësues të huaj me cilësinë e vëzhguesve ndërkombëtarë?
- Po nga burime të tjera a ka ndodhur të keni pasur ndonjë problematikë të përcjellë për Elizabeta Imeraj?
- A ka ndodhur të keni dërguar referim për veprime të mëtejshme në rast se ka pasur informacione të tilla.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën e datës 3.2.2021, jam informuar si më poshtë:

'... ju bëjmë me dije se nuk kemi pasur asnjë problematikë të përcjellë për shtetasen Elizabeta Imeraj nga viti 2018 e deri aktualisht. Nuk ka pasur asnjë lloj informacioni nga asnjë burim, për aq sa kërkohet nga ana juaj...'

Për sa më sipër, ish-vëzhguesi ndërkombëtar H.K. ka pasur mundësinë të përcjellë në çdo moment çdo shqetësim të tijin në lidhje me pretendimet e paraqitura në datën 5.9.2020. Shteti shqiptar funksionon mbi bazat e parimeve të së drejtës dhe mirëfunksionimit institucional.

Sipas normave ligjore në fuqi, për çdo situatë që ndodh dhe që vjen në kundërshtim me ligjin (siç është ajo e prezantuar dhe e pretenduar si gjetje nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar), çdo person konform nenit 280 të Kodit të Procedurës Penale ka të drejtën e depozitimit të kallëzimit penal në institucionet përkatëse, gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin konkret.

2. Për të vijuar me prova të tjera që lidhen me mosekzistencën e një fakti të tillë në raport me mua, i jam drejtuar me kërkesë:

- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;*
- Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë;*
- Komisarariatit të Policisë Nr. 1;*
- Komisarariatit të Policisë Nr. 2;*
- Komisarariatit të Policisë Nr. 3;*
- Komisarariatit të Policisë Nr. 4;*
- Komisarariatit të Policisë Nr. 5;*
- Komisarariatit të Policisë Nr. 6;*
- Komisarariatit të Policisë Rinas.*

Nga kthim përgjigjet e marra pas verifikimeve të dokumentacionit që disponohen prej tyre, në çdo lloj regjistri, regjistri i kërkesë-ankesave, regjistri i informacionit të klasifikuar si sekret dhe regjistri i korrespondencës, rezulton se:

- Nuk ka asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi i përcjellë nga ndonjë shtetas i huaj apo vëzhgues ndërkombëtar për Elizabeta Imeraj.*
- Nuk ka asnjë kërkesë/ankesë/kallëzim/informacion apo referim të bërë për Elizabeta Imeraj nga ndonjë shtetas i huaj apo shqiptar.*

Në analizë të përgjigjeve të kthyera rezulton e plotë dhe e qartë se situata e prezantuar është një perceptim i gabuar.

Ndaj kërkoj nga ana juaj reflektim në bazë të provave dhe jo mbi bazën e fjalëve që s'kanë prova, por dhe në thelb në përmbajtjen e tyre janë kaq të kota sa nuk qëndrojnë.

Në lidhje me pikën e katërt, ku prezantohet pretendimi së vëzhguesi ndërkombëtar ishte informuar nga një burim joshqiptar i besueshëm se ai ishte përndjekur nga subjekti i rivlerësimit, e cila e kishte fotografuar dhe filmuar atë, duhet të arsyetoj sa më poshtë:

Një situatë e tillë s'ka ndodhur kurrë, s'e kam idenë se kush është H.K., nuk do e njihja edhe po ta shija në rrugë dhe s'më ka vajtur kurrë në mendje një gjë e tillë. Përsëri më duhet të ritheksoj se ndihem e keqardhur nëse realisht ish-vëzhguesi ndërkombëtar ka krijuar një perceptim të tillë shumë larg botës reale. Unë jam prokurorë, ushtroj detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku për shkak të ngarkesës shumë të madhe të kësaj prokurorie më duhet të konsumoj shumë kohë në zyrë dhe orë të tëra punë për të përballuar ngarkesën. Unë jam nënë e dy fëmijëve të mitur, për të cilët më duhet të kujdesem, të bëj detyrat me ta, të shëtis me ta, t'i çoj nëpër kurse të ndryshme dhe çdo minutë e lirë e kohës time ju dedikohet atyre. Nuk kam asnjë hapësirë kohore për të parë, për të ndjekur, e aq më

pak për të fotografuar një vëzhgues ndërkombëtar as me të dashurën, as me kolegen, as me askënd! Unë mundohem që të mos shkëputem nga teoria e të nxënit në aspektin juridik dhe i jam angazhuar për shumë vite me radhë mësime dhe ndaj ku mundem brenda hapësirës kohore, pa cenuar përditshmërinë, kam dhënë mësim në Fakultetin e Drejtësisë. Nga ana tjetër, duhet të keni parasysh se edhe pse jam prokurore, në një proces Vetting-u, një proces që e rritet për shkak se ish-relatorja ishte në konflikt interesi, unë përfaqësoj një individ si çdo person tjetër, me ngarkesa familjare, me sëmundje familjarësh, etj.

Ndaj është mëse e vërtetë kur them se kam jetesën time të nderuar dhe nuk merrem me jetesën e askujt. Mua personalisht s'më intereson jetesa personale e askujt, dhe aq më tepër e një vëzhguesi ndërkombëtar, për të cilin ju them në fjalën time të nderit që s'kam asnjë lloj dijenie për të. Bazuar në sa më sipër, në lidhje me konkluzionet e nxjerra nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe dërguar Komisionit në datën 30.9.2020, analizoj sa më poshtë: Pretendimi për sjellje joprofesionale nuk qëndron, pasi është krijuar mbi bazën e perceptimeve të gabuara dhe pa prova. Qoftë dërgimi i një kërkesë zyrtare, qoftë dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me e-mail, janë veprime që nuk ndalohen në ligj dhe, si të tilla, lejohen. Jam treguar etike si në formë, ashtu dhe në përmbajtje, dhe për aktet e nënshkruara nga ime me firmën e Elizabeta Imeraj mbaj përgjegjësinë totale për veprimet e kryera.

Komunikimi i drejtpërdrejtë me një vëzhgues ndërkombëtar, i cili ka një rol specifik në procesin e rivlerësimit, nuk ka asnjë lloj qëllimi, vetëm perceptimin personal të një subjekti, i cili çmon se procesi i tij i rivlerësimit ka nevojë për mbikëqyrje si rezultat i një situatë reale të një konflikti interesi, siç ishte rasti im në nëntor të vitit 2019, e pasuar dhe më vonë me një konflikt tjetër interesi të dëshmuar po prapë me një vendim të Komisionit, siç është rasti i dhjetorit të vitit 2020. Siç edhe vetë pranohet nga vëzhguesi ndërkombëtar: 'Asnjë dispozitë ligjore nuk i pengon subjektet e rivlerësimit t'i paraqesin vëzhguesve ndërkombëtarë prova për të garantuar shqyrtimin e plotë në procesin e rivlerësimit'. Sa më sipër, nuk konsiderohet sjellje joprofesionale një sjellje që nuk vjen në kundërshtim me ligjin në asnjë procedurë e çfarëdolloji qoftë ajo, penale, civile dhe as administrative.

Kam të gjithë të drejtën të mendoj se është joprofesionale qëndrimi i mbajtur nga një ish-vëzhgues ndërkombëtar, i cili tregon, pasi është larguar, nga vendi ynë dhe nuk ushtron detyrën më këtu, duke prezantuar situatë që nuk ekzistojnë dhe në asnjë moment kohor të qenies së tij në Shqipëri nuk i janë bërë me dije askujt. Sidoqoftë, përsëri duke i rithirrur aspektit normal të bashkëpunimit mes njerëzve, aspektit normal të komunikimit, kam dëshirë të besoj se ish-vëzhguesi ndërkombëtar ka krijuar thjesht një perceptim të gabuar, edhe pse s'ka pasur asnjë arsye të krijojë një perceptim të tillë, arsye të cilat mundet të burojnë nga veprimet e mia.

Pretendimi për sjellje joetike/ushtrimi i ndikimit të paligjshëm në procesin e rivlerësimit, nuk qëndron.

Për këtë fakt vëzhguesi ndërkombëtar i referohet një denoncimi të bërë nga një person me emrin Rr.Sh.

Nuk shoh asnjë veprim të kryer, për të:

- Identifikuar apo marrë në pyetje shtetasin me emrin Rr.Sh.,
- Ashtu siç nuk shoh asnjë veprim të vëzhguesit ndërkombëtar apo të Komisionit të kryer për të verifikuar përmbajtjen e denoncimit të bërë nga Rr.Sh.

Në çdo formë hetimi për të vlerësuar besueshmërinë e deklarimeve apo përmbajtjes së një denoncimi, duhet të bazohemi në disa elemente që po i rendisim si më poshtë:

- identifikimin e denoncuesit/dëshmitarit/deklaruesit;

- krijimin e një baze vlerësimi për besueshmërinë e denoncuesit/dëshmitarit apo deklaruesit si individ;
- vërtetimin e përmbajtjes së të dhënave të marra nga denoncuesi/dëshmitari apo deklaruesi.

Në rastin konkret nuk është ndërmarrë asnjë lloj veprimi për t'u kryer si mjet kërkimi prove, i cili shërben për mbledhjen dhe administrimin e provave.

Në lidhje me pikën e parë, edhe pse nuk është bërë nga as nga Komisioni dhe as nga vëzhguesi ndërkombëtar, nga ime janë bërë kërkimet për të evidentuar të gjitha detajet që lidhen me denoncimin e shtetasit Rr.Sh..

Së pari, kam kryer veprimet e nevojshme për të evidentuar identifikimin e plotë të denoncuesit, nga ku rezulton se në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë 3 (tre) persona me emrin Rr.Sh. dhe konkretisht:

- Rr.Sh., i datëlindjes 20.8.1945, lindur në ***, Dibër dhe banues në ***, Dibër;
- Rr.Sh., i datëlindjes 15.5.1973, lindur në Dibër dhe banues në ***, Dibër.
- Rr.Sh., i datëlindjes 5.1.1994, lindur në Dibër dhe banues në ***, Tiranë.

Asnjë nga këta persona nuk ka depozituar një denoncim të tillë tek ONM-ja, çfarë nënkupton që emri i vënë është një emër i vënë kot dhe denoncimi ka buruar nga persona të tjerë të cilët nuk janë nisur nga tregimi i fakteve reale, por janë nisur nga dashakeqësia dhe armiqësia karshi personit tim.

Megjithatë, le të lëmë mënjanë anën emocionale dhe ta trajtojmë juridikisht përmbajtjen e denoncimit të sjelle tek ONM-ja ja nga i ashtuquajturit Rr.Sh.

Sipas akteve që më keni vënë në dispozicion në denoncimin e bërë nga një burim anonim, që ka dashur t'i vërë vetes emrin Rr.Sh., ngrihen këto pretendime:

- Ka dijeni për Prokurorinë e Tiranës se e ka zënë halli për çështje pronash. Për të vërtetuar një pretendim të tillë i jam drejtuar me kërkesë Zyrës së Regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës, duke kërkuar informacion nëse ka kallëzim apo të kallëzuar apo procedim në këtë prokurori për ndonjë shtetas me emrin Rr.Sh. Nga përgjigjja e kthyer rezulton se nuk ka asnjë kallëzim, të kallëzuar apo procedim në këtë prokurori për ndonjë shtetas me emrin Rr.Sh.
- Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht, pretendon se unë nuk jam divorcuar. Një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi ka një vendim gjykate dhe një procedurë të ndjekur ligjore që dokumentojnë zgjidhjen e martesës.
- Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht pretendon për një çështje me kallëzues F.P. Me kërkesë drejtuar Zyrës së Regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës, është kthyer përgjigjja se prokurori Elizabeta Imeraj nuk ka ndjekur kurrë hetime në raport me ndonjë çështje me kallëzues F.P.
- Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht pretendon për shkelje të kryera nga ana ime në lidhje me shortin që zhvillohet në prokurori. Një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi konform urdhrat që po ju vendos në dispozicion, shorti hidhet në mënyrë elektronike. Ndërsa për shortin manual janë të ngarkuar drejtuesit e seksioneve. Përsëri me kërkesë i jam drejtuar zyrës së sekretarisë, duke kërkuar informacion nëse ka ndonjë ankesë, kërkesë apo memo të depozituar nga palët në proces, individë, avokatë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore që kanë pretendime në lidhje me shortin. Nga kthim përgjigjja e datës 23.2.2021 rezulton se nuk ka asnjë të dhënë të tillë, ndaj dhe ky pretendim nuk qëndron.
- Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht pretendon diçka në raport me '***'.

*Edhe ky pretendim i tillë nuk qëndron, pasi sipas kthim përgjigjes në të dhënat e regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës, çështja që lidhet me subjektin ‘***’ është hetuar nga prokurori A.L., ndërkohë që nga ana e prokurorisë për këtë shtetas është kërkuar ‘arrest në burg’. Sa më sipër, jo një, por asnjë rresht i pretendimeve të individit që ka dashur t’i vërë vetes emrin Rr.Sh. nuk qëndron, nuk është i vërtetë dhe nuk bazohet në asnjë provë konkrete.*

Nga kërkimet e bëra në Zyrën e Regjistrimit në Prokurori rezulton se një individ me emrin Rr.Sh. ka depozituar me postë një copë letër, ku ngre disa pretendime në lidhje me një sërë shkeljesh. Me kërkesë të datës 21.2.2021 kam marrë kopje të plotë të dosjes përkatëse, nga e cila rezulton se prokurorja e ngarkuar me hetimin, S.M., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në këtë denoncim, po me emrin Rr.Sh., rezulton të jenë akuzuar një sërë individësh dhe institucionesh. Në raport me pretendimet karshi personit tim kam bërë vetë kërkimet, të cilat po ua vë në dispozicion me dokumente zyrtare. Por edhe për këto pretendime apo dhe pretendime për shkelje të kryera nga institucione të tjera, ku përmenden dhe vëzhgues ndërkombëtarë dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm etj., është vendosur mosfillimi i çështjes penale.

Nisur nga sa më sipër, bazueshmëria e çfarëdolloj pretendimi në denoncimin e të ashtuquajturit Rr.Sh., jo vetëm që nuk bazohet në ligj, por dhe nuk lejohet nga ligji. Në mënyrë krejt të çuditshme në këtë gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar lidh në formë artificiale gjëra që nuk qëndrojnë me njëra-tjetrën.

Kështu, ai arsyeton:

‘Koha e e-mailit të dërguar gjyqtarit H.K. nga subjekti i rivlerësimit më 4 nëntor 2019, menjëherë pas mbërritjes së tij me fluturimin e mëngjesit nga Amsterdami mund të perceptohet si synim i saj për të treguar dijeninë e vendndodhjes së vëzhguesit ndërkombëtar. Ky fakt mbështetet nga denoncimi i dërguar nga shtetasi Rr.Sh., referuar më lart (...) Thuhet se Elizabeta Imeraj ka financuar në mënyrë sekrete dhe të paligjshme survejimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, duke abuzuar me të dhënat e të afërmeve të tyre, nëpërmjet përdorimit të fakteve të nxjerra nga konteksti dhe kuptimi i tyre (...) Pra, me pak fjalë, mbështet arsyetimin e tij në denoncimin e Rr.Sh., Rr. të sajuar, Rr. që s’pasqyron asgjë të vërtetë në denoncimin e tij, Rr. që ngre pretendime dhe për vetë vëzhguesin ndërkombëtar.

Në nenin neni 40 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet: ‘Objekti i vlerësimit të aftësisë profesionale’ përcakton se objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve’.

Në vijim të arsyetimit bëj me dije si Komisionin dhe të nderuarin vëzhgues se themeli i çdo procesi gjyqësor dhe administrativ është rregullsia ligjore e tij. Kuptimi i një procesi të rregullt është një nocion tejet i gjerë dhe përfshin të gjitha dimensionet që cenojnë në thelb apo tentojnë të cenojnë një procedurë gjyqësore apo administrative.

Veprimtaria në kushtet e konfliktit të interesit përbën ndoshta një nga rastet më përfaqësuese kur cenohet rëndë procesi i rregullt ligjor dhe përbën kështu shkak thelbësor jo vetëm për ta bërë ‘nul’ një procedurë, por nga ana tjetër i privon shtetasit të drejtën natyrore për t’u dëgjuar nga një ‘gjykatë’ e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj.

Parimi i mësipërm, i mishëruar në nenin 6 të KEDNj-së, përbën edhe normë të brendshme ligjore, duke u sanksionuar në ligjin tonë më lart, në Kushtetutë, në nenin 42/2 të saj.

Ka qenë pikërisht kjo normë ligjore e cila ka motivuar kërkesat e mia publike të përcjella zyrtarisht nga e-maili zyrtar në vëmendje të ONM-së dhe KPK-së.

Sikurse kam shpjeguar gjerësisht në kërkesat e mia të datave 17 dhe 18 tetor 2019, të përcjella ONM-së dhe në kërkesat e të njëjtave data të përcjella në vëmendje të KPK-së dhe ish-relatores së çështjes time, znj. G.B., kam provuar me shkresa dhe kam arsyetuar mbi baza të forta ligjore se trajtimi i procedurës time të rivlerësimit është zhvilluar në kushte të rënda të konfliktit të interesit nga ish-relatorja, znj. B.

Përtej këtij fakti, sikurse kam analizuar në kërkesat e mia, jam terrorizuar kur jam vendosur në kushte intimidimi nga ana e shtetasit T.Gj., i cili më kishte deklaruar fakte dhe rrethana të cilat fatkeqësisht më rezultuan të vërteta, duke më përforcuar bindjen se trajtimi i çështjes së rivlerësimit tim ishte zhvilluar realisht në kushte të konfliktit të interesit.

Më tej, duke mbajtur në konsideratë dinamikën e trajtimit të kërkesave të mia, rezultoi se kërkesa ime për vlerësim të kushteve të ekzistencës së konfliktit të interesit të znj. B. u konsiderua e drejtë, duke u vendosur pranimi i kërkesës së kësaj komisionereje për t'u përjashtuar nga trupa gjyquese.

Deri në këtë fazë, ndryshe nga sa konstaton vëzhguesi, nuk më rezulton asnjë problematikë në lidhje me veprimtarinë time si subjekt në rivlerësimin dhe përdorimin e të drejtave të mia për të pasur një procedurë të rregullt ligjore.

Në kuadër të sjelljeve joprofesionale të pretenduara ndaj meje, vëzhguesi arsyeton se unë si subjekt kam tentuar të krijoj një kontakt të drejtpërdrejtë me vëzhguesin ndërkombëtar, e kjo me qëllim krijimin e një trajtimi më të favorshëm ndaj meje.

Ky konstatim dhe deduksion i bërë nga vëzhguesi më rezulton në një nonsens logjik.

Kërkesat e mia, qoftë drejtuar Komisionit, ashtu edhe ONM-së, janë zhvilluar përmes e-mailit publik të deklaruar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si kanal zyrtar komunikimi gjatë procedurës së rivlerësimit. Në këtë kuptim, çdo komunikim i zhvilluar nga kjo adresë e-maili konsiderohet publik, i lëshuar në mënyrë të vullnetshme dhe gëzon publicitetin e nevojshëm në raport me të gjitha subjektet e përfshira në procesin e rivlerësimit. Për këtë arsye, një e-mail i dërguar nga ky kanal komunikimi nuk mund as të konceptohet, e jo më të konsiderohet si tentativë për të influencuar.

Edhe nëse konsiderohet i tillë, çfarë kam tentuar të influencoj? Në çfarë mënyrë kam tentuar të influencoj? Përmes çfarë të dhënash kam tentuar të influencoj?

Duke mos gjetur asnjë përgjigje mbi këto pyetje që lindin natyrshëm nga konstatimi i vëzhguesit, më rezulton një shkëputje e linjës logjike ndërmjet akteve të administruara dhe konstatimit që bën ky i fundit.

Në kërkesat e përcjella ONM-së kam shfaqur të njëjtat shqetësime që kam kundrejtuar edhe drejt KPK-së. Këto shqetësime të mia ishin të bazuara, të marra shkas nga një rrethanë faktike të prezantuar para organeve të Veting-ut, e që në thelb paraqitnin një shqetësim normal dhe të ligjshëm timin që më kishte rezultuar gjatë punës time, e që fatkeqësisht m'u konfirmuan nga vendimmarrja e mëpasshme e Komisionit, me relatore znj. B.

Duke qenë se ky shqetësim i imi u gjend i drejtë nga Komisioni, ka qenë plotësisht e justifikueshme që në mbështetje të parimit Kushtetues për një proces të rregullt ligjor, të jepej një shpjegim apo të vlerësohej në vijimësi fakti i prezantuar prej meje para ONM-së mbi ndodhinë dhe pretendimet cenuese ndaj meje, të prezantuara nga shtetasi T.Gj.

Nga sa më sipër, mendoj se prezantimi i një shtete aspak normale, ku përfshihen rrethana që krijojnë dyshime serioze për ekzistencën e kushteve të konfliktit të interesit, për më tepër kur ky prezantim bëhet përmes e-mailit publik, në mënyrë zyrtare, nuk përbën asnjë indicie minimale për të justifikuar opinionin e vëzhguesit për ta konsideruar këtë sjellje si joprofesionale.

Sjell në vëmendje të Komisionit se, ndryshe nga sa konstaton vëzhguesi, kërkesat e mia të përcjella nga e-maili zyrtar, i njoftuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ishin të formuluar kuptueshëm, me kërkim të qartë dhe të arsyetuar, me identifikim të dërguesit dhe pranuesit të kërkesave dhe me bazë ligjore të cituar në hyrjen e çdo kërkesë. Në këtë mënyrë kërkesat jo vetëm përmbushnin kriterin përmbajtësor, por edhe atë formal të tyre.

Në përfundim të trajtimit të pjesës së parë të kësaj gjetjeje, nga një analizë objektive e rrethanave të faktit, vendimmarrjes së Komisionit dhe bazës ligjore relevante, mendoj se, jo vetëm që nuk kam kryer asnjë sjellje që bie ndesh me profesionalizmin tim, por nga ana e ish-vëzhguesit dhe vëzhguesit aktual duhet të verifikoheshin kushtet nëse ndodheshim në situatën e neneve 16/1, 16/10 dhe 17/1/2 të ligjit nr. 84/2016, kur duhet iniciuar një procedurë disiplinore ndaj komisioneres B.

Për sa kohë më rezulton që nga vëzhguesi është prezantuar si gjetje një komunikim mëse korrekt i imi dhe tentativë e imja për të shmangur një konflikt të rëndë interesi, nuk dua ta besoj që nga ky i fundit nuk është bërë asnjë veprim për të verifikuar veprimtarinë e komisioneres B., e për më tepër kur një vendimmarrje e Komisionit e konsideron këtë komisionere të ketë vepruar në kushte të konfliktit të interesit, e kjo me vetëdije të plotë të kësaj të fundit.

*Në gjetjen nr. ***, të përcjellë në vëmendje të Komisionit në datën 30.9.2020 nga vëzhguesi, pretendohet për sjellje joetike nga ana ime.*

Për të arritur në këtë konkluzion, vëzhguesi citon:

- deklaratën e dërguar në datën 5.9.2020, nga gjyqtari H.K.;
- e-maillet e datave 17, 18 tetor 2019 dhe 4 nëntor 2019, dërguar nga subjekti drejt ONM-së;
- denoncimin e shtetasit Rr.Sh. drejtuar KPK-së dhe ONM-së.

Por nuk jepet asnjë e dhënë konkrete se cilat janë këto burime. Çfarë kanë informuar këto burime? Si kam ndikuar dhe si mundem unë si subjekt të ndjek dhe të vëzhgoj komisionerët apo vëzhguesit ndërkombëtarë?

Paraqitja e një opinioni dhe më tej akoma, e një gjetjeje nga vëzhguesi, duhet të referojë në të dhëna të sakta dhe fakte të ndodhura. Ngritja e akuzave në ngarkimin tim (sikur unë vëzhgoj apo survejoj komisionerët dhe vëzhguesit) në thelb përbën një cenim të rëndë, jo vetëm të moralit, por edhe të reputacionit që kam unë si magjistrat.

Për këtë arsye, lëshimi i këtyre deklaratave, në kushtet e një mungese totale të faktit, e aq më pak pa paraqitur asnjë provë (sepse nuk ka të tilla, pasi veprimet e pretenduara të kryera prej meje nuk ekzistojnë), mendoj se përbën një cenim etik dhe profesionalizmi të vëzhguesit dhe jo timen. Nuk mund të pretendohet të bëhet një gjetje apo të jepet një opinion pa asnjë të dhënë, pa asnjë provë, por vetëm mbi baza subjektive dhe denoncues të sajuar, që mundet të burojnë dhe nga vetë aty brenda. Vlerësimi objektiv i fakteve dhe rrethanave, si dhe ndërlidhja logjike e tyre, e bën sistematik dhe të qenësishëm një opinion që kërkon të jepet nga një vëzhgues i këtij procesi, por që të gjitha këto kriterë vlerësimi, kanë çeduar në këtë rast.

Në përfundim të kësaj gjetjeje, citohet denoncimi i paraqitur nga ana e shtetasit 'Rr.Sh.'.

Për të verifikuar këto të dhëna të pretenduara në këtë denoncim, ju jam drejtuar me kërkesa zyrtare institucioneve, ku është drejtuar ky material, e në përgjigje kam përfutur përgjigjet përkatëse, të cilat i vendos në dispozicion të Komisionit.

Nga vlerësimi objektiv i këtyre të dhënave të rezultuara, provohet se pretendimet e denoncuar në materialin e përcjellë prej të ashtuquajturit Rr.Sh., janë plotësisht të

pavërteta dhe të gjitha të dhënat e mbledhura dëshmojnë se personi që ka bërë denoncimin nuk përputhet me personat që kanë si identitet të tyre emrin Rr.Sh.

Në këtë mënyrë, përfundimisht po ju vë përballë fjalën time të nderit, fjalën e thënë me dokumente nga të gjitha institucionet ligjzbatuese që e kanë për detyrë të ndjekin probleme të tilla, provat konkrete për të qenurit totalisht i rremë i Rr.Sh., si në identitet, ashtu dhe në përmbajtje, duke kërkuar zhvendosjen e bazueshmërisë nga thashethemet, në zbatimin korrekt të ligjit”.

Në përfundim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë gjetje, janë dorëzuar dhe administruar aktet shkresore:

- kthim përgjigje nga Garda e Republikës;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Rinas;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 1;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 2;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 3;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 4;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 5;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 6;
- kthim përgjigje nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë;
- kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- kthim përgjigje dhe praktika e trajtimit të denoncimit nga Prokuroria e Tiranës;
- kthim përgjigje nga Zyra e Regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës (tri copë).

Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se çdo veprim mbi përgjimin e mundshëm të z. H.K., jo vetëm që s’ka asnjë lidhje me të si subjekt rivlerësimi, por nëse do ishte bërë gjatë ushtrimit të detyrës dhe në funksion të detyrës, përbën veprën penale “shpërdorim detyre” dhe nëse është bërë në rang privat përbën përsëri veprën penale, konkretisht atë të përndjekjes, prandaj kjo procedurë duhet t’i nënshtrohet një hetimi penal dhe jo administrativ.

Konstatimi i Komisionit

Lidhur me këtë gjetje dhe pas përgjigjeve dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti në rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, Komisioni, pas shqyrtimit të plotë të saj nuk konstatoi shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Nga ana tjetër, nga asnjë institucion ligjzbatues në Shqipëri nuk rezultoi asnjë lloj e dhëne, prove apo *indicieje* që të lidhë subjektin e rivlerësimit me pretendimin e ngritur.

Burimi i provës për vërtetimin e faktit të pretenduar është denoncimi i paraqitur nga Rr.Sh., i depozituar pranë Komision. Nga hetimi administrativ nuk rezultoi të administrohet asnjë fotografi, apo përgjim për ish vëzhguesin z. K., dhe as rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë njohuri në lidhje me to. Pretendimet e bazuara në letrën e Rr.Sh., mbeten pretendime të shprehura nga ky i fundit pa asnjë të dhënë tjetër me vlerë provuese.

Nga ana tjetër, bazuar në dokumentacionin e administruar, nuk rezultoi që z. K. ta ketë adresuar shqetësimin e tij gjatë qëndrimit në Shqipëri në asnjë nga agjencitë kompetente për ndjekjen e rastit, si ne polici apo prokurori, fakt ky i konfirmuar nga përgjigjet zyrtare.

3. Vëzhguesi ndërkombëtar ka dërguar pranë Komisionit në datën 21.10.2020, dy Gjetje³⁶ bazuar në figurën e subjektit të rivlerësimit.

³⁶ Shihni 2 gjetjet me nr. *** dhe nr. *** prot., të vëzhguesit ndërkombëtar dërguar në Komision në datën 21.10.2020.

I. Vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur Gjetje në lidhje me një denoncim që është depozituar pranë ONM-së më 24.8.2020, ku denoncuesi rezulton të jetë personi me emrin Rr.Sh., denoncim në të cilin janë ngritur pretendime të shumta në lidhje me sjelljen profesionale dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit³⁷.

Në lidhje me Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit³⁸ për këtë çështje deklaroi:

- *“Zgjidhja e martesës e bërë nga ime në vitin 2019, nuk ka asnjë lloj ndikimi në procesin tim të rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*
- *Nuk ka asnjë arsye ligjore dhe faktike, për aq kohë sa martesë apo zgjidhja e martesës nuk janë fakte që ndikojnë në punën time si prokuror i Republikës së Shqipërisë, të bëhen pjesë e procesit të rivlerësimit për efekt analizimi, e aq më tepër të konkludohet me gjetje për një situatë të tillë.*
- *Zgjidhja e martesës ka rregulluar vetëm pasoja që lidhen ngushtësisht me jetesën time personale si individ, jetesën e fëmijëve të mi dhe asnjë lloj pasojë që mundet të ketë ndikim në procesin e rivlerësimit.*
- *Do kërkoja nga ana juaj që këto elemente të trajtohen në bazë të ligjit dhe jo mbi thashetheme të çuditshme.*
- *Është e nevojshme që procesi im i rivlerësimit të jetë në përputhje me parimet kryesore kushtetuese që lidhen mbi të gjitha me barazinë para ligjit dhe respektimin e të drejtave të njohura, si në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ashtu edhe në Kushtetutë.*
- *Në aspektin formal, në lidhje me procesin e rivlerësimit i cili përfshin tri kriteret: atë të pasurisë, atë të figurës dhe kriterin profesional, në asnjërin prej tyre zgjidhja ime e martesës nuk ndikon në proces”.*

Në përfundim të shpjegimeve mbi këtë Gjetje, subjekti i rivlerësimit ka depozituar, në cilësinë e provës, aktet shkresore si:

- kthim përgjigje nga Garda e Republikës;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Rinas;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 1;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 2;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 3;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 4;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 5;
- kthim përgjigje nga Komisariati i Policisë Nr. 6;
- kthim përgjigje nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë;
- kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- kthim përgjigje dhe praktika e trajtimit të denoncimit nga Prokuroria e Tiranës;
- kthim përgjigje nga Zyra e Regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës, (tri copë).

Konstatimi i Komisionit

Komisioni konstaton se zgjidhja e martesës së subjektit të rivlerësimit është bërë në vitin 2019 me anë të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim trajton çështjen e subjektit në raportin e saj ngushtësisht personal me familjen, ish-bashkëshortin dhe fëmijët.

³⁷ Shihni gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të paraqitur në Komision në datën 21.10.2020.

³⁸ Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Komisioni nuk konstatoi problematika apo çështje nga procedura e ndjekur, vendimi gjyqësor dhe pasojat për zgjidhjen e martesës së subjektit të rivlerësimit, që lidhen me kriteret e rivlerësimit, sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016.

II. Vëzhguesi ndërkombëtar deklaroi në datën 21.10.2020 ekzistencën e kontaktit të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2002, gjykata italiane ka gjetur fajtorë dhe dënuar shtetasit A.K. dhe A.B., të pretenduar si ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe ish-kunati i saj³⁹.

Në lidhje me Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴⁰ për këtë çështje deklaroi:

*“Gjetja e paraqitur nga vëzhguesi, në vazhden edhe të gjetjeve të tjera, përbën vetëm qëndrimin e tij subjektiv nisur nga të dhëna të administruara prej tij dhe ende të panjohura karshi meje, e mbi të gjitha pa m’u dhënë mundësia që paraprakisht të jap shpjegime mbi këto rrethana, përpara se vëzhguesi ta kualifikojë këtë rrethanë si gjetje apo para se t’i vendoste titullin që ai mendon si më të drejtin. Sjell në vëmendjen e Komisionit se unë jam njohur dhe më pas martuar me bashkëshortin tim në prill të vitit 2007, fakt ky që provohet nga certifikata e martesës, kohë pas të cilës kemi filluar jetesën e përbashkët në katin e tretë të ndërtesës 5-katëshe të ndodhur në rr. ‘****’, ***, Tiranë.*

Fillimisht nga të dhënat që rezultojnë nga vendimi që më keni vënë në dispozicion: rezulton se:

Së pari

Personat me emrat A.B., i datëlindjes 20.1.1970, dhe A.K. i datëlindjes 15.10.1975, nuk janë as ish-bashkëshorti dhe as ish-kunati im, për shkak të identitetit të ndryshëm.

Së dyti

Nga asnjë lloj rrethane nuk ka pasur asnjë lloj indicieje nga asnjë lloj institucioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje të tyre në veprimtari kriminale.

Së treti

S’ka asnjë lloj bazueshmërie për të menduar dijeninë time mbi këtë situatë të pavërtetë.

Nuk kam pasur asnjë informacion, asnjë indicie, asnjë të dhënë mbi rrethana apo fakte që ish-kunati dhe ish-bashkëshorti im të jenë proceduar apo edhe dënuar ndonjëherë nga ndonjë gjykatë e huaj apo shqiptare për çfarëdolloj vepra penale, e jo më për vepra penale të përfshira në rrafshin e tyre të cilësuar si ‘krim i organizuar’.

Vendosem në kontakt të këtyre rrethanave vetëm pasi jam njohur me rezultatet e hetimit dhe citimin e vendimit të dënimit, pasi nuk kam pasur asnjë mundësi dhe asnjë indicie nga asnjë person për ekzistencën e një ngjarjeje të tillë.

Për këtë arsye, objektivisht dhe subjektivisht, nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë informacion, asnjë të dhënë mbi çka citohet në këtë gjetje, duke u gjendur qysh në periudhën e plotësimit të formularit, ashtu edhe aktualisht, e painformuar me asnjë të dhënë për ekzistencën e këtij fakti të evidentuar në këtë Gjetje të vëzhguesit.

Kontaktet me ish-bashkëshortin tim sigurisht që kanë qenë permanente, por kurrë nuk më është komunikuar ekzistenca e një fakti apo rrethane të tillë. Ndërsa në lidhje me ish-kunatin, kontaktet me të, për efekt të jetesës në të njëjtën banesë, kanë qenë në kuadrin e fqinjësisë.

³⁹ Shihni gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar dërguar pranë Komisionit në datën 21.12.2020.

⁴⁰ Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Edhe sot që paraqes këto shpjegime, nuk jam në dijeni dhe nuk kam asnjë informacion as mbi periudhën, rrethanat apo kushtet e zhvillimit të këtij procedimi apo gjykimi.

Qoftë në të shkuarën por edhe aktualisht, nuk rezulton asnjë e dhënë në formën e indicies për të më krijuar dyshim për ekzistencën e këtij fakti të cituar në Gjetjen e vëzhguesit.

Qoftë ish-bashkëshorti, ashtu edhe ish-kunati im, nuk kanë rezultuar dhe nuk rezultojnë (referuar kërkesave të përcjella prej meje pas njoftimit të rezultateve të hetimit), ndonjëherë të dënuar, për kryerjen e ndonjë vepre apo kundërvajtje penale, sipas informacioneve zyrtare.

Me sa jam në dijeni, ndaj këtyre personave, qoftë në të shkuarën, ashtu edhe aktualisht, nuk di të ketë pasur apo të ketë ndonjë ndalim ligjor që nuk i lejon ata të dalin nga Shqipëria drejt një vendi tjetër të Europës. Nuk di që të kenë qenë ndonjëherë në kërkim nga ndonjë organ ligjzbatues dhe nuk di të kenë vuajtur ndonjëherë ndonjë dënim penal në Shqipëri dhe as në ndonjë vend tjetër të Europës apo të botës.

Duke qenë se gjatë 12 viteve jetese më ish-bashkëshortin tim, dhe për sa kam pasur kontakt me ish-kunatin, nuk kam pasur asnjë indicie dhe asnjë të dhënë për të cilën unë mund të shfaqja dyshime mbi ekzistencën e dënimit të cituar nga vëzhguesi në këtë raport.

Sidoqoftë, për një saktësim të plotë të situatës, brenda mundësive me burime informative në Itali jam interesuar nga burime të miat ku kam kërkuar informacion në lidhje me këtë rrethanë.

Për aq sa prezantohen në këtë vendim të gjykatës italiane, të përcjellë nga ana juaj si fotokopje, konstatohet mungesa thelbësore e ngritjes së një dyshimi për kontakt të papërshtatshëm për arsyet e mëposhtme:

Së pari, pretendimi nuk është i provuar, pasi ka që në dukje ndryshime të identitetit të personave të përmendur të vendim.

Së dyti, nuk ka asnjë element që të provojë dijeninë time në lidhje me një fakt të tillë, që të obligon në mbajtjen e përgjegjësisë në rang të një kontakti të papërshtatshëm.

Në këto kushte:

- Personi me emrin A.B. (jugosllav) nuk përputhet në identitet me ish-bashkëshortin tim.
- Personi me emrin A.K. nuk përputhet me identitetin me ish-kunatin tim.

Sidoqoftë, për të qenë sa me korrekt, jo vetëm me pretendimin e ngritur nga vëzhguesi ndërkombëtar, por me veten time në radhë të parë, kam bërë kërkimet e mia pas marrjes së kësaj gjetjeje, si më poshtë:

Kërkimet e bëra brenda vendit:

I jam drejtuar me kërkesë të gjitha institucioneve të shtetit shqiptar duke kërkuar informacion sa më poshtë:

1. A keni informacion nga çfarëdolloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë, ajo e shtetasit A.B., i datëlindjes 20.1.1973?
2. A keni informacion nga çfarëdolloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë, ajo e shtetasit A.B., i datëlindjes 15.10.1975?
3. Kërkëse për marrjen e dëshmisë së penaltetit për shtetasin A.B..
4. Kërkëse për marrjen e dëshmisë së penaltetit për shtetasin A.B..

Në përgjigje të kërkesave të bëra nga ime, konkretisht institucionet si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përmes shkresës së datës 24.2.2021, ka konfirmuar se nuk disponon asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë ajo apo veprimtari që lidhet me krimin e organizuar për shtetasit A.B. dhe A.B.
- Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me shkresën e datës 19.2.2021, ka konfirmuar se nuk disponon asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë ajo apo veprimtari që lidhet me krimin e organizuar për shtetasit A.B. dhe A.B.
- Drejtoria e Kufirit dhe e Migracionit, me shkresën e datës 23.2.2021, ka konfirmuar se nuk disponon asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë ajo apo veprimtari që lidhet me krimin e organizuar për shtetasit A.B. dhe A.B.
- Nga marrja e akteve dëshmi penaliteti në emër të shtetasve A.B. dhe A.B., rezulton statusi i tyre gjyqësor, të padënuar.

Në këto kushte, në të cilat asnjë institucion në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk disponon një të dhënë të tillë, është e pamundur nga ana ime, jo vetëm të kem pasur dijeni, por të kem pasur qoftë edhe indicien më të vogël që të futem në fazën e kërkimit për të marrë informacion.

Kërkimet e bëra jashtë vendit:

Në lidhje me këtë vendim gjykatë rezulton se personi me emrin A.B. të ketë marrë pafajësi të formës së prerë, pavarësisht se nuk përputhet në identitet me ish-bashkëshortin.

Në analizë të rrethanave të mësipërme, në të cilat:

- Në dijeninë time personat që përmenden në vendimin e gjykatës italiane nuk janë as ish-bashkëshorti dhe as ish-kunati im, siç rezultojnë nga aktet.
- S'ka asnjë informacion të shkruar nga institucionet shqiptare mbi një pretendim të tillë.
- Kanë lëvizur lirshëm për, dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë, pa pasur asnjë problem në asnjë lloj kufiri.
- Bëjnë një jetë normale dhe në përputhje me ligjin.

Konkludoj se nuk ka asnjë lloj arsye për të cilat të kem përgjegjësi unë për diçka që jo vetëm nuk më përket, por dhe nuk përputhet me aktet.

Të ndodhur në rrethanat e shpjeguara më sipër, unë nuk kam pasur dhe aktualisht nuk kam asnjë dijeni mbi çka pretendohet dhe citohet në Gjetjen e vëzhguesit.

Në një vështrim të thjeshtë të këtij akti që më keni vënë në dispozicion si vendim i gjykatës italiane, rezulton se ky vendim është dhënë në mungesë qoftë dhe për personin me identitet A.K., me shtetësi kosovare dhe jo shqiptare.

Në një kërkim të thjeshtë në Kosovë rezultojnë të jenë disa individë me emrin A.K.

Nga ana tjetër, ish-kunati A.B. është një shtetas i rregullt që bën një jetesë krejt normale, i martuar dhe me dy fëmijë, që dhe për shkaqe shëndetësore është shumë i kontrolluar në jetesën e tij.

Për këtë arsye, sqaroj Komisionin se i jam përgjigjur me korrektesë dhe sinqeritet maksimal pyetjeve të gjendura në formularin përkatës për sa i përket figurës, sepse jo vetëm në kohën e plotësimit të formularit, por deri në momentin e paraqitjes së rezultateve të hetimit, nuk kisha asnjë dijeni për 'dënimin e pretenduar', të ish-bashkëshortit dhe ish-kunatit tim.

Për rrethanat e shpjeguara prej meje, mbi mosdijeninë time absolute karshi ekzistencës së këtij dënimi, ftoj Komisionin të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme, të marrë informacione nga çdo institucion, siç dhe mora unë personalisht informacion në lidhje me ndonjë rrethanë që më ekspozon mua kundrejt dijenisë për një rrethanë të tillë.

Duke u referuar në konstatimin e vëzhguesit, pretendohet se dënimi të jetë dhënë nga një gjykatë italiane në vitin 2002.

Kujtoj se martesë mes meje dhe ish-bashkëshortit tim është bërë në vitin 2007, vit në të cilin kam filluar edhe bashkëjetesën me këtë të fundit.

Përgjatë martesës, ish-bashkëshorti veçmas, apo së bashku, kemi udhëtuar jashtë Shqipërisë, por kurrë nuk ka rezultuar ndonjë problematikë apo e dhënë tjetër për të më krijuar mua ndonjë indicie se ekziston ndonjë rrethanë që nuk lejon lëvizjen apo shton dyshimin për ekzistencën e një vendimi dënimi jashtë Shqipërisë.

Në një vështrim të rasteve të ngjashme, edhe sikur ta marrim të mirëqenë se ish-kunati është A.K., të mbajtur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, po përmend arsyetimet e mbajtura në vendimet si më poshtë:

- vendimi nr. ***, datë 22.11.2018, për subjektin e rivlerësimit E.Dh.;*
- vendimi nr. ***, datë 26.7.2019, për subjektin e rivlerësimit K.B.;*
- vendimi nr. ***, datë 17.1.2020, për subjektin e rivlerësimit S.S.*

Pika 3 e nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, parashikon: 'Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve, por gjithashtu çdo rrethanë lehtësuese që lidhet me çdo gjetje. Çdo vlerësim i kontrollit të figurës që nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese, konsiderohet i paplotë'.

Me qëllim qartësimin e kësaj gjetjeje sipas kërkesave ligjore të përcaktuara më lart, vëzhguesi ndërkombëtar i ka pasur të gjitha mundësitë të kërkonte sqarime nga ana ime si subjekt i rivlerësimit, duke më drejtuar pyetje, por një situatë e tillë në ndryshim nga çdo rast tjetër i hetuar në KPK, nuk është ndjekur.

Me përjashtim të faktit se kam jetuar në raporte fqinjësie me ish-kunatin e pretenduar si të dënuar, nuk kam asnjë lloj raporti tjetër me të, e për më tepër në situatën aktuale, ku për shkak të divorcit nuk kam asnjë lloj afrimiteti.

Për sa më sipër, deklaroj se:

- nuk kam pasur kontakte me ish-kunatin, kontaktet kanë qenë si në çdo raport fqinjësor që mundet të keni secili prej jush;*
- nuk kam pasur marrëdhënie afrimiteti me ish-kunatin, referuar edhe tabulateve telefonike, ku rezulton se për dy vitet e fundit nuk kam asnjë telefonatë me të.*

Për sa më sipër, rezulton krejt e qartë se nuk kam pasur dijeni mbi faktin e pretenduar të dënimit të ish-kunatit, edhe pse këmbëngul që nuk është i njëjti person; nuk kam pasur mundësi që një fakt të tillë ta mësoja drejtpërdrejt nga verifikimi në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore.

Nga sa rezulton nga vendimi që më është vënë në dispozicion, vendimi i dënimit është dhënë në mungesë dhe, si e tillë, as vetë personi nuk ka dhe nuk ka pasur mundësi të kishte dijeni për një gjë të tillë.

E njëjta linjë arsyetimi është ndjekur dhe mbajtur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në rastin e vendimmarrjes për subjektin e rivlerësimit E.Dh.

*Nga vendimi i arsyetuar rezulton se në të njëjtën linjë arsyetimi dhe konkluzioni rezulton që të ketë arritur edhe z. J.L., vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2018, i përshkruan në mënyrë sintetike rrethanat e mësipërme dhe i parashtron si të detyrueshme për t'u marrë në konsideratë në përputhje me pikën 3, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.*

Edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit K.B. është mbajtur si qëndrim:

'Komisioni, vlerësoi se: Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa 5, të dhëna për sigurinë, subjekti ka deklaruar se nuk ka dijeni se një nga anëtarët e familjes është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

... Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në hetimin e kryer për këtë çështje, krijoi bindjen se subjekti nuk ka pasur kontakte të vazhdueshme me shtetasin E.V. Kjo rrethanë e kontakteve të rralla familjare se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni për arrestimin e kunatit E.V., u mor në konsideratë nga Komisioni si rrethanë lehtësuese në përputhje me pikën 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni krijoi bindjen se përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ishin bindëse, se ai ka qenë i besueshëm, i hapur dhe i plotë në deklaratimet e tij lidhur me dijeninë e arrestimit dhe kontaktet e rralla me shtetasin E.V. Gjatë hetimit Komisioni nuk konstatoi asnjë indice apo të dhënë për dijeninë e subjektit lidhur me arrestimin e kunatit të tij, z. E.V., në vitin 2012'.

Edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit S.S. është mbajtur e njëjta praktikë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndaj nuk ka asnjë arsye të mendohet se ish-kunati im, për asnjë lloj rrethane, të ketë raporte më të afërta me mua, se çka kunati i E.Dh. me të apo kunati i K.B. me të, apo djali i tezes së S.S. me të.

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë se kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar të figurës që mbulon periudhën 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit. Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: 'Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarameve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës'.

Neni 38, 'Standardet e kontrollit të figurës', pika 3, 'Kontrolli i figurës' përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të këtij neni dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementët e parashikuar në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë. Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës, përcaktohen nga paragrafi 4 i nenit 38, të grupuara në 5 kategori.

Ndaj në këtë kuptim edhe vlerësimi i bërë jo në përputhje me parashikimet ligjore nga vëzhguesi ndërkombëtar është i paplotë.

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar për figurën, që mbulon periudhën nga 1 janari 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit, pra subjekti i rivlerësimit deklaroi për kontakte të papërshtatshme referuar kësaj periudhe. Mënyra e kontrollit të figurës detajohet brenda parimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, që në nenin 34 të tij përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës: 'Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarameve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të

Aneksit të Kushtetutës'. Që të deklarohet një kontakt i përshtatshëm apo i papërshtatshëm duhet që subjekti të jetë në dijeni të tij.

Unë nuk kam qenë në dijeni, pasi bëhet fjalë për një vendim të dhënë në shtetin italian në vitin 2002.

Lidhja ime nuk është aq e afërt me ish-kunatin, sa që unë të merrja vesh këtë detaj nga jeta e tij personale, për te cilin as vetë ky nuk kishte dijeni.

Sa më sipër, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, mbi kontrollin e figurës sime si subjekt i rivlerësimit, formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

Në analizë të hetimit të zhvilluar personalisht nga ana ime rezulton se:

1. Nuk u vërtetua që unë si subjekt rivlerësimi të kem apo të kem pasur dijeni në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

2. Unë si subjekt i rivlerësimit e kam plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës në vitin 2017.

3. Personat e paraqitur në vendim nuk janë në identitet as ish-bashkëshorti dhe as ish-kunati.

4. Në emër të personit me identitet tjetër ka një vendim pafajësie të formës së prerë nga gjykata italiane.

5. Vendimi që ju paraqisni është dhënë në mungesë dhe pa dijeninë e personave që ju është përmendur emri.

Në një analizë të thjeshtë, në vendim përmendet edhe emrin A.K., që në Shqipëri përfaqëson një figurë publike, merr pjesë në emisione televizive si analist, studiues dhe publikues, mos duhet vallë të mendojmë që dhe ky individ është dënuar në Itali?

Unë si subjekt e kam plotësuar me saktësi dhe vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës, duke dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me sa me vihet në dispozicion nga vëzhguesi ndërkombëtar.

Po i rikthehem analizës së bërë nga vëzhguesi ndërkombëtar për efekt të banesës së përbashkët.

Të Nderuar!

*Unë kam banuar për shkak martesë në kat të tretë të apartamentit të ndodhur në rr. '***' dhe në kat të dytë si 'fqinj' ka banuar A.B. me dy fëmijët e tij dhe të shoqen, dhe jo A.K., shtetas jugosllav.*

Edhe në rang të arsytimit të parimeve të Bangalore, rezulton mëse e qartë që referenca e mbajtur nga vëzhguesi ndërkombëtar nuk përputhet me rastin konkret.

*Nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar është referuar 'për shkak të banimit në të njëjtën banesë'. Ndërkohë, përdorimi i apartamentit në katin e tretë të banesës me 5 kate, të ndodhur në rr. '***', ka ardhur për shkak të martesës time në vitin 2007.*

Nga ana tjetër, banesa është ndërtuar në mënyrë që në kushtet e një banese si në çdo banesë me individë në raporte fqinjësie, me hyrje të ndara, kate të ndara etj.

Në parimet e Bangalore përcaktohet dhe definicioni si më poshtë:

DEFINITIONS

In this statement of principles, unless the context otherwise permits or requires, the following meanings shall be attributed to the words used:

- "Court staff" includes the personal staff of the judge including law clerks.

- "Judge" means any person exercising judicial power, however designated.

- "Judge's family" includes a judge's spouse, son, daughter, son-in-law, daughter-in-law, and any other close relative or person who is a companion or employee of the judge and who lives in the judge's household.

- "Judge's spouse" includes a domestic partner of the judge or any other person of either sex in a close personal relationship with the judge.

Commentary Judge's family 221. In the definition of "judge's family", the expression "and who lives in the judge's household" applies only to "any other close relative or person who is a companion or employee of the judge" and not to a judge's spouse, son, daughter, son-in-law or daughter-in-law.

Në kuptimin e 'familja e gjyqtarit', shprehja 'dhe kush jeton në të njëjtën banesë', aplikohet vetëm për 'çdo të afërm ose person të gjyqtarit, dhe jo për bashkëshortin e gjyqtarit, birin, vajzën, etj.

Në këtë kuptim s'ka asnjë arsye në kuadër të këtij përcaktimi që vëzhguesi ndërkombëtar të referojë si bazueshmëri arsyetimi dhe parimesh në parimet e Bangalores, për më tepër për ish-kunatin me të cilin nuk kam jetuar asnjëherë në të njëjtën banesë, edhe sikur ta marrim të mirëqenë që bëhet fjalë realisht për ish-kunatin, ndërkohë që qartazi rezulton se nuk është ai.

Në të gjitha vitet e mia si prokuror i jam nënshtruar verifikimeve të vazhdueshme, duke u pajisur me certifikatë sigurie të nivelit 'Tepër sekret', element i cili tregon se asnjë institucion, në asnjë lloj kohe, nuk ka pasur asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për ndonjë situatë të mundshme që më vë mua apo familjarë të mitë në kushtet e pasjes së kontakteve të papërshtatshme.

Bashkëlidhur gjeni certifikatën e sigurisë.

Nga ana tjetër, kam marrë pjesë në trajnime të ndryshme jashtë vendit, ku më është dashur të pajisem me dokumentacion të rregullt nga përfaqësitë e huaja si angleze, amerikane apo dhe në vendet e BE-së.

Në asnjë moment s'kam pasur asnjë lloj problematike në raport me asnjë lloj agjencie brenda dhe jashtë vendit.

Përkundrazi, partnerët tanë ndërkombëtarë janë bërë shkak dhe arsye për trajnimet e zhvilluara nga ana ime në mënyrë të vazhdueshme.

Bashkëlidhur gjeni edhe CV-në time personale.

- Në lidhje me pretendimin e përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar për cenimin e besimit të publikut nga ana ime, po arsyetoj sa më poshtë:

Jam prokuror i Republikës së Shqipërisë prej 16 vitesh dhe gjatë punës time kam hetuar dhe përfaqësuar çështje në gjykim të cilat për shkak të rëndësisë së tyre kanë marrë vëmendje të shtuar të publikut.

... Nuk arrij të kuptoj se me çfarë është matur nga vëzhguesi ndërkombëtar perceptimi se kam cenuar besimin e publikut?

Nuk e shoh në asnjë moment kohor të punës time të përditshme të kem cenuar një besim të tillë.

Por, edhe për të qartësuar Komisionin, si dhe vëzhguesin ndërkombëtar, kam ndërmarrë si iniciativë një metodike matëse të besimit të publikut, të cilën po ua përcjell në formë anketimi.

Nga rezultatet e marra konkludohet se për periudhën kohore nga data 18.2.2021 deri më 22.2.2021, kam arritur të marr të provuar besimin e plote të 3333 personave të anketuar.

Nga ana tjetër, po paraqes në vëmendjen e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar një tjetër mënyrë për matjen e besimit tek publiku, por tashmë të pavarur plotësisht nga ndonjë veprim i imi. Në korrik të vitit 2019 nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë është zhvilluar procesi i përzgjedhjes së kandidatëve prokurorë për në SPAK. Intervistat e zhvilluara me secilin kandidat janë pasqyruar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga ku mundet të dallohet qartazi shikueshmëria e publikut kundrejt prezantimit të çdo kandidati. Në një shikim të bërë nga ana ime, të cilin po ua vë në dispozicion rezulton e kundërta e perceptimit të përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar për cenimin e besimit të publikut.

Në rang krahasimor me koleget e tjerë, prezantimi i bërë nga ana ime ka një shikueshmëri disafish më të lartë se shikueshmëria për çdo koleg tjetër.

Bashkëlidhur keni të dhënat e printuara, të cilat dhe mundet t'i aksesoni direkt në faqen zyrtare të KLP-së.

Së fundmi, figura ime si individ dhe si prokuror për të gjitha këto shkaqe nuk mundet të cenohet dhe as përbaltet nga armiqësi apo dashakeqësi të personave që fshihen, duke i vënë vetes emrin e rremë 'Rr.Sh.'''.

Në përfundim të shpjegimeve në lidhje me këtë Gjetje, subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të saj aktet shkresore, si:

- dëshmi penaliteti për ish-bashkëshortin;
- dëshmi penaliteti për ish-kunatin;
- printime nga sistemi TIMS për ish-bashkëshortin;
- printime nga sistemi TIMS për ish-kunatin;
- raporti nga SHISH në lidhje me përfshirjen e mundshme të subjektit në krimin e organizuar apo për kontakte të mundshme me persona të përfshirë në këto veprimtari të paligjshme;
- raport i përgatitur nga Grupi i Punës (DSIK), i cili ka verifikuar ekzistencën e dijenisë së subjektit për përfshirjen e mundshme të ish-bashkëshortit apo ish-kunatit në krimin e organizuar, apo ekzistenca e dënimeve penale në ngarkim të tyre;
- kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- kthim përgjigje nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë;
- certifikata e sigurisë përcjellë nga DSIK-ja;
- kopje të vendimit të gjykatës dhënë nga gjykata italiane, apel;
- fleta 145 e komentarit të *United Nations* për Parimet e Bangalores;
- këqyrja nga faqja zyrtare e KLP-së;
- anketimi i zhvilluar datë 18.2.2021 deri më 22.2.2021.

Konstatim i Komisionit

Komisioni konstatoi se të dhënat dhe gjeneralitetet e personave të përmendur në vendimin e gjykatës italiane nuk përkojnë me gjeneralitetet e ish-bashkëshortit dhe ish-kunatit të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni gjithashtu vlerësoi edhe përgjigjet e institucione të shtetit shqiptar lidhur me implikimin e mundshëm të ish-bashkëshortit dhe ish-kunatit të subjektit të rivlerësimit, në veprimtari të kundërligjshme.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përmes shkresës së datës 24.2.2021, ka konfirmuar se nuk disponon asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë ajo, apo veprimtari që lidhet me krimin e organizuar për shtetasit A.B. (ish-bashkëshorti) dhe A.B. (ish-kunati).
- Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me shkresën e datës 19.2.2021, ka konfirmuar se nuk disponon asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë ajo, apo veprimtari që lidhet me krimin e organizuar për shtetasit A.B. dhe A.B.
- Drejtoria e Kufirit dhe e Migracionit, me shkresën e datës 23.2.2021, ka konfirmuar se nuk disponon asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për përfshirje në veprimtari kriminale e çfarëdolloji qoftë ajo, apo veprimtari që lidhet me krimin e organizuar për shtetasit A.B. dhe A.B.
- Dëshmitë e panalitetit në emër të shtetasve A.B. dhe A.B. rezultojnë se statusi i tyre gjyqësor është “i padënuar”.

Në këto kushte, në të cilat asnjë institucion në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk disponon një të dhënë të tillë, Komisioni nuk konstatoi se ish-bashkëshorti i subjektit dhe ish-kunati kanë qenë apo janë të dënuar për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se kontrolli i figurës nis me plotësimin e deklaratës për figurën nga subjekti, që mbulon periudhën nga 1 janari 2012 deri në ditën e deklaramit. Pra, subjekti i rivlerësimit deklaroi kontakte të papërshtatshme referuar kësaj periudhe. Neni 34 i ligjit nr. 84/2016 përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës, që është verifikimi i deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, vendimi i Gjykatës Italiane të Apelit, i paraqitur nga ana e subjektit të rivlerësimit tregon një situatë tjetër faktike, ku në dispozitivin e tij tregohet se për personin me emrin A.B, i dtl. 1970, Gjykata ka vendosur pafajësinë për shkak të mos kryerjes së veprës penale.

Kjo situatë faktike gjen pasqyrim tek Ligji nr. 84/2016, ku në nenin 3, pika 15, parashikohet kuptimi i personit të përfshirë në krimin e organizuar, si më poshtë : ‘Person i përfshirë në krimin e organizuar’ është çdo person që është i dënuar apo proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë...me përjashtim të rastit kur ai është i deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi deklaramë të pasakta të subjektit në deklaramën e figurës dhe as kontakte të papërshtatshme të saj me persona të përfshirë në veprimtari kriminale lidhur me vepra që përfshihen në krimin e organizuar.

4. Vëzhguesi ndërkombëtar, në datën 21.12.2020, ka dërguar pranë Komisionit Gjetje⁴¹ lidhur me “kërkesën për heqje dorë”.

Gjetja ka lidhje me “kërkesën për heqje dorë”, të paraqitur nga komisionerja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, znj. E.Ç., më 26.11.2020, dhe vendimin e marrë nga trupi

⁴¹ Shihni gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar dërguar pranë Komisionit më datë 21.12.2020

grykues i caktuar me shortin e datës 3.12.2020, që e ka pranuar kërkesën për heqje dorë të sipërpërmendurës, për të mos qenë pjesë e trupit grykues që do të rivlerësojë çështjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

Vëzhguesi ndërkombëtar specifikon edhe arsyet dhe ngjarjet që e kanë shtyrë komisioneren për të paraqitur këtë kërkesë për heqje dorë.

Në lidhje me Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴² për këtë çështje deklaroi:

“Arsyet për të cilat znj. Ç. ka kërkuar heqjen dorë nga procesi i rivlerësimit tim lidhen shkurtimisht dhe thjeshtë, me ato arsye që ajo i ka prezantuar në kërkesën e saj për heqje dorë. Unë kam 16 vjet që punoj si prokuror i Republikës së Shqipërisë dhe në asnjë moment nuk kam pranuar asnjë lloj ‘ndikimi direkt apo indirekt’ për heqjen dorë nga detyra e ushtruar në një çështje si prokuror, paçka se situata të ndryshme mundet të na bëjnë të ndihemi ‘të parehatuar’ në punën që bëjmë.

Edhe detyra e komisionerit ushtrohet mbi bazën e parimeve të rëndësishme dhe çdo lloj ndërhyrje e çfarëdolloji qoftë ajo, duhet të referohet ne organet përkatëse. Për aq kohë sa znj. Ç. nuk ka parashtruar asnjë rrethanë të tillë, por ka përcjellë faktin se është ndjerë ‘e parehatuar’, cila dispozitë ligjore e çfarëdolloj ligji në fuqi më obligon mua si subjekt rivlerësimi të kujdesem për anën emocionale të anëtarëve të Komisionit apo për qenien e tyre si të rehatuar apo të parehatuar?

Nuk e shoh aspak me vend, dhe për më tepër e shoh si perceptim të gabuar të vëzhguesit ndërkombëtar që më adreson mua veprimet e znj. Ç. për heqje dorë. Megjithatë, unë po ndaloj në një analizë më të posaçme, duke parashtruar pyetjen sa më poshtë: Çfarë kuptimi ka që çdo individ, duke përfshirë edhe gazetarë, paskan dijeni në lidhje me faktin se një person qenka pyetur me cilësinë e dëshmitarit në procesin tim të rivlerësimit, ndërsa unë jam në padijeni totale të një situate të tillë deri në momentin e marrjes së rezultateve të hetimit dhe pas bërjes së kërkesës për të m’u vënë në dispozicion një kopje e pyetjes së këtij personi si dëshmitar?

Në mënyrë që të sqaroj problemet e ngritura si gjetje nga ana juaj, po e ndaj trajtimin e këtij problemi në tre pjesë kryesore:

Së pari: roli i luajtur nga znj. E.Ç. në procesin tim të rivlerësimit dhe kërkesa e paraqitur prej saj për heqje dorë.

Së dyti: dëshmia e marrë personit me emrin B.Sh. dhe sjellja e komisioneres E.Ç. në marrjen e kësaj dëshmie.

Së treti: kërkimi i informacionit se si një gazetar ka marrë dijeni në lidhje me procesin tim të rivlerësimit.

Në lidhje me pikën e parë, znj. Ç. ka referuar se nuk ndihet e rehatuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shqetësim në lidhje me objektivitetin e saj në vendimmarrje.

Unë nuk kam asnjë lloj dijenie në lidhje me këtë rrethanë, nuk ka ndodhur të kem diskutuar asnjëherë me znj. Ç. dhe as ndonjë person të njohur të saj mbi procesin tim të rivlerësimit apo rolin e znj. Ç. në këtë proces. Jam në padijeni të plotë të çdo lloj mbledhjeje, takimi apo dhe ‘thashethemi’, si ato të ‘Rr.Sh.’, të zhvilluar për procesin tim të rivlerësimit dhe nuk kam pasur asnjë lloj dijenie mbi shtatë takime, mbi tetë takime, apo mbi dhjetë takime të zhvilluara. Ajo që shihet qartë edhe në këto gjetje është se i kushtohet me shumë rëndësi ‘thashethemeve’ sesa provave, gjë e cila përfaqëson një problematikë të madhe në kuadër të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të KEDNj-së.

⁴² Shihni përgjigjen e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Nuk njoh asnjë familjar të komisioneres E.Ç. dhe as ka ndodhur ndonjëherë të kem pasur njohje me ndonjë nga familjarët e saj. Nga ana tjetër, jo vetëm është absurde dhe e pambështetur në ligj, por dhe e padrejtë si juridikisht, ashtu dhe në baza logjike që të më kërkohet mua si subjekt rivlerësimi llogaridhënie për rehatinë apo parehatinë e një komisioneri, të një vëzhguesi etj. Do kërkoja me ngulm zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi si për çdo subjekt tjetër rivlerësimi, paçka se e gjithë ecuria e 'mbrapshtë' e këtij procesi lidhet me faktin se ish-relatorja e çështjes time ka vijuar të mbajë çështjen për një vit e disa muaj, në kushtet e konfliktit të interesit dhe, siç e thonë dhe 'thashethemet' me të cilat nuk jam marrë dhe nuk kam ndërmend të merrem, ka marrë përsipër të ndërhyjë tek çdo person për ta bërë të mundur qëllimin e saj.

Edhe unë kam dëgjuar nga këto fjalë, m'i kanë thënë njerëz të ndryshëm, të lidhur apo jo me procesin e rivlerësimit, që ish-relatorja jep detaje kudo për procesin tim të rivlerësimit, mundohet të ndikojë për të më bërë dëm, mundohet të sajojë insinuata në rëndim të pozitës time, mundohet të ndikojë subjektivisht anëtarët e trupës, madje kam dëgjuar se bën dhe presione duke kërcënuar edhe vëzhguesit ndërkombëtarë, por unë personalisht në asnjë moment nuk kam rënë pre e 'thashethemeve' të tilla, dhe kam pritur duke prezantuar prova konkrete mbi ecurinë normale të procesit të rivlerësimit. Është e çuditshme se si ka mundësi që vëzhguesi ndërkombëtar bazon gjetjet, mendimet apo dhe konkluzionet në fjalët e Rr.Sh., person i cili nuk ekziston, është në të njëjtën linjë arsyetimi me Rr.Sh., paçka se asgjë e thënë nga ai në përmbajtje nuk qëndron, dhe nuk merret aspak në kuadër të rolit si vëzhgues me sqarimin e situatës se përse ish-relatorja e çështjes time ka mbajtur çështjen në kushtet e konfliktit të interesit, nëse duhet marrë dhe analizuar një gjë e tillë.

Është mëse normale që të zhvillohet një proces normal si për çdo subjekt tjetër dhe është mëse normale që vëzhguesi ndërkombëtar të operojë edhe në drejtim të realizimit të vëzhgimit të procesit edhe për sa i përket realizimit të të drejtave të mia si subjekt rivlerësimi.

Më është përcjellë me letër të shkruar dhe me mesazhe telefonike, që vëzhguesi ndërkombëtar është subjektiv në procesin e rivlerësimit në ngarkimin tim, por një situatë e tillë është marrë dhe konceptuar nga ana ime si përpjekje e njerëzve dashakeqes për t'i dhënë qoftë mua, qoftë procesit të rivlerësimit orientimin e gabuar. Dhe nga ana ime në raport me këto situata, kur e kam çmuar të arsyeshme, kam bërë kallëzim penal sipas ligjit në fuqi. Sipas jush, çfarë duhet të bëj unë si subjekt rivlerësimi, të marr për bazë dhe të besoj ato që thuhet nëpër tavolina, të marr për bazë dhe të besoj ato që shkruhen nëpër media online, duke na bërë 'pis' secilin prej nesh, të marr për bazë fjalët e Rr.Sh.?

Ne nuk mundet të lejojmë që të biem në analiza të pabazuara të personave që fshihen pas Rr.Sh. apo medias online, që hedhin baltë mbi figurën e dikujt vetëm për të realizuar armiqësitë e tyre personale.

Por, le t'i kthehemi në analizë momenteve kryesore që lidhen me arsyet e prezantuar nga vetë komisionerja për heqje dorë, dhe konkretisht:

- ka mbyllur hetimin me një kriter dhe më pas ka vendosur për tre kritere;
- ndihet e parehatuar me familjarët e saj;
- dhe i ka bërë një pyetje një gazetar.

Normalisht të Nderuar, mbyllja e hetimit me një kriter për një individ si puna ime, që s'ka asnjë lloj pasurie dhe i ngarkohet barrë për pasuri paramartesore, në kundërshtim dhe me vetë qëndrimin e mbajtur nga komisionerja Ç. në raste të njëjta (shihni vendimin për E.K.), e bën komisioneren të ndihet e parehatuar, por kjo situatë s'ka lidhje me asnjë lloj veprimi apo mosveprimi të kryer nga ana ime, por me bindjen e saj.

Në mënyrë direkte komisionerja është pyetur qoftë nga vëzhguesi ndërkombëtar, qoftë nga trupa gjyquese që mori në shqyrtim kërkesën e saj për heqje dorë, nëse ka pasur ushtrim ndikimi, nëse ka pasur presion apo kërcënim apo ndonjë rrethanë tjetër që përbën shkelje ligjore, dhe ajo është përgjigjur se nuk ka pasur.

Nga ana tjetër, sapo jam njohur me deklaratimet e dhëna para KPK-së nga shtetasi B.Sh., i thirrur për t'u pyetur si dëshmitar nga komisionerët G.B. dhe E.Ç., në prani të vëzhguesit ndërkombëtar H.K., pasi kam marrë kopjen e këtij procesverbali pyetje. Nuk dihet mënyra e thirrjes së këtij dëshmitari, në aktet e dosjes s'ka asnjë shkresë, fletëthirrje, urdhërthirrje, procesverbal të thirrjes së tij me telefon etj., ndaj mbetet e paqartë se si është administruar në dosje kjo dëshmi?

- *Për efekt analizimi do ndalem për të trajtuar si individin e thirrur si dëshmitar, mënyrën e thirrjes së tij, ashtu edhe qëndrimin e mbajtur nga dëshmitari dhe komisionerët.*

Për sa i përket dëshmitarit B.Sh., ky shtetas, sipas përgjigjeve të marra nga zyra e regjistrimit në prokurori, rezulton të ketë tre procedime penale në hetim nga prokurorë të ndryshëm për veprat penale 'mashtrim' dhe 'falsifikim dokumentesh'. Unë personalisht, me cilësinë e prokurorit, nuk kam pasur asnjëherë në hetim një shtetas të tillë dhe me këtë emër, dhe unë personalisht nuk kam pasur asnjëherë lidhje me ndonjë çështje të tijën.

Sidoqoftë, nga kërkimet e mia ka rezultuar se znj. G.B. e ka pasur klient të saj in këtë shtetas në kohën kur ushtronte detyrën e përmbarueses gjyqësore dhe madje sipas të dhënave nga akti që po ju vendos në dispozicion, koha e zgjatjes së procesit ka qenë disi e gjatë, çfarë ju jepte totalisht mundësinë për krijimin e një njohjeje mes tyre. Bashkëlidhur keni aktin konkret, ku rezulton G.B. me cilësinë e përmbarueses gjyqësore. Nga ana tjetër, në rang të mënyrës së thirrjes së dëshmitarit, nuk shoh asnjë shkresë, asnjë kërkesë apo urdhër për t'u paraqitur qoftë dhe një njoftim i thjeshtë i bërë për këtë dëshmitar.

- *Cila është mënyra procedurale e thirrjes së këtij shtetasi si dëshmitar kundër meje në proces?*
- *Cila është mënyra e administrimit të dosjes së kësaj dëshmie?*
- *Përse nuk ka marrë pjesë në pyetjen e këtij dëshmitari anëtari tjetër i trupës gjyquese?*

Në vijim të analizës dhe në studim të dëshmisë së paraqitur nga pyetjet e paraqitura nga komisionerja B., del e qartë situata sugjestionuese në të cilën ajo e vendos dëshmitarin e pyetur.

Nga ana tjetër, komisionerja Ç. e pyet shprehimisht dëshmitarin 'A doni ju të bëheni bashkëpunëtor drejtësie', ndërkohë këtë atribut nuk ja ka dhënë ligji nr. 84/2016, dhe asnjë ligj tjetër.

Në këtë mënyrë, si ka mundësi që këto detaje i kanë shpëtuar pa analizuar Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe si ka mundësi që i vetmi detaj që ju bën sens është denoncimi i sajuar i 'Rr.Sh.'?

Në dëshminë e dhënë nga shtetasi B.Sh. ai tregon dhe për një gazetar tjetër, ja dhe një gazetar tjetër që na paska dijeni në raport me ngjarjen!

Pra, fakti i paraqitjes së kërkesës nga B.Ç. bën më shumë sens ligjor dhe logjik të ketë lidhje me kolegun e tij apo të jetë në drejtim të punës së tij si gazetar sesa të ketë një lidhje joekzistuese me mua personalisht. Do ishte më normale dhe logjike të veprohej mbi baza argumentesh, provash dhe jo thashethemesh, sepse ky proces duhet të jetë i drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Ndërkohë përsëri vjen në skenë denoncimi i 'Rr.Sh.', për të cilin risjellim në vëmendjen e Komisionit dhe ndërkombëtarit edhe një herë si më poshtë:

Për të gjitha këto fakte të paqena vëzhguesi ndërkombëtar i referohet një denoncimi të bërë nga një person me emrin Rr.Sh.

Nuk shoh asnjë veprim të kryer nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar për të identifikuar apo marrë në pyetje shtetasin me emër Rr.Sh., ashtu siç nuk shoh asnjë veprim të vëzhguesit ndërkombëtar apo të Komisionit të kryer për të verifikuar përmbajtjen e denoncimit të bërë nga Rr.Sh.

Në çdo formë hetimi për të vlerësuar besueshmërinë e deklarimeve apo përmbajtjes së një denoncimi duhet të bazohemi në disa elementë që po i rendisim si më poshtë:

- identifikimin e denoncuesit/dëshmitarit/deklaruesit;
- krijimin e një baze vlerësimi për besueshmërinë e denoncuesit/dëshmitarit apo deklaruesit si individ;
- vërtetimin e përmbajtjes së të dhënave të marra nga denoncuesi/dëshmitari apo deklaruesi.

Në rastin konkret nuk është ndërmarrë asnjë lloj veprimi për t'u kryer si mjet kërkimi prove, i cili shërben për mbledhjen dhe administrimin e provave.

Në lidhje pikën e parë, edhe pse nuk është bërë nga as nga Komisioni dhe as nga vëzhguesi ndërkombëtar, nga ime janë bërë kërkimet për të evidentuar të gjitha detajet që lidhen me denoncimin e shtetasit Rr.Sh.

Së pari: kam kryer veprimet e nevojshme për të evidentuar identifikimin e plotë të denoncuesit, nga ku rezulton se në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë tre persona me emrin Rr.Sh. dhe konkretisht:

- Rr.Sh., i datëlindjes 20.8.1945, lindur në ***, Dibër dhe banues në ***, Dibër;
- Rr.Sh., i datëlindjes 15.5.1973, lindur në Dibër dhe banues në ***, Dibër.
- Rr.Sh., i datëlindjes 5.1.1994, lindur në Dibër dhe banues në ***, Tiranë.

Asnjë nga këta persona nuk ka depozituar një denoncim të tillë tek ONM-ja, çfarë nënkupton që emri i vënë është një emër i vënë kot dhe denoncimi ka buruar nga persona të tjerë të cilët nuk janë nisur nga tregimi i fakteve reale, por janë nisur nga dashakeqësia dhe armiqësia karshi personit tim.

Megjithatë, le të lëmë mënjatë anën emocionale dhe ta trajtojmë juridikisht përmbajtjen e denoncimit të sjellë tek ONM-ja nga i ashtuquajtimi Rr.Sh.

Sipas akteve që më keni vënë në dispozicion në denoncimin e bërë nga një burim anonim, që ka dashur t'i vërë vetes emrin Rr.Sh., ngrihen këto pretendime:

- *Ka dijeni për Prokurorinë e Tiranës se e ka zënë halli për çështje pronash.*

Për të vërtetuar një pretendim të tillë i jam drejtuar me kërkesë Zyrës së Regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës, duke kërkuar informacion nëse ka kallëzim apo të kallëzuar, apo procedim në këtë prokurori për ndonjë shtetas me emrin Rr.Sh. Nga përgjigjja e kthyer rezulton se nuk ka asnjë kallëzim, të kallëzuar apo procedim në këtë prokurori për ndonjë shtetas me emrin Rr.Sh..

- *Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht, pretendon se unë nuk jam divorcuar.*

Një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi ka një vendim gjykate dhe një procedurë të ndjekur ligjore që dokumentojnë zgjidhjen e martesës.

- *Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht pretendon për një çështje me kallëzues F.P.*

Me kërkesë drejtuar Zyrës së Regjistrimit në Prokurorinë e Tiranës është kthyer përgjigjja se prokurori Elizabeta Imeraj nuk ka ndjekur kurrë hetime në raport me ndonjë çështje me kallëzues F.P.

- Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht pretendon për shkelje të kryera nga ana ime në lidhje me shortin që zhvillohet në prokurori.

Një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi konform urdhrorit që po ju vendos në dispozicion shorti hidhet në mënyrë elektronike. Ndërsa për shortin manual janë të ngarkuar drejtuesit e seksioneve. Përsëri me kërkesë i jam drejtuar zyrës së sekretarisë, duke kërkuar informacion nëse ka ndonjë ankesë, kërkesë apo memo të depozituar nga palët në proces, individë, avokatë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore që kanë pretendime në lidhje me shortin. Nga kthim përgjigjja e datës 23.2.2021 rezulton se nuk ka asnjë të dhënë të tillë, ndaj dhe ky pretendim nuk qëndron.

- Ky shtetas që s'ka këtë identitet realisht pretendon diçka në raport me '***'.

Edhe ky pretendim i tillë nuk qëndron, pasi sipas kthim përgjigjes në të dhënat e regjistrorit në Prokurorinë e Tiranës, çështja që lidhet me '***' është hetuar nga prokurori A.L., ndërkohë që nga ana e prokurorisë për këtë shtetas është kërkuar 'arrest në burg'. Sa më sipër, jo një, por asnjë rresht i pretendimeve të individit që ka dashur t'i vërë vetes emrin Rr.Sh. nuk qëndron, nuk është i vërtetë dhe nuk bazohet në asnjë provë konkrete. Nga kërkimet e bëra në Zyrën e Regjistrorit në Prokurori rezulton se një individ me emrin Rr.Sh. ka depozituar me postë një copë letër, ku ngre disa pretendime në lidhje me një sërë shkeljesh.

Me kërkesën e datës 21.2.2021 kam marrë kopje të plotë të dosjes përkatëse, nga e cila rezulton se prokurorja e ngarkuar me hetimin, S.M., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në këtë denoncim, po me emrin Rr.Sh., rezulton të jenë akuzuar një sërë individësh dhe institucionesh. Në raport me pretendimet karshi personit tim kam bërë vetë kërkimet, të cilat po ua vë në dispozicion me dokumente zyrtare. Por dhe për këto pretendime apo dhe pretendime për shkelje të kryera nga institucione të tjera, ku përmenden dhe vëzhgues ndërkombëtarë, si dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm etj., është vendosur mosfillimi i çështjes penale. Nisur nga sa më sipër, bazueshmëria e çfarëdolloj pretendimi në denoncimin e të ashtuquajturit Rr.Sh., jo vetëm që nuk bazohet në ligj, por dhe nuk lejohet nga ligji.

Sa më sipër, bazuar në aktet dhe provat që po ju vë në dispozicion, asnjë pretendim nuk qëndron, do kërkoja nga Komisioni, por dhe nga vëzhguesi, të dalin jashtë suazës së fjalëve të vëna në gojën e një denoncuesi që i kanë sajuar emrin Rr.Sh., pasi në përmbajtjen e këtij denoncimi nuk ka asgjë të vërtetë, veçse përfaqëson një individ apo individë me një frymë shumë të madhe dashakeqësie dhe armiqësore karshi meje. Për sa më sipër, asnjë pretendim në gjetjen e prezantuar si të tillë në lidhje me heqjen dorë të znj. Ç. nga procesi im i rivlerësimit nuk qëndron, pasi nuk kam asnjë mundësi të ndikoj në rehatinë apo parehatinë e saj me familjarët e saj, nuk kam asnjë mundësi të di veprimet dhe lëvizjet e gazetarëve të ndryshëm dhe nuk ka asnjë bazë ligjore që më ngarkon mua të përgjigjem për veprime dhe mosveprime që s'janë kryer nga ana ime.

Në rrethanat e mësipërme, nuk ka një situatë ekzistuese ose që ka ndodhur, nuk ka një fakt ekzistues ose që ka ndodhur, ndaj dhe Gjetja duhet të bazohet në prova konkrete. E vetmja gjë që rrjedh e provuar nga aktet është si më poshtë:

- Znj. Ç., në cilësinë e komisioneres në procesin tim të rivlerësimit, ka mbajtur qëndrime të ndryshme, siç është mbyllja e hetimit me një kriter e më pas me tre kriterë, çfarë me të drejtë interpretohet aktualisht nga ana ime si 'parehati' e saj, parehati të cilën e ka shprehur në kërkesë të formalizuar, pa dijeninë dhe pa asnjë lloj lidhjeje me mua.
- Vëzhguesi ndërkombëtar mbështet argumentet e tij mbi bazën e një denoncimi nga burim anonim, i pavërtetë në përmbajtje në çdo rresht të tij dhe që e vetmja e vërtetë që ky denoncim paraqet është armiqësia dhe dashakeqësia që ka personi i fshehur pas emrit të rremë Rr.Sh. kundër meje.

- *Nuk është e ligjshme, por as e moralshme, që asnjë lloj interpretimi të mbështetet mbi rrethana të paqena që burojnë nga armiqësia e personave që fshehin emrin dhe identitetin e tyre dhe sajojnë gjëra të paqena në emër të urrejtjes.*

Së fundmi, nuk ka asnjë lidhje direkte apo indirekte me kërkesën për heqje dorë të znj. Ç., nuk njoh asnjë familjar të saj dhe nga institucionet e shtetit shqiptar nuk disponohet asnjë lloj informacioni nga asnjë lloj burimi për ndonjë problematikë të tillë. Nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë kërkesë, ankesë apo kallëzim në lidhje me këtë rast”.

Konstatim i Komisionit

Komisionerja e dorëhequr me vullnetin e saj i ka bërë të qarta arsyet e heqjes dorë dhe kërkesa e saj është pranuar nga një trup gjykues i ngritur sipas ligjit, prandaj nuk mundet të vihet në diskutim vërtetësia e vullnetit të shprehur prej saj në kërkesën për heqje dore, për më tepër kur nuk kemi asnjë provë, *indicie* apo të dhënë që komisionerja nuk ka deklaruar ushtrimin e ndikimit. Ajo e ka interpretuar kërkesën e saj për heqje dore si rezultat i mosplotësismit të një kriteri në vendimmarrje që lidhet me “humbjen e të qenurit objektive”.

Nga ana tjetër, nuk rezulton asnjë e dhënë apo indice që të lidhin subjektin e rivlerësimit me veprime konkrete të kryera prej saj në drejtim të kërkesës për heqje dorë nga komisionerja.

Komisioni çmon se shprehja e përdorur nga komisionerja e dorëhequr E.Ç, se ‘subjekti i rivlerësimit është e shqetësuar në lidhje me procesin e rivlerësimit’, nuk mundet të penalizojë këtë të fundit për një situatë subjektive të pashprehur direkt nga subjekti. Nga ana tjetër, nuk rezultoi që subjekti të këtë bërë ndonjë kërkesë për përjashtimin e komisioneres, çfarë do të shërbente për të provuar vullnetin e subjektit të rivlerësimit.

Vlen të theksojmë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji japin garanci të plota se organet e Vettingut janë të pavarura dhe në vendimmarrjet e tyre i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi.

Marrja e vendimeve në një proces kaq të rëndësishëm është totalisht e çliruar nga çdo lloj ndikimi apo ndërhyrjeje e çfarëdolloji, kusht ky i domosdoshëm për garantimin e mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës.

Nuk mundet të paragjykojmë ‘kërkesën për heqje dorë’, të një komisioneri duke arsyetuar argumente të tjerë nga ato që ka paraqitur vetë komisioneri, si dhe për aq kohë sa një trupë gjykuese e ka marrë në shqyrtim dhe është shprehur me vendim duke e pranuar këtë kërkesë.

Pas shqyrtimit të Gjetjes së mësipërme dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi sjellje që të përbënin shkelje etike apo profesionale nga ana e saj.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

A. Për vlerësimin e pasurisë

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.

1. Komisioni konstatoi disa problematika lidhur me pasuritë e ish-bashkëshortit në deklaratimet e bëra, por bazuar në praktikën e ndjekur nuk ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

2. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe iu përgjigj saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë.

3. Mbështetur në Gjetjet mbi hetimin e kryer për vlerësimin e pasurive, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

B. Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për 5 (pesë) çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Nga denoncimet dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar Komisioni nuk konstatoi problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi në tërësi të kriterit të pasurisë dhe vlerësimit profesional lidhur me çështjet e gjykuara dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura, denoncimet, dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka arritur nivel të mjaftueshëm për kriterin e pasurisë, të figurës dhe vlerësimit profesional.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, prokurore/drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës

dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Suela ZHEGU
Anëtare

Roland ILIA
Relator

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli